



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 612 Akti

Nr. 781 Vendimi
Tiranë, më 3.7.2024

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Brunilda Bekteshi	Kryesuese
Lulzim Hamitaj	Relator
Etleda Çiftja	Anëtare

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Jonida Vrana, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Francesco Ciardi, në datën 2.7.2024, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Flamur Kapllani**, me detyrë gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

OBJEKTI: Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

TRUPI GJKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoji arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, subjektin e rivlerësimit, vëzhguesin ndërkombëtar, si dhe pasi shqyrtoi dhe diskutoi mbi tërësinë e çështjes që i përket rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit Flamur Kapllani, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, i cili në seancën dëgjimore publike të datës 2.7.2024 kërkoi konfirmimin në detyrë,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit Flamur Kapllani gjatë periudhës së fillimit të procesit të hetimit administrativ ka ushtruar detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë. Për shkak të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ky subjekt i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.
2. Z. Flamur Kapllani u është nënshtruar procedurave të rivlerësimit, duke u shortuar si subjekt në shortin e hedhur në datën 15.12.2020 nga Komisioni, në përputhje me rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, me trup gjykues të përbërë nga komisionerët Lulzim Hamitaj, Brunilda Bekteshi dhe Etleda Çiftja.
3. Gjatë hetimit administrativ është njoftuar subjekti i rivlerësimit për përbërjen e trupit gjykues, duke i kërkuar gjithashtu të shprehej lidhur me ekzistencën e konfliktit të interesit me anëtarët e tij. Subjekti i rivlerësimit, me anë të postës elektronike të datës 19.1.2021, ka konfirmuar mospasjen e ndonjë konflikti interesi me anëtarët e trupit gjykues që i ishin bërë me dije.
4. Në vijim, pasi të gjithë anëtarët deklaruan mospasjen e konfliktit të interesit, me vendimin nr. 1, datë 21.12.2020, trupi gjykues vendosi të fillojë një hetim administrativ të thellë dhe të gjithanshëm sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, si dhe të caktojë kryesuese të trupit gjykues komisioneren Brunilda Bekteshi. Relatori i çështjes ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në nenin 14, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.
5. Në zbatim të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, subjekti i rivlerësimit ka nisur procedurat e rivlerësimit, si vijojnë:
 - a) plotësimi dhe dërgimi i deklaratës së pasurisë sipas shtojcës 2 të ligjit nr. 84/2016 pranë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI) brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, sipas nenit 31;
 - b) plotësimi dhe dërgimi i deklaratës për kontrollin e figurës sipas shtojcës 3 të ligjit nr. 84/2016 pranë Autoritetit Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (ish-DSIK, në vijim AKSIK), brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, sipas nenit 35;

- c) plotësimi dhe dërgimi i formularit të vetëvlerësimit profesional sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016 pranë organit të vlerësimit të aftësive profesionale, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi, sipas nenit 41 të ligjit nr. 84/2016.
6. Me vendimin nr. 2, datë 12.6.2024, Komisioni vendosi të mbyllë hetimet dhe, në bazë të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, vlerësoi që procesi i rivlerësimit për këtë subjekt të bazohej në të tria kriteret e rivlerësimit të parashikuara nga ligji nr. 84/2016.
7. Në datën 12.6.2024, Komisioni e njoftoi subjektin e rivlerësimit nëpërmjet postës elektronike mbi rezultatet e hetimit kryesisht dhe e ftoi atë për t'u njohur me dosjen dhe provat e administruara (nëse e vlerësonte të nevojshme), në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 35-40 e 45-47 të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe për të paraqitur shpjegimet e kërkuara në fund të hetimit administrativ, duke i dhënë kohë deri më 25.6.2024.
8. Në datën 13.6.2024 u paraqit përfaqësuesi me autorizim i subjektit, z. Taulant Mersini, për t'u njohur me dokumentacionin, të cilin e administroi nëpërmjet CD-së. Subjekti paraqiti shpjegimet e veta brenda afatit të caktuar nga Komisioni.
9. Trupi gjykues, pasi shqyrtoi shpjegimet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, nëpërmjet vendimit nr. 3, datë 27.6.2024, vendosi caktimin e seancës dëgjimore në datën 2.7.2024, duke e njoftuar subjektin përmes postës elektronike për këtë vendimmarrje.

II. SEANCA DËGJIMORE

10. Seanca dëgjimore u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në datën 2.7.2024, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Francesco Ciardi.
11. Në vijim, pasi dëgjoi relacionin, subjekti Flamur Kapllani parashitroi shpjegimet përkatëse lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, si dhe mbi procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij, duke iu referuar edhe shpjegimeve të paraqitura më herët me shkrim. Në fund të seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë. Seanca dëgjimore e datës 2.7.2024 u mbyll, për të rifilluar më 3.7.2024 për shpalljen e vendimit.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

12. Subjekti i rivlerësimit ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit, duke u përgjigjur në kohë kur i është kërkuar – sipas parashikimeve të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016 – përgjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ.

IV. HETIMI ADMINISTRATIV I KRYER NGA KOMISIONI

13. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu një hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (i) provat e dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit në ILDKPKI, në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (iii) raportin mbi kontrollin e figurës së dorëzuar në Komision nga AKSIK-ja; (iv) provat shkresore/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (v) raportin e përpiluar nga KLP-ja; (vi) deklaratimet dhe përgjigjet e subjektit të rivlerësimit të bëra me anë të komunikimit elektronik; (vii) shpjegimet me shkrim dhe dokumentacionin mbështetës të paraqitur nga

subjekti i rivlerësimit pas njoftimeve të mbylljes së hetimeve administrative; (viii) argumentimet e paraqitura në seancë dëgjimore; (ix) faktet e njohura botërisht.

A. VLERËSIMI I PASURISË

A/1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

14. Bazuar në nenet 30-33 të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja ka dërguar në Komision raportin lidhur me deklaratimet dhe vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, duke konstatuar se:

- *deklarimi është i saktë dhe në përputhje me ligjin;*
- *ka burime të ligjshme financiare për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklaratim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

15. Komisioni ka hetuar në mënyrë të pavarur mbi çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të sipërpërmendur, ashtu sikurse mbi të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016.

16. Hetimi administrativ në lidhje me vlerësimin e pasurisë ka konsistuar në: verifikimin e vërtetësisë së deklaratimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe personave të lidhur; verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi ose përdorim; evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklaratimeve të rreme apo të ndonjë konfliktit të interesave, të parashikuara nga pika 5 e nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

A/2. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

1. Apartament në Tiranë, në vlerën 5.070.000 lekë

17. Në DIPP-në e vitit 2004, subjekti ka deklaruar kontratën e sipërmarrjes nr. *** rep., datë 20.1.2004, nënshkruar mes tij dhe shoqërisë “****” sh.p.k., për porositjen e apartamentit nr. ***, kati ***, me sipërfaqe 88.10 m², në vlerën 5.070.000 lekë. Në këtë kontratë është cituar se në momentin e nënshkrimit është likuiduar shuma prej 2.000.000 lekësh, ndërsa pjesa tjetër e çmimit do të likuidohet në fund të vitit 2004.

18. Në DIPP-në e vitit 2011, subjekti ka deklaruar një kontratë shitblerjeje të apartamentit në analizë, me nr. ***, datë 20.12.2011¹, në të cilën është cituar se e gjithë vlera e apartamentit është likuiduar nga blerësit, jashtë zyrës noteriale.

19. Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar apartamentin nr. ***, me sipërfaqe 78,56 m², me nr. pasurie ***, kati ***, shkalla *** e godinës ***-katëshe, e ndodhur në z. k. ***, rruga “****”, Njësia Bashkiake nr. ***, Tiranë, në vlerën 5.070.000 lekë, në bashkëpronësi me bashkëshorten. Ai ka bashkëlidhur një vërtetim nga dokumenti hipotekor nr. ***, datë 29.3.2012, në emër të tij, ku evidentohet shënimi se pasuria në analizë është rivlerësuar në vlerën 10.998.400 lekë, në datën 25.5.2012.

¹ Bashkëngjitur deklaratës *Vetting*, subjekti ka paraqitur dokumentin hipotekor, si dhe dy kontratat.

20. Si burimin për krijimin e kësaj pasurie, subjekti ka deklaruar kursimet ndër vite, si dhe kredinë e marrë në datën 30.12.2005 në NBG Bank, në vlerën 25.000 euro, të cilën e ka shlyer plotësisht në datën 20.3.2015. Në mbështetje të deklarimit të tij, ai ka paraqitur vërtetimin nr. *** prot., datë 28.10.2016, nga NBG Bank.
21. Në përgjigje të pyetësorit nr. 1, subjekti ka deklaruar se ka shpenzuar vlerën 100.000 lekë për pajisjet elektroshtëpiake gjatë vitit 2006, si dhe 300.000 lekë të shpenzuara për pajisje dhe mobilim gjatë vitit 2015.
22. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka deklaruar se nuk ka kryer investime në pasurinë në fjalë. Rritja e vlerës së saj është rezultat i rivlerësimit sipas raportit² të datës 6.4.2012, për përgatitjen e të cilit subjekti ka deklaruar se ka paguar shumën 59.284 lekë. Nga ky raport ka rezultuar se vlera mesatare e çmimit të apartamentit ishte 1.000 euro/m², pra në total në shumën 78.560 euro ose 10.998.400 lekë³.
23. Nga verifikimi i kryer nga Komisioni referuar çmimeve të shitjes në tregun e lirë në qytetin e Tiranës, sipas EKB-së, rezultoi se për vitin 2003⁴ vlera e këtij apartamenti do të ishte në shumën 4.708.945 lekë. Pra, në një vlerë më të ulët nga sa e ka përfituar subjekti i rivlerësimit, për rrjedhojë duket se nuk gjendet në kushtet e trajtimit preferencial.
24. I pyetur në lidhje me sipërfaqen e apartamentit, e cila në kontratën e porosisë ka qenë 88,10 m², ndërsa në atë të shitblerjes ishte 78,56 m², subjekti ka shpjeguar se shoqëria e ndërtimit ka ndryshuar sipërfaqen e përbashkët nga 9,54 m² në 13,27 m². Ai ka sqaruar gjithashtu se moszbatimi i lejes së ndërtimit ka sjellë vonesa në hipotekimin e pallatit dhe nxjerrjen e certifikatave të pronësisë. Nga dokumentacioni i administruar ka rezultuar se shoqëria “***” sh.p.k. është pajisur me vërtetim hipotekor në datën 22.11.2011, pothuajse 1 muaj para nënshkrimit të kontratës së shitblerjes. Subjekti ka deklaruar se nuk disponon garazh as në këtë pallat dhe as në ndonjë vend tjetër.

1.1 Përgjatë hetimit administrativ, Komisioni ka administruar dokumentacionin si në vijim:

25. ASHK⁵ ka përcjellë kartelën e pasurisë, në të cilën citohet se ajo është rivlerësuar në shumën 10.998.400 (lekë), si dhe një mandatarëkëtim të datës 25.5.2012 dhe certifikatën e vlerësimit të pasurisë në fjalë.
26. Ministria e Drejtësisë⁶ ka përcjellë kopje të regjistrit të veprimeve noteriale të kryera nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur, në të cilin janë evidentuar kontrata e porosisë dhe ajo e shitblerjes së pasurisë në analizë. Komisioni ka administruar kontratat në fjalë dhe ka konstatuar se ato janë të njëjta me ato të paraqitura nga subjekti.
27. Furnizuesi i Shërbimit Universal⁷ (në vijim FSHU) ka bërë me dije se me të dhënat Flamur Kapllani kanë rezultuar 10 kontrata, konkretisht: 4 kontrata në Berat, 2 në Shijak, 1 në Vlorë, 1 në Fier dhe 2 në Tiranë. FSHU-ja ka sqaruar se nuk disponon të dhëna personale

² Paraqitur nga subjekti në përgjigje të pyetësorit nr. 2.

³ Bazuar në metodën aplikuese të vlerësimit “Krahasimi i drejtpërdrejtë e cila merr në konsideratë vlerat e shitblerjeve në kushtet e ngjashme me pronën objekt vlerësimi”.

⁴ Pasi kontrata e sipërmarrjes është nënshkruar në datën 20.1.2004, kohë në të cilën nuk kishte dalë udhëzimi për vitin 2004.

⁵ Me shkresën nr. *** prot., datë 23.4.2021.

⁶ Me shkresën nr. *** prot., datë 26.3.2021.

⁷ Shkresa nr. *** prot., datë 2.4.2021.

të abonentëve, veç emrave dhe mbiemrave dhe, për këtë arsye, është në pamundësi për të identifikuar nëse kontratat e identifikuara i përkasin subjektit dhe personave të lidhur.

28. Pas ripërsëritjes së kërkesës për vënien në dispozicion të kopjeve të kontratave të sipërcituara, FSHU-ja⁸ ka bërë me dije se nuk disponon dokumente që i përkasin periudhës përpara vitit 2007. Ky informacion disponohej nga KESH.
29. Në vijim, Komisioni i është drejtuar KESH-it⁹, i cili ka bërë me dije se nuk dispononte informacionin e kërkuar.
30. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka deklaruar se ka filluar të banojë në apartamentin në analizë, në janar të vitit 2006. Në mbështetje të deklaramit të tij, ai ka paraqitur kontratën e energjisë elektrike me nr. kontrate ***, si dhe përgjigjen e FSHU-së nr. *** prot., datë 12.6.2023, sipas së cilës kontrata nr. ***, me kod klienti ***, e lidhur në emrin e subjektit, është hapur në datën 28.3.2006¹⁰. Deri në këtë periudhë, kontrata rezultonte në emër të sipërmarrësit dhe investitorit, shoqërisë “****” sh.p.k.
31. UKT-ja¹¹ ka konfirmuar kontratën me nr. ***, për objektin me adresë rruga “****”, Tiranë, në emër të subjektit. Po ashtu, subjekti ka paraqitur në përgjigje të pyetësorit nr. 2 përgjigjen e UKT-së¹², ku konfirmohet kontrata me nr. *** e lidhur në emër të subjektit. Bashkëlidhur saj gjendet informacioni i rezultuar nga sistemi SMI, me të dhënat nga muaji maj 2008 e në vijim.
32. Për sa i përket marrëdhënies me shtetasin A. Sh. dhe shoqërinë “****” sh.p.k., subjekti ka deklaruar se nuk ka pasur dhe nuk ka ndonjë marrëdhënie shoqërore përveçse marrëdhënies kontraktuale për porositjen dhe blerjen e apartamentit. Gjithashtu, ai ka deklaruar se nuk ka gjykuar ndonjë çështje me palë ndërgjyqëse ose kërkues këtë shtetas dhe/ose me shoqërinë “****” sh.p.k.
33. Nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë¹³, Kukës¹⁴ dhe Lezhë¹⁵ është konfirmuar se nuk kanë rezultuar çështje të shqyrtuara nga subjekti me palë shoqërinë “****” sh.p.k. dhe as me administratorin dhe ortakun e vetëm të kësaj shoqërie, z. A. Sh.
34. SPAK¹⁶ ka bërë me dije se në emër të shtetasit të sipërpërmendur nuk është regjistruar ndonjë procedim penal.
35. DPPP-ja¹⁷, me shkresën e datës 8.4.2021, ka konfirmuar se në emër të z. Flamur Kapllani kanë rezultuar raportime të kontratave noteriale, si dhe ka raportime të transaksioneve bankare, si vijon:
 - në datën 20.12.2011, blerja e pasurisë nr. ***, volumi ***, faqe ***, z. k. ***, në vlerën 5.070.000 lekë, nga shoqëria “****” sh.p.k., sipas kontratës nr. ***;

⁸ Me shkresën nr. *** prot., datë 19.4.2023.

⁹ Me shkresën nr. *** prot., datë 24.5.2023.

¹⁰ Bashkëlidhur kësaj shkrese, ka rezultuar përmbledhësja e pagesave të kryera, prej muajit janar 2007 e në vijim.

¹¹ Me shkresën nr. *** prot., datë 30.3.2021.

¹² Shkresën nr. *** prot., datë 13.6.2023.

¹³ Me shkresën nr. *** prot., datë 27.4.2023.

¹⁴ Me shkresën e datës 25.4.2023 (prot. nr. ***).

¹⁵ Me shkresën nr. *** prot., datë 29.2.2024.

¹⁶ Me shkresën nr. *** prot., datë 2.5.2023.

¹⁷ Me shkresën e datës 10.5.2017 është konfirmuar për ILDKPKI-në i njëjti informacion që është përcjellë edhe për Komisionin nga DPPP-ja.

- në datën 20.3.2015, shlyerje totale e kredisë në NBG Bank, në vlerën 11.320 euro;
- në datën 20.3.2015, debitim i llogarisë në Credins Bank, në shumën 1.000.000 lekë.

1.2 Lidhur me analizën financiare të burimeve të krijimit të pasurisë

36. Në deklaratën *Vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si burim për blerjen e pasurisë në fjalë: (i) kursimet ndër vite nga të ardhurat personale; (ii) një kredi të marrë në datën 30.12.2005 pranë NBG Bank, në vlerën 25.000 euro, me afat 20 vjet, e cila është shlyer totalisht në datën 20.3.2015¹⁸.
37. Lidhur me likuidimin e çmimit të kësaj pasurie, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratat periodike, si vijon:
- në deklaratën e vitit 2004 – paguar 1.000.000 lekë nga të ardhurat e akumuluar kursime etj., me lidhjen e kontratës;
 - në deklaratën e vitit 2005 – paguar 500.000 lekë + kredia;
 - në deklaratën e vitit 2006 – paguar kësti i fundit firmës ndërtuese në shumën 500.000 lekë.
38. Ndërsa, në përgjigje të pyetësorit nr. 1, subjekti ka deklaruar se pagesat për këtë pasuri janë kryer si vijon:
- 1.000.000 lekë paguar në vitin 2003 (si parapagim pa dokumentacion);
 - 1.000.000 lekë paguar në datën e nënshkrimit të kontratës së sipërmarrjes;
 - 25.000 euro paguar me kredinë e marrë në bankën NBG Bank, në datën 30.12.2005.
39. Në përgjigje të pyetësorit nr. 4, subjekti ka shpjeguar se pagesat për likuidimin e çmimit të apartamentit janë kryer sipas deklarimeve të tij në DIPP-të vjetore, konkretisht:
- në momentin e lidhjes së kontratës janë paguar 1.000.000 lekë nga të ardhurat e akumuluar kursime etj.;
 - në deklaratën e vitit 2005 – paguar 500.000 lekë në fund të dhjetorit 2005 me mandat dore, në cash, plus vlerën e kredisë prej 25.000 euro;
 - në deklaratën e vitit 2006 – paguar kësti i fundit firmës ndërtuese në shumën 500.000 lekë, me mandat dore në cash, pagesë e bërë në dhjetor 2006;
40. Po ashtu, subjekti ka shpjeguar se kontrata e sipërmarrjes e datës 20.1.2004, është kontratë tip dhe citimi se “Në momentin e nënshkrimit të saj janë likuiduar 2.000.000 lekë”, mund të ketë mbetur i pandryshuar nga ndonjë kontratë e ngjashme, detaj ky që nuk i është kushtuar rëndësi, pasi në fakt në vitin 2004 janë paguar 1.000.000 lekë, sikurse është deklaruar edhe në DIPP-në e këtij viti.
41. Lidhur me shumat dhe kohën e kryerjes së pagesave nga subjekti, Komisioni i është drejtuar edhe shoqërisë ndërtuese “****” sh.p.k., e cila në përgjigjen e dërguar¹⁹ ka informuar se pagesat në fjalë janë kryer si në tabelën në vijim.

¹⁸ Sipas vërtetimit datë 20.12.2016 të NBG Bank.

¹⁹ Kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 28.5.2024.

Tabela nr. 1 – Likuidimi i pasurisë apartament

Datë	Shuma	Dokumenti
20.1.2004	1,000,000 ALL	Mandatarkëtim nr. ***
28.12.2005	500,000 ALL	Mandatarkëtim nr. ***
30.12.2005	24,625 €	Kredi në NBB Bank, transfertë bankare
26.12.2006	500,000 ALL	Mandatarkëtim nr. 371

42. Për sa më sipër, Komisioni ka analizuar burimin e krijimit për secilën pagesë të kryer sipas dokumentacionit të depozituar nga shoqëria e ndërtimit, si dhe ka analizuar disponibilitetin financiar të subjektit për krijimin e pasurisë apartament.

1.2.1 Lidhur me pagesën e kryer në vitin 2004, në shumën 1.000.000 lekë

43. Në DIPP-në e vitit 2004, subjekti ka deklaruar se ka paguar 1.000.000 lekë me të ardhurat e akumuluar, kursime etj., deri në momentin e lidhjes së kontratës së datës 20.1.2004. Ndërkohë që në DIPP-në e vitit 2003, subjekti nuk ka deklaruar kursime *cash*.

44. I pyetur nga Komisioni lidhur me këtë konstatim, në përgjigje të pyetësorit nr. 4, subjekti parashtrori se pavarësisht se ai nuk kishte deklaruar gjendje *cash* në DIPP-në e vitit 2003 dhe as pakësim të saj në vitin 2004, bazuar në burimin e deklaruar në DIPP-në vjetore dhe në deklaratën *Vetting*, gjendja dhe pakësimi i gjendjes *cash* në vitin 2003, sipas tij, është krejtësisht i kuptueshëm. Pra, subjekti pretendon se përdorimi i likuiditeteve *cash* ishte cituar prej tij si burim për pagesën e kështit të parë, ndonëse nuk ishte saktësuar në deklaratat përkatëse si gjendje *cash* në banesë dhe më pas si pakësim i saj.

45. Për sa më sipër, duke iu referuar faktit se deklarata e vitit 2003 është depozituar në qershor të vitit 2004, kohë kur ishte paguar kësti i parë (në janar 2004), është konstatuar se subjekti ka kryer deklarim të pasaktë për kursimet e tij. Pas qartësimit të subjektit lidhur me kursimet e tij, Komisioni analizoi disponibilitetin financiar të subjektit dhe familjes së tij, për krijimin e gjendjes *cash* deri në fund të vitit 2003. Në këtë analizë u përfshinë të ardhurat e konfirmuara nga institucionet punëdhënëse²⁰ apo financiare²¹ për interesat e përfutur gjatë kësaj periudhe, si dhe shpenzimet e identifikuar për periudhën 1997²² – 2003.

46. Për të ardhurat e realizuara nga bashkëshortja e subjektit gjatë vitit 2003, subjekti ka depozituar në deklaratën *Vetting* disa mandate për tërheqje me *check* nga llogaria e United Nations Development Programme në Intesa Sanpaolo Bank. Gjatë hetimit, subjekti ka depozituar²³ një vërtetim të datës 7.11.2003, të nënshkruar nga menaxheri kombëtar i projektit, ku citohej se: “Znj. E. K. ka qenë e punësuar pranë Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Bujqësinë dhe Ushqimin, projekti ***/***/***/***, në pozicionin sekretare/përkthyes për periudhën mars – nëntor 2003”. Duke qenë se nuk u provua me dokumentacion ligjor sa kanë qenë këto të ardhura, si dhe nuk u provua pagesa e detyrimeve tatimore lidhur me to, sikurse përcakton neni D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe neni

²⁰ Shkresë nr. *** prot., datë 20.10.2016, nga ISSH/Drejtoria Rajonale Berat; vërtetim nr. *** prot., datë 17.10.2016, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë; vërtetim datë 14.10.2016 nga shkolla e mesme profesionale kombëtare “****” ***, Kavajë.

²¹ Shkresë nr. *** prot., datë 26.3.2021, nga ProCredit Bank.

²² Kohë kur subjekti ka filluar detyrën.

²³ Me pyetësorin nr. 4, datë 8.5.2024.

3, pika 19 e ligjit nr. 84/2016, Komisioni vlerësoi të mos i konsiderojë të ardhurat e realizuara nga bashkëshortja e subjektit në analizën financiare.

47. Ndërsa, për sa i përket shpenzimeve, ato janë përlllogaritur në përputhje me metodologjinë e aplikuar sipas jurisprudencës së Kolegjit të Posaçëm të Apelimit²⁴ në masën 30% për vitet 1997 – 1999 dhe sipas INSTAT-it²⁵ për vitet 2000 – 2003.
48. Gjithashtu, gjatë hetimit ka rezultuar se për periudhën e analizuar, subjekti i rivlerësimit ka investuar në blerjen e automjetit tip “Audi”, në vlerën 240.000 lekë, sipas kontratës nr. ***, datë 23.8.2000. Në përgjigje të pyetësorit nr. 3, subjekti ka deklaruar se ky mjet ka dalë nga qarkullimi në vitin 2002 dhe është shitur për pjesë këmbimi në një servis automjetesh në vlerën 100.000 lekë. Subjekti nuk ka paraqitur ndonjë dokument që do të vërtetonte të ardhurat e përfutuara nga shitja për pjesë këmbimi. Për rrjedhojë, këto të ardhura nuk janë përfshirë në analizën financiare.

Tabela nr. 2 – Mundësia për kursim për pagesën e vitit 2004

Nr.	Përshkrimi	Periudha 1997 – 2003
1	TË ARDHURA	3,355,225
	Të ardhura nga paga e subjektit	2,830,613
	Të ardhura nga paga e bashkëshortes	517,123
	Të ardhura nga interesat	7,489
2	SHPENZIME	1,575,499
	Shpenzime jetese 1997 – 1999 (30% e të ardhurave)	244,315
	Shpenzime jetese 2000 – 2003 sipas ILDKPKI-së	1,211,184
	Shpenzime transporti	120,000
3	PASURI	492,520
	Pasuri e paluajtshme/e luajtshme	
	Automjet Audi (23.8.2000)	240,000
	Banka (31.12.2003)	252,520
4	DIFERENCA (1-2-3)	1,287,206

49. Për sa më sipër, Komisioni ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit dhe familja e tij kanë pasur mundësi që të kursejnë shumën 1.287.206 lekë deri në fund të vitit 2003. Kjo shumë ka rezultuar e mjaftueshme për pagesën e kështit të parë në vlerën 1.000.000 lekë, të paguar në datën 20.1.2004, për blerjen e apartamentit.

1.2.2 Lidhur me pagesat e kryera në vitin 2005, konkretisht 500.000 lekë dhe kredia në shumën 25.000 euro

50. ABI Bank²⁶ ka konfirmuar se z. Flamur Kapllani ka marrë një kredi sipas kontratës nr. ***, datë 20.12.2005, në shumën 25.000 euro, me afat maturimi datë 25.12.2025. Kredia është disbursuar në datën 30.12.2005 – dhe po në këtë datë është transferuar shuma 24.625 euro në llogari të shoqërisë “****” sh.p.k., me përshkrimin²⁷ “Blerje apartamenti nga z. Flamur Kapllani sipas kontratës së sipërmarrjes të datës 20.1.2004”.
51. Komisioni ka analizuar disponibilitetin financiar të familjes së subjektit, duke konsideruar e përlllogaritur të ardhurat dhe shpenzimet e familjes së tij për të gjithë vitin 2005, bazuar

²⁴ Vendimi nr. ***, datë 18.6.2021, i Kolegjit.

²⁵ Shkresa nr. *** prot., date 4.3.2019, nga ILDKPKI-ja.

²⁶ Me shkresën nr. *** prot., datë 12.4.2023.

²⁷ Sipas shkresës nr. *** prot., datë 26.4.2024, nga ABI Bank.

edhe në përgjigjen e shoqërisë së ndërtimit, si dhe mandatarkëtimin e lëshuar prej saj për pagesën e shumës 500.000 lekë, në datën 28.12.2005, siç paraqitet në tabelën në vijim.

Tabela nr. 3 – Analiza financiare për pagesat e vitit 2005

Nr.	Përshkrimi	2005
1	TË ARDHURA	4,519,740
	Të ardhura nga paga e subjektit	936,196
	Të ardhura nga paga e bashkëshortes	500,000
	Të ardhura nga interesat	20,044
	Kredi NBG Bank, datë 20.12.2005 (25.000 euro)	3,063,500
2	SHPENZIME	397,065
	Shpenzime jetese sipas ILDKPKI-së	328,671
	Shpenzime transporti	33,000
	Shpenzime TIMS	35,394
3	PASURI	4,103,601
	Pasuri e paluajtshme/e luajtshme	
	Apartament me sip. 89 m ² , Tiranë (kësti 500.000 lekë + kredia)	3,517,548
	<i>Ndryshim likuiditeti</i>	586,054
4	DIFERENCA (1-2-3)	19,073

52. Nga sa më sipër, Komisioni ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit ka pasur burime të mjaftueshme për pagesën e këstit të apartamentit, si dhe për të përballuar shpenzimet e tjera familjare.

1.2.3 Lidhur me pagesën e kryer në vitin 2006, në shumën 500.000 lekë

53. Komisioni ka analizuar disponibilitetin financiar të familjes së subjektit, duke konsideruar e përlllogaritur të ardhurat dhe shpenzimet e identifikuar për të gjithë vitin 2006, bazuar edhe në përgjigjen dhe dokumentacionin e depozituar nga shoqëria e ndërtimit, pasi sipas mandatarkëtimin shuma prej 500.000 lekësh është paguar në datën 26.12.2006.

54. Nga hetimi i kryer nga Komisioni, si dhe bazuar në përgjigjet e subjektit në pyetësonin nr. 2, ka rezultuar se në vitin 2006 subjekti ka marrë një kredi në Raiffeisen Bank në shumën 1.000.000 lekë, me qëllim realizimin e disa punimeve në shtëpi. Sipas shpjegimeve të subjektit (pas konsultimit me një inxhinier), këto punime nuk mund të kryheshin, për rrjedhojë, në vitin 2007, shumën në fjalë e ka ridepozituar në bankë, duke e likuiduar plotësisht kredinë. Ky deklaram i subjektit është konfirmuar edhe nga përmbajtja e procesverbalit të datës 11.3.2011, i mbajtur nga ILDKPKI-ja²⁸.

55. Në analizën financiare të kryer lidhur me disponibilitetin e subjektit për pagesën e shumës 500.000, Komisioni ka konsideruar veç kredisë në NBG Bank, të ardhurave dhe shpenzimeve përkatëse të periudhës në analizë, edhe shumën e marrë kredi në Raiffeisen Bank prej 1.000.000 lekësh, si gjendje *cash* në likuiditete, siç paraqitet në tabelën në vijim:

²⁸ I paraqitur nga subjekti në përgjigje të pyetësonit nr. 4, si dhe i administruar nga Komisioni me shkresën nr. *** prot., datë 17.5.2024.

Tabela nr. 4 – Analiza financiare për pagesën e vitit 2006

Nr.	Përshkrimi	2006
1	TË ARDHURA	1,953,169
	Të ardhura nga paga e subjektit	935,187
	Të ardhura nga interesat	17,982
	Kredi në Raiffeisen Bank, 5.7.2006 (1.000.000 lekë)	1,000,000
2	SHPENZIME	1,204,053
	Shpenzime jetese sipas ILDKPKI-së	328,671
	Shpenzime transporti	33,000
	Shpenzime TIMS	140,843
	Shpenzime arredimi	250,000
	Shpenzime kredia NBG Bank (25.000 euro) (principal + interes)	324,572
	Shpenzime kredia Raiffeisen Bank (1.000.000 lekë) (principal +interes)	126,967
3	PASURI	988,598
	Pasuri e paluajtshme/e luajtshme	
	Apartament në Tiranë (kontratë sipërmarrjeje datë 20.1.2004)	500,000
	<i>Ndryshim likuiditeti</i>	488,598
4	DIFERENCA (1-2-3)	(239,482)

56. Nga analiza e kryer subjekti ka rezultuar me një pamundësi financiare në shumën 239.482 lekë, për të paguar këstin e fundit të apartamentit, si dhe për të përballuar shpenzimet e tjera familjare. Për rrjedhojë, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe paragrafin 5 të nenit Ç të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i ka kaluar subjektit barrën e provës për të paraqitur prova e shpjegime të tjera/bindëse për të provuar të kundërtën e rezultateve të Komisionit lidhur balancën negative të konstatuar.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

57. Subjekti ka pretenduar se balanca negative e konstatuar nga Komisioni është rezultat i mospërfshirjes në analizën financiare të të ardhurave nga punësimi i bashkëshortes si përkthyes, në shumën 600.000 lekë, në projektin “****”, kompani konsulente e rekrutuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, sipas procedurave të përcaktuara nga Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Banka Botërore.

58. Subjekti është shprehur se ka arritur të sigurojë disa prova indirekte, siç është raporti i vlerësimit të ndikimit mjedisor, nr. ***, vol. ***, maj 2006, i marrë nga faqja zyrtare e Bankës Botërore (në gjuhën angleze, i përkthyer), për të provuar kohën dhe burimin e të ardhurave. Në pamundësi për t'i dokumentuar këto të ardhura, për shkak të kohës së largët, projektit të huaj i cili nuk është më prezent në Shqipëri, subjekti ka pretenduar që Komisioni të bënte një vlerësim, duke balancuar shpenzimet e jetesës me këto të ardhura.

59. Gjithashtu, subjekti ka pretenduar se gjatë këtij viti ka paguar këstet e kredisë në monedhën euro, duke i konvertuar të ardhurat e tij në lekë, me kursin me të mirë që tregu ofronte.

Vlerësimi i trupit gjykues

60. Pas analizimit të pretendimeve të subjektit lidhur me pretendimin e tij për përfshirjen në analizën financiare të të ardhurave nga punësimi i bashkëshortes në shumën 600.000 lekë, trupi gjykues çmon se vlerësimi i ligjshmërisë së tyre i nënshtrohet kritereve të parashikuara nga neni D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe neni 3, pika 19 e ligjit nr. 84/2016.

61. Në vlerësimin e kësaj situatë faktike, nën dritën e kuadrit ligjor të kohës, edhe pse nga provat e paraqitura nga subjekti deri diku konfirmohet marrëdhënia e punësimit²⁹ të bashkëshortes së tij, si dhe deklarimi i tyre në DIPP-në e vitit 2006, sërisht nuk plotësohet kushti kumulativ i pagesës së tatimit për këto të ardhura, sikurse përcakton dispozita e sipërcituar. Për rrjedhojë, trupi gjykues ka vlerësuar të mos i përfshijë këto të ardhura në analizën financiare, si burim për pagesën e këstit prej 500.000 lekësh për blerjen e apartamentit në pronësi të subjektit.
62. I gjendur në pamundësi për të provuar me dokumentacion ligjor të ardhurat e bashkëshortes, subjekti ka pretenduar që Komisioni të bëjë një vlerësim, duke balancuar minimalisht të ardhurat e përfituara nga bashkëshortja me shpenzimet e jetesës.
63. Trupi gjykues çmon se nuk mund ta marrë në konsideratë këtë pretendim të subjektit, pasi pranimi i tij do të kishte të njëjtin efekt financiar sikurse edhe përfshirja në analizën financiare e të ardhurave nga punësimi i bashkëshortes – të cilat, sikurse u analizua më sipër, nuk mund të konsiderohen si të ligjshme në kuptim të ligjit. Përlllogaritja e shpenzimeve të jetesës nga Komisioni sipas të dhënave të INSTAT-it, në funksion të analizës financiare për subjektin e rivlerësimit, përbën një zgjedhje tejet garantiste ndaj tij. Për rrjedhojë, Komisioni nuk mundet kryesisht të reduktojë këto shpenzime apriori dhe në mungesë të një dokumentacioni ligjor justifikues.
64. Megjithatë, trupi gjykues do të mbajë në konsideratë në kuadër të një vlerësimi të përgjithshëm të situatës financiare të subjektit të rivlerësimit faktin se këto të ardhura, të cilat ndonëse nuk e kaluan testin e ligjshmërisë sipas përcaktimeve të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, referuar provave indirekte të paraqitura nga subjektit, kanë qenë gjithsesi pjesë e buxhetit të familjes.
65. Lidhur me pretendimin e subjektit se ka përdorur kursin e këmbimit më të favorshëm në treg, trupi gjykues, nisur nga fakti se nëpërmjet dokumentacionit të administruar nga Komisioni nuk konstatohet periudha apo data konkrete për këmbimin e kursit valutor, nuk vlerëson ta marrë në konsideratë këtë pretendim, për sa kohë ai mbetet i paprovuar.
66. Në përfundim të sa u parashtrua e analizua më sipër, trupi gjykues çmon se balanca negative e njoftuar subjektit të rivlerësimit me rezultatet e hetimit mbetet e pandryshuar, e cila vlerësohet në tërësi me rrethanat e çështjes, që janë përcaktuese për vlerësimin e kriterit të pasurisë apo procesit të rivlerësimit për këtë subjekt.

2. Pasuri e llojit tokë arë, e ndodhur në *, Durrës, me sipërfaqe 1.000 m²**

67. Subjekti ka deklaruar për herë të parë në DIPP-në e vitit 2012, e më pas në deklaratën *Vetting*, pasurinë e llojit tokë arë me sipërfaqe 1.000 m², me nr. ***, z. k. ***, vol. ***, fq. ***, ndodhur në fshatin ***, Durrës, në vlerën 200.000 lekë. Kjo pasuri është përfituar nëpërmjet kontratës nr. ***, datë 10.11.2012, nga shitësi F. I. Bashkëlidhur deklaratës *Vetting* subjekti ka depozituar certifikatën e pronësisë së pasurisë në fjalë, me nr. ***, datë 18.12.2012, në emër të shtetasve Flamur Kapllani dhe E. K. Si burim për krijimin e kësaj

²⁹ Mandate për tërheqje me *check* nga llogaria e United Nations Development Programme në Intesa Sanpaolo Bank, në shumën totale 608.360 lekë; vërtetimi i datës 7.11.2003, i menaxherit kombëtar të projektit, i cili deklaron se znj. E. K. ka qenë e punësuar pranë Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Bujqësinë dhe Ushqimin, projekti ***/***/***/***, në pozicionin sekretare/përkthyes për periudhën mars – nëntor 2003; si dhe komunikime nëpërmjet postës elektronike mes bashkëshortes së subjektit dhe një përfaqësueseje të shoqërisë për të cilën bashkëshortja e subjektit ka punuar.

pasurie, subjekti ka deklaruar kursimet e realizuara nga paga gjatë vitit 2012 dhe nga aktiviteti privat i ushtruar nga bashkëshortja e tij.

68. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, të dërguar nga Komisioni, subjekti ka sqaruar se likuidimi i çmimit për blerjen e pasurisë në analizë është kryer *cash*. Në vijim, në përgjigje të pyetësorit nr. 4, subjekti ka paraqitur 3 kontrata të ngjashme të nënshkruara nga shtetas të tjerë për shitblerjen e pronave në të njëjtën zonën ku gjendet edhe pasuria e tij – dhe që i përkasin të njëjtës periudhë³⁰. Nga shqyrtimi i këtyre kontratave ka rezultuar se ato janë nënshkruar nga i njëjti shitës (i cili i ka shitur truallin subjektit) – dhe se çmimi i shitjes ka qenë i njëjtë me atë të cilin ka paguar edhe subjekti.

2.1 Përgjatë hetimit administrativ, Komisioni ka administruar dokumentacionin si vijon:

69. ASHK³¹ ka konfirmuar pasurinë në analizë, në pronësi të subjektit dhe bashkëshortes së tij.
70. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të përcjellë nga Ministria e Drejtësisë³² (regjistri i veprimeve noteriale), ndër të tjera ka rezultuar edhe një kontratë sipërmarrjeje nr. ***, datë 15.3.2017, e nënshkruar nga subjekti dhe bashkëshortja e tij, me shtetasin Ilir Latifi, në cilësinë e administratorit të shoqërisë ndërtuese “****” sh.p.k.
71. Lidhur me këtë kontratë, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka sqaruar se ka rënë dakord me shoqërinë ndërtuese “****” sh.p.k., për t’i vënë në dispozicion pasurinë tokë arë, me qëllim marrjen e lejes së ndërtimit nga ana e saj (për një sipërfaqe edhe më të madhe në të cilën përfshihej edhe pasuria e subjektit), për ndërtimin e një kompleksi. Në këmbim shoqëria ka marrë përsipër ndërtimin e një objekti për llogari të pronarëve të tokës, pra për llogarinë e subjektit dhe bashkëshortes së tij. Po ashtu, subjekti ka shpjeguar se vlera e përgjithshme e objektit do të paguhej në momentin e paraqitjes së situacionit dhe faturës nga shoqëria e ndërtimit. Në mbështetje të deklarimit të tij, subjekti ka paraqitur një shkresë nga shoqëria “****” sh.p.k., të datës 15.6.2023 (bashkëlidhur së cilës gjendet procesverbali i inxhinierit të shoqërisë dhe fotot përkatëse aktuale të ndërtesës, si dhe foto të marra në Google Earth nga portali <https://geoportal.asig.gov.al>³³), ku citohet se: *“Bazuar në kontratën e sipërmarrjes nr. ***, datë 15.3.2017, shoqëria ndërtuese “****” sh.p.k. ka marrë përsipër ndërtimin e objektit. Shoqëria është pajisur me lejet e posaçme për ndërtimin e kësaj vile, si më poshtë: vendimit të KKT-së nr. ***, datë 12.4.2017; vendimit të KKT-së nr. ***, datë 6.11.2018; leje nr. ***, datë 20.2.2018 dhe leje nr. *** prot., datë 4.9.2019, me afat kohor 78 muaj; Ju konfirmojmë se shoqëria “****” sh.p.k. nuk ka lëshuar asnjë faturë tatimore për punimet e realizuara deri tani për vilën objekt të kontratës sonë dhe nuk ka arkëtuar asnjë shumë monetare deri më sot në lidhje me kontratën e sipërcituar. Vlera e përgjithshme e objektit do të faturohet nga ana jonë me përfundimin e ndërtimit. Në këtë moment, shoqëria do të ketë njohur dhe kontabilizuar të gjitha kostot e realizimit të ndërtimit dhe do t’i shpërndajë ato në mënyrë proporcionale sipas parashikimeve kontraktuale”*.

³⁰ Kontratat nr. ***, datë 10.11.2012, nr. ***, datë 10.11.2012 dhe nr. ***, datë 9.12.2012.

³¹ Me shkresat nr. *** prot., datë 6.9.2017 dhe datë 4.10.2017.

³² Me shkresën nr. *** prot., datë 26.3.2021.

³³ Me shkresën nr. *** prot., datë 17.5.2023, nga Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor, është bërë me dije se me të dhënat e kërkuara ishte e pamundur të identifikohesh pasuria në fjalë. Duke qenë se informacioni është përcjellë nga subjekti, nuk është konsideruar e nevojshme të përsëritej kërkesa.

72. Gjithashtu, subjekti ka sqaruar se nuk ka kryer pagesë për ndërtimin, pasi shoqëria e ndërtimit nuk ka respektuar grafikun e punimeve sipas lejes së miratuar, si dhe nuk ka ende dokumentacion ligjor për respektimin e zbatimit të projektit të miratuar nga Zyra e Urbanistikës. Pagesa lidhet me përfundimin e objektit, ndërtimin e tij sipas projektit të miratuar, hartimin e aktit të kolaudimit, që vërteton përfundimin e ndërtimit të objektit sipas projektit të miratuar. Me nxjerrjen e lejes së shfrytëzimit nga Zyra e Urbanistikës, që lejon përdorimin e këtij sendi sipas destinacionit të përcaktuar në lejen e ndërtimit dhe regjistrimin e tij në ASHK, ky send të futet në qarkullimin juridiko-civil.
73. I pyetur nga ILDKPKI-ja, në datën 9.7.2021³⁴, lidhur me deklarin e kontratës së sipërmarrjes në DIPP-në e vitit 2018, ndërkohë që ajo ishte nënshkruar në vitin 2017, subjekti ka deklaruar se bëhej fjalë për një harrësë nga ana e tij.
74. Për sa i përket marrëdhënies me shtetasit F. I. dhe I. L., në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka deklaruar se me ta ka vetëm njohje të zakonshme dhe se nuk gjendej në kushtet e konfliktit të interesit me këta shtetas. Po ashtu, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë³⁵ ka konfirmuar se nuk kanë rezultuar çështje të shqyrtuara nga subjekti me palë shtetasit e mësipërm, gjatë ushtrimit të detyrës si gjyqtar.
75. SPAK³⁶ ka bërë me dije se në emër të shtetasve të sipërpërmendur nuk është regjistruar ndonjë procedim penal.
76. Gjatë hetimit administrativ, Komisioni ka administruar dy denoncime me të njëjtën përmbajtje (ku përmendet pasuria në analizë), të datës 9.5.2019, me nr. *** prot. dhe nr. *** prot., nga shtetasi A. Sh. Denoncuesi ka parashtruar se subjekti frekuenton shumë shpesh një hotel në ***. Në këtë hotel janë aksionerë denoncuesi, shtetasja E. P., si dhe kunati i subjektit, z. B. K.
77. Gjithashtu, denoncuesi ka parashtruar se ortakja E. P. ka kërkuar të shkëmbejë një pjesë të aksioneve të saj me një “tokë arë” në pronësi të z. Kapllani. Ndërkohë që referuar vendimit të mbledhjes së asamblesë së ortakëve, të datës 16.2.2018, të vënë në dispozicion nga vetë denoncuesi, ka rezultuar se pasuria tokë arë me të cilën shtetasja E. P. do të këmbente aksionet, ishte në pronësi të shtetasit K. M.
78. Për sa i përket pretendimeve të denoncuesit se subjekti mund të jetë aksioneri në hotelin ku denoncuesi është ortak (që sipas këtij të fundit ka nisur aktivitetin në vitin 2017 – pra, pas deklaratës *Vetting*), si dhe faktit se shkëmbimi i aksioneve nga ortakja E. P. do të bëhej me një pronë të tij, Komisioni ka kryer verifikimet si vijon:
- i) Lidhur me ndonjë pasuri të mundshme në ***, Durrës, nga hetimi administrativ (ASHK, RNSH, FSHU, UKT, bankat e nivelit të dytë etj.), si dhe nga verifikimi në sistemin *online* të ASHK-së, në emër të subjektit dhe personave të lidhur me të nuk ka rezultuar porositja/blerja/kryerja e ndonjë pagese për pasuri të mundshme në këtë adresë.
 - ii) Pavarësisht se të dyja pasuritë ndodhen në ***, Durrës, pasuria tokë arë në pronësi të subjektit ka nr. ***, z. k. ***, vol. ***, fq. ***, me sipërfaqe 1.000 m², ndërsa ajo e

³⁴ Me shkresën nr. *** prot., datë 19.4.2023.

³⁵ Me shkresën nr. *** prot., datë 27.4.2023.

³⁶ Me shkresën nr. *** prot., datë 2.5.2023.

cituar nga denoncuesi ka nr. pasurie ***, z. k. ***, vol. ***, fq. ***, me sipërfaqe 22.000 m².

iii) Nga verifikimet e kryera nga Komisioni, pasuria e llojit arë vijon të jetë në pronësi të tij që nga data 10.11.2012, kur e ka blerë nga shitësi F. I., e deri në momentin e nënshkrimit të kontratës së sipërmarrjes nr. ***, datë 15.3.2017.

79. Për sa i përket marrëdhënies së subjektit me shtetasit A. P., E. P. e A. Sh., subjekti është shprehur në përgjigje të pyetësorit nr. 3 se me këta shtetas nuk ka marrëdhënie shoqërore apo familjare, por i njeh si bashkëpunëtorë biznesi me kunatin e tij, shtetasin B. K.

80. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë³⁷ ka bërë me dije se pas shortimit të çështjeve subjekti i rivlerësimit është caktuar për gjykimin e çështjes nr. *** akti, datë 2.10.2016, në të cilën shtetasi A. P. ka qenë në cilësinë e të padituri. Subjekti ka paraqitur kërkesën për heqjen dorë nga shqyrtimi i çështjes në fjalë, kërkesë e cila është pranuar nga kryetari i Gjykatës.

2.2 Lidhur me analizën financiare të burimeve të krijimit të pasurisë

81. Në deklaratën *Vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se si burim për krijimin e pasurisë në fjalë kanë shërbyer të ardhurat e tij nga paga dhe puna e bashkëshortes si notere.

82. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të përcjellë nga DPT-ja³⁸ ka rezultuar se znj. E. K. është administratore e subjektit “E. K.” me NIPT *** dhe për vitin 2012 ajo ka realizuar fitim në shumën 280.425 lekë. Po ashtu, ky institucion ka përcjellë Deklaratat e Tatimit të Thjeshtuar mbi Fitimin për vitet 2014 – 2020, Deklaratat e Tatimit mbi të Ardhurat Personale të Biznesit të Vogël për vitet 2012 – 2013, si dhe Pasqyrat Financiare për vitet 2014 dhe 2017 – 2020. Në mënyrë të përmbledhur, Komisioni e ka pasqyruar informacionin e përcjellë për secilin vit në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr. 5 – Fitimi i realizuar nga E. K. P. F., për periudhën 2012 – 2016

	2012	2013	2014	2015	2016
Të ardhura	484,666	2,066,762	2,557,109	5,260,224	4,204,124
Shpenzime	204,241	391,992	358,042	1,074,437	1,156,845
Fitimi	280,425	1,674,770	2,199,067	4,185,787	3,047,279
Tatimfitimi			164,930	313,934	

83. Nisur nga forma ligjore në të cilën është regjistruar aktiviteti i bashkëshortes së subjektit si person fizik, detyrimi i saj ka qenë për depozitim pranë administratës tatimore të Deklaratës së Tatimit mbi të Ardhurat Personale të Biznesit të Vogël dhe Deklaratës së Tatimit të Thjeshtuar mbi Fitimin³⁹. Pasqyrat financiare të administruara nga Komisioni, si nga subjekti ashtu edhe nga DPT-ja, janë të fragmentizuara, nuk janë për të gjithë periudhën e analizuar ose në to gjendet vetëm pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve (PASH) dhe, për pasojë, Komisioni nuk është bazuar në informacionin që ato pasqyrojnë.

84. Komisioni ka përfshirë në analizën financiare të kryer për subjektin e rivlerësimit, në zërin e të ardhurave, fitimin e realizuar për secilin vit sipas informacionit dhe dokumentacionit

³⁷ Me shkresën nr. *** prot., datë 31.5.2023.

³⁸ Me shkresën nr. *** prot., datë 20.4.2021.

³⁹ Bazuar në nenin 5.6 “Vendimi për destinimin e fitimit” të UMF-së nr. 5, datë 30.1.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, nuk ka detyrim të depozitohet pranë Administratës Tatimore vendimin e organit kompetent vendimmarrës të shoqërisë lidhur me rezultatet financiare të vitit paraardhës dhe destinimin e fitimit pas tatimit, pasi është biznes i vogël me përgjegjësi tatimore për Tatimin e Thjeshtuar mbi Fitimin.

të përcjellë nga zyra tatimore (Deklaratës së Tatimit mbi të Ardhurat Personale të Biznesit të Vogël dhe Deklaratës së Tatimit të Thjeshtuar mbi Fitimin) dhe në zërin e likuiditeteve, llogaritë bankare në emrin e biznesit, duke u bazuar në korrespondencën e mbajtur me bankat e nivelit të dytë, përveç llogarive të noterit (në monedhat ALL dhe EUR), për tjetërsimin e pasurive.

85. Në analizën financiare janë përfshirë të gjitha të ardhurat dhe shpenzimet për vitin 2012 dhe ka rezultuar se subjekti ka pasur burime të mjaftueshme financiare, siç paraqitet në mënyrë të detajuar në tabelën në vijim

Tabela nr. 6 – Analiza financiare për blerjen e tokës

Nr.	Përshkrimi	2012
1	TË ARDHURA	1,939,286
	Të ardhura nga paga e subjektit	1,120,999
	Të ardhura nga paga e bashkëshortes	700,370
	Të ardhura nga interesat	17,917
	Shitje automjeti Ford Fiesta, me targë *** (kontratë datë 11.6.2012)	100,000
2	SHPENZIME	1,482,051
	Shpenzime jetese sipas ILDKPKI-së	423,072
	Shpenzime TIMS	493,003
	Shpenzime shkollimi	279,440
	Shpenzime rivlerësimi për apartamentin në Tiranë	59,284
	Shpenzime kredia NBG Bank (25.000 euro) (principal + interes)	227,252
3	PASURI	102,321
	Pasuri e paluajtshme/e luajtshme	
	Parcelë e llojit arë me sip. 1000 m ² , në ***, Durrës (10.11.2012)	200,000
	<i>Ndryshim likuiditeti</i>	(97,679)
4	DIFERENCA (1-2-3)	354,913

86. Në përfundim të sa më sipër, Komisioni ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit dhe familja e tij kanë pasur mundësi financiare të investojnë në blerjen e pasurisë tokë arë, si dhe të përballojnë shpenzimet e tjera familjare.

3. Automjet tip “Toyota” me targë *, në vlerën 6.000 euro**

87. Subjekti ka deklaruar në deklaratën *Vetting* automjetin tip “Toyota Rav 4” me targë ***, në vlerën 6.000 euro, në bashkëpronësi me bashkëshorten⁴⁰. Pasuria në fjalë është përfituar nëpërmjet kontratës nr. ***, datë 8.8.2016, nga shitësi K. A. Si burim krijimi të kësaj pasurie, subjekti ka deklaruar të ardhurat nga paga dhe kursimet familjare.
88. DPSHTRR-ja⁴¹ ka konfirmuar se znj. E. K. ka në pronësi mjetin në analizë, si dhe është përcjellë dosja përkatëse. Nga shqyrtimi i saj ka rezultuar se shitësi e kishte përfituar këtë automjet nga shoqëria “****” në Itali, sipas faturës së datës 14.6.2016, në vlerën 7.500 euro. Referuar deklaratës doganore, automjeti në fjalë është zhdoganuar në datën 29.6.2016, në

⁴⁰ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratën *Vetting* kopje të praktikës së noterit (kontrata, deklarata doganore etj.) dhe kopje të lejes së qarkullimit në emër të znj. E. K.

⁴¹ Me shkresën nr. *** prot., datë 31.3.2021.

vlerën 212.965 lekë. Ndërsa subjekti e ka përfituar këtë automjet rreth një muaj më pas, në vlerën 6.000 euro.

89. Nëpërmjet pyetësorit nr. 2, Komisioni e ka ftuar subjektin të paraqesë shpjegime lidhur me çmimin e blerjes së automjetit në analizë, në vlerën 6.000 euro, ndërkohë që vetë shitësi e kishte blerë atë një muaj më parë në vlerën 7.500 euro. Në përgjigje të këtij pyetësi, subjekti ka shpjeguar se bëhej fjalë për një okazion dhe se njohja dhe takimi me shitësin ishte krejt rastësore, përmes një njoftimi publik që ai kishte bërë. Subjekti ka deklaruar se me shitësin nuk ka diskutuar për çmimin e mëparshëm të mjetit, por ka rënë dakord për çmimin e ofruar prej 6.000 euro, shumë e cila është paguar *cash* prej subjektit.
90. Në lidhje me shtetasin K. A., subjekti ka deklaruar se nuk ka pasur dhe nuk ka marrëdhënie shoqërore/njohjeje përveçse marrëdhënies kontraktuale për shitjen e automjetit në fjalë. Ai është shprehur se në asnjë rast nuk ka gjykuar ndonjë çështje me palë ndërgjyqëse ose kërkues këtë shtetas.
91. Përgjatë hetimit administrativ, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë⁴² ka konfirmuar se nuk kanë rezultuar çështje të shqyrtuara nga subjekti me palë shtetasin K. A.
92. SPAK⁴³ ka bërë me dije se në emër të shtetasit të sipërpërmendur nuk është regjistruar ndonjë procedim penal.
93. Komisioni kreu analizën financiare në datën e investimit, duke përfshirë të ardhurat dhe shpenzimet e identifikuara. Lidhur me të ardhurat e përfituara nga aktiviteti privat i bashkëshortes së subjektit, ato janë përlllogaritur në masën 1.777.579 lekë⁴⁴, duke e ndarë në mënyrë të barabartë për secilin muaj fitimin e realizuar gjatë vitit 2016.

Tabela nr. 7 – Analiza financiare për blerjen e automjetit

Nr.	Përshkrimi	8.8.2016
1	TË ARDHURA	2,644,417
	Të ardhura nga paga e subjektit	865,486
	Të ardhura nga paga e bashkëshortes	1,777,579
	Të ardhura nga interesat	1,352
2	SHPENZIME	704,861
	Shpenzime jetese sipas ILDKPKI-së	411,411
	Shpenzime TIMS	293,450
3	PASURI	1,783,232
	Pasuri e paluajtshme/e luajtshme	
	Automjet Toyota (8.8.2016)	811,620
	<i>Ndryshim likuiditeti</i>	971,612
4	DIFERENCA (1-2-3)	156,325

94. Nga analiza e kryer ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit dhe familja e tij kanë pasur mundësi financiare të investojnë në blerjen e pasurisë së luajtshme automjet, si dhe të përballojnë shpenzimet e tjera familjare.

⁴² Me shkresën nr. *** prot., datë 27.4.2023.

⁴³ Me shkresën nr. *** prot., datë 2.5.2023.

⁴⁴ 3.047.279 lekë ÷ 12 muaj x 7 muaj.

95. Në përfundim, lidhur me konstatimin se subjekti e ka përfitur automatikisht në një vlerë më të ulët nga sa e kishte përfitur vetë shitësi, trupi gjykues, në referencë edhe të qëndrimit të mbajtur nga Kolegji⁴⁵, çmon të nënvizojë faktet se:
- Së pari, në blerjen e kësaj pasurie çmimi i përcaktuar sipas vullnetit të lirë të palëve kontraktuale, i pashoqëruar me ndonjë situatë konflikti interesi në raport me shitësin, nuk mund të jetë *apriori* përcaktues i kushteve të “trajtimit preferencial”, në kuptim të nenit 23, pika 1 e ligjit nr. 9367/2005, i ndryshuar, i cili parashikon se: “*Është e ndaluar që një zyrtar të kërkojë ose të marrë, në mënyrë të drejtpërdrejtë a të tërthortë, dhurata, favore, premtime ose trajtime preferenciale, të cilat i jepen për shkak të pozicionit të tij, nga një individ, person fizik ose juridik privat*”, vetëm për faktin se çmimi i blerjes nga subjekti është më i ulët nga çmimi i blerjes nga shitësi i automatizimit.
 - Së dyti, duke qenë se nga analiza financiare subjekti ka rezultuar me burime të ligjshme të mjaftueshme për krijimin e pasurisë, trupi gjykues i ka vlerësuar shteruese dhe bindëse shpjegimet e subjektit.
96. Për sa më sipër, të dyja këto aspekte, të cilat mund të lidheshin në parim me momentin kohor objekt rivlerësimi kalimtar, kanë rezultuar pa problematika.
- 4. Llogari bankare në Raiffeisen Bank, në vlerën 11.508,10 lekë, si dhe llogari e pagës në Credins Bank, në vlerën 989.161 lekë, në emër të z. Flamur Kapllani**
97. Bashkëlidhur deklaratës *Vetting*, subjekti ka paraqitur vërtetimin nr. *** prot., datë 26.1.2017, nga Raiffeisen Bank, ku evidentohet gjendja në llogarinë rrjedhëse në shumën 200.808,07 lekë.
98. Raiffeisen Bank⁴⁶ ka përcjellë dokumentacionin, sipas së cilit ka rezultuar se:
- Në llogarinë nr. ***, z. Kapllani i është kredituar paga deri në vitin 2010. Gjendja e kësaj llogarie, e cila në të njëjtën kohë është edhe *overdraft*, në datën 27.1.2017, kur është depozituar deklarata *Vetting*, ka qenë në vlerën 10.808,07 lekë.
 - Në llogarinë rrjedhëse nr. ***, gjendja në datën 27.1.2017, kur është depozituar deklarata *Vetting*, ka qenë në vlerën 149,08 lekë.
 - Në llogarinë Master Card nr. ***, gjendja në datën 27.1.2017, kur është depozituar deklarata *Vetting*, ka qenë në vlerën 0,25 euro.
99. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës edhe vërtetimin nr. *** prot., datë 25.1.2017, nga Credins Bank, ku ka rezultuar se z. Flamur Kapllani ka llogari bankare në vlerën 989.161 lekë.
100. Credins Bank⁴⁷ ka bërë me dije se z. Flamur Kapllani ka llogari page në këtë bankë, nga viti 2010 e në vijim. Gjendja e kësaj llogarie në datën 27.1.2017, kur është depozituar deklarata *Vetting*, ka qenë në vlerën 988.461,65 lekë.
101. Për sa më sipër, nuk janë evidentuar problematika lidhur me llogaritë bankare të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit.

⁴⁵ Referuar vendimit nr. 42, datë 18.11.2022.

⁴⁶ Me shkresën nr. *** prot., datë 29.3.2021.

⁴⁷ Me shkresën nr. *** prot., datë 31.5.2021.

5. Kredi për blerjen e banesës në NBG Bank, në vlerën 25.000 euro, likuiduar në datën 20.3.2015

102. Në DIPP-në e vitit 2005, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar kontratë kredie në NBG Bank në vlerën 25.000 euro, për blerje apartamenti. Në deklaratat periodike në vijim ai ka deklaruar shumën e paguar dhe atë të mbetur nga kjo kredi deri në vitin 2015, ku ai ka deklaruar likuidimin total të kredisë në fjalë.
103. Nga hetimi⁴⁸ ka rezultuar se përveç kësteve mujore, të paguara për secilin vit, subjekti ka kryer dy pagesa për shlyerje të parakohshme të kësaj kredie. Konkretisht, në vitin 2009 ai ka depozituar shumën 10.000 euro dhe në vitin 2015 ka depozituar shumën 11.320 euro, për të mbyllur totalisht kredinë.
104. Në përgjigje të pyetësorit nr. 4, subjekti ka shpjeguar se si burim për shlyerjen para kohe të kredisë në vitin 2009 kishin shërbyer kursimet *cash* të deklaruara në DPV-në e vitit 2008, paratë e tërhequra nga bashkëshortja në llogaritë e saj bankare dhe kursimet nga pagat e realizuara brenda vitit. Për shlyerjen në shumën 11.320 euro, në datën 20.3.2015, kanë shërbyer të ardhurat nga punësimi i tij dhe bashkëshortes. Subjekti ka sqaruar se në datën 20.3.2015 ka tërhequr nga llogaria e tij bankare në Credins Bank shumën 1.000.000 lekë. Pjesa tjetër, për të plotësuar shumën, është marrë nga fitimi i realizuar nga aktiviteti i bashkëshortes, notere.
105. Në deklaratat periodike subjekti ka deklaruar gjendje *cash*, si vijon:
- në DIPP-në e vitit 2008, kursime *cash* në shumën 500.000 lekë;
 - në DIPP-në e vitit 2009, tërheqje të depozitave bankare të bashkëshortes nga BKT dhe ProCredit Bank në shumën 500.000 lekë;
 - në DIPP-në e vitit 2010, gjendje *cash* në banesë në shumën 200.000 lekë;
 - në DIPP-të e viteve 2011 – 2016 nuk ka deklaruar gjendje *cash*.
106. Lidhur me deklaratimet e gjendjes *cash* si më sipër, në përgjigje të pyetësorit nr. 4, subjekti ka sqaruar se: *“Shumat e tërhequra nga depozitat bankare të bashkëshortes nga BKT e ProCredit Bank, së bashku me gjendjen cash të deklaruar në vitin 2008, janë përdorur për shlyerjen e kredisë në vitin 2009. Qartësoj se vlera 200.000 lekë e kursyer në vitin 2010 është pakësuar në vitin 2011. Pas këtij viti nuk kam pasur kursime në cash. Vitet kur unë kam deklaruar gjendjen cash kanë qenë viti 2008 dhe viti 2010. Ndërsa përveç vitit 2003, që është deklarata ime e parë e pasurisë dhe pakësimi i kursimeve ka ndodhur në fillim të vitit 2004 (vetëm 20 ditë pas datës 31.12.2003) dhe shumë kohë përpara se të paraqitej në ILDKPKI deklarata e parë e pasurisë, kam pasur gjendje cash dhe në vitin 2006, që vinte si rezultat i kredisë së marrë në Raiffeisen Bank, e cila u tërhoq por nuk u përdor për qëllimin e marrjes. Kjo shumë u pakësua në vitin 2007 për shlyerjen e kredisë. Këtë fakt e kam deklaruar edhe në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI. Deklarime të tjera për gjendje cash nuk kam kryer, pasi pas vitit 2010 nuk kam pasur të tilla”.*
107. Komisioni, nisur nga deklaratimet periodike të subjektit, shpjegimet e dhëna gjatë hetimit, si dhe nga procesverbali i mbajtur në mars të vitit 2011 në ILDKPKI, vlerëson se vlerat e gjendjeve *cash* ndër vite duhet të konsiderohen edhe në analizën financiare përkatëse, sikurse janë përshkruar në tabelën në vijim.

⁴⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 24.3.2021, nga ABI Bank (ish-NBG Bank).

Tabela nr. 8 – Gjendja cash ndër vite

Viti	2003 ⁴⁹	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011-2016
Shuma	1,287,206	-	-	1,000,000	-	500,000	-	200,000	-

108. Komisioni ka analizuar mundësinë financiare për shlyerjen e parakohshme të kësaj kredie në datë 9.2.2009 dhe 20.3.2015, nga e cila subjekti ka rezultuar me një balancë negative në masën 307.019 lekë, për likuidimin pjesor të kredisë në datën 9.2.2009.

109. Për sa më sipër, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe paragrafin 5 të nenit Ç të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i ka kaluar subjektit barrën e provës për të dhënë shpjegime bindëse lidhur me sa më sipër dhe për të paraqitur dokumente ligjore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

110. Subjekti ka pretenduar përfshirjen në analizën financiare të kryer për datën 9.2.2009, të të ardhurave të bashkëshortes nga punësimi pranë Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore, të cilat sipas llogarisë së saj bankare në BKT, deri në datën e mësipërme, kanë qenë në shumën 34.002 lekë.

111. Subjekti ka pretenduar edhe reduktimin e shpenzimeve të udhëtimit të kryer në datat 21-23 janar 2009⁵⁰, në masën 96.019 lekë, që i referohen një vizite pune në Bruksel, udhëtim i mbuluar nga organizatorët.

112. Subjekti ka parashtruar se shpenzimet gjithëpërfshirëse për instrumentin *** deri në vitin 2006 mbuloheshin nga programi ***, i cili jo vetëm mbulonte të gjitha shpenzimet e udhëtimit, por aplikonte edhe dieta shumë të mira për organizatorët, një pjesë e të cilave janë kursyer nga ana e tij, pavarësisht se bazuar në jurisprudencën e trupave të rivlerësimit, të ardhurat nga dietat nuk përfshihen në analizën financiare. Ai ka paraqitur në cilësinë e provës shkresën e Ministrisë së Drejtësisë nr. *** prot., datë 19.6.2024 ku, ndër të tjera, citohet se: *“...sipas dokumentacionit të gjetur në arkiv-protokollin e Ministrisë së Drejtësisë, mbi pjesëmarrjen në seminarin me temë “E Drejta Komunitare Evropiane dhe Pavarësia e Sistemit Gjyqësor dhe Gjykatësve të Lartë të Vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe Turqisë”, të zhvilluar në Bruksel, Belgjikë, në periudhën 22 – 23 janar 2009, ju informojmë se Ministria e Integritit Evropian ka qenë koordinator i aktiviteteve të *** në Shqipëri në vitin 2009. Shpenzimet gjithëpërfshirëse për instrumentin *** deri në vitin 2006 mbuloheshin nga programi ***, ndërsa tashmë këto kosto mbulohen tërësisht nga fondet IPA, ku institucionet e shtetit nuk mbulojnë asnjë kosto shtesë”*.

113. Gjithashtu, subjekti ka pretenduar rishikimin e përlllogaritjes së kryer lidhur me likuidimin e kredisë, sa i takon kursit të këmbimit të euros, duke pretenduar kursin prej 127,6 lekë/euro, sipas të dhënave të marra në arkivin e kursit të këmbimit të Bankës së Shqipërisë, në datën 9.2.2009. Ndërkohë që Komisioni ka përlllogaritur në analizën financiare një kurs këmbimi mesatar të këmbimit lek/euro, në raportin 137,17 lekë/për 1 euro.

⁴⁹ Gjendja cash për vitin 2003 sipas analizës financiare për mundësi kursimi, të kryer për periudhën 1997 – 2003.

⁵⁰ Ndërsa për ditët e tjera të qëndrimit, sikurse ka deklaruar edhe në përgjigje të pyetësorëve të mëparshëm, subjekti ka deklaruar se është akomoduar në banesën në pronësi të shtetasit S. M., i cili është djali i hallës së tij, për të cilin ka paraqitur edhe një deklaratë.

Vlerësimi i Komisionit

114. Pas analizimit të prapësimeve të paraqitura nga subjekti, si dhe pas verifikimeve të kryera, Komisioni ka konstatuar se qëndron pretendimi i tij për marrjen e një page nga ana e bashkëshortes në datën 30.1.2009, në BKT, në shumën 34.002 lekë.
115. Lidhur me pretendimin për heqjen e shpenzimeve për udhëtimin e datave 21.1.2009 – 30.1.2009, subjekti ka depozituar dokumentacionin justifikues që provon se për datat 21-23 janar ai ka udhëtuar për qëllime pune, dhe deklaratën e të afërmit të tij, shtetasi S. M., që provon qëndrimin tek ai pas ditëve të trajnimit. Komisioni korrigjoi shpenzimet e këtij udhëtimi, duke mos përfshirë biletën e udhëtimit dhe koston e qëndrimit për ditët e trajnimit. Ndërsa për ditët që ka qëndruar tek i afërmi, Komisioni ka përlllogaritur 7 ditë qëndrimi, me kosto 5 euro dita.
116. Lidhur me pretendimin për kursin e këmbimit, në këtë rast, meqenëse shuma e paguar për mbylljen e parakohshme të kredisë është tërhequr në monedhën lek dhe është depozituar në monedhën euro, në të njëjtën datë, pra 9.2.2009, Komisioni vlerëson të marrë në konsideratë pretendimin e subjektit, duke aplikuar kursin e këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë, të datës 9.2.2009. Në këtë datë kursi i këmbimit ka qenë 1 euro = 127,6 lekë.
117. Pas përfshirjes në analizë të pretendimeve si më sipër arsyetuar, analiza do të rezultojë me balancë negative në vlerën 82.644 lekë.

Tabela nr. 9 – Likuidimi i kredisë

Nr.	Përshkrimi	9.2.2009
1	TË ARDHURA	175,873
	Të ardhura nga paga e subjektit	136,545
	Të ardhura nga paga e bashkëshortes	34,002
	Të ardhura nga interesat	5,326
2	SHPENZIME	1,361,023
	Shpenzime jetese sipas ILDKPKI-së	34,155
	Shpenzime TIMS	4,801
	Shpenzime kredia NBG Bank (25.000 euro) (principal + interes)	1,322,067
3	PASURI	(1,102,506)
	Pasuri e paluajtshme/e luajtshme	
	<i>Ndryshim likuiditeti</i>	<i>(1,102,506)</i>
	DIFERENCA (1-2-3)	-82,644

118. Në përfundim të sa u parashtua e analizua më sipër, trupi gjykues çmon se balanca negative e mbetur në shumën 82.644 lekë vlerësohet në tërësi me rrethanat e çështjes, që janë përcaktuese për vlerësimin e kriterit të pasurisë apo procesit të rivlerësimit për këtë subjekt.

6. Kredi në Raiffeisen Bank në vlerën 1.000.000 lekë, marrë në datën 5.7.2006, mbyllur në datën 6.9.2007

119. Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar kredi personale për kryerjen e punimeve në banesë në shumën 1.000.000 lekë, disbursuar në datën 5.7.2006 dhe mbyllur në datën 6.9.2007, pasi nuk është përdorur për qëllimin e marrë. Bashkëlidhur deklaratës *Vetting*, subjekti ka paraqitur vërtetimin nr. *** prot., datë 23.1.2017, nga Raiffeisen Bank, ku

citohet se z. Flamur Kapllani e ka mbyllur kredinë në fjalë. Kjo kredi është analizuar më sipër, së bashku me pasurinë apartament në pronësi të subjektit.

120. Komisioni ka analizuar disponibilitetin e subjektit në vitin 2007 për likuidimin e kredisë në shumën 1.000.000 lekë, duke përfshirë edhe një investim të kryer nga subjekti në vitin 2007. Konkretisht, gjatë hetimit ka rezultuar se gjatë vitit 2007 bashkëshortja e subjektit të rivlerësimi ka investuar në blerjen e automjetit tip “Ford Fiesta”, me targë ***.
121. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, lidhur me automjetin në fjalë, subjekti ka paraqitur kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 7.6.2007, me palë shitëse Sh. H. dhe blerëse E. K. Çmimi i shitjes ka qenë në shumën 150.000 lekë.
122. Nga analiza e kryer ka rezultuar se subjekti ka pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare për likuidimin e kredisë, siç evidentohet në tabelën në vijim.

Tabela nr. 10 – Analiza për mbylljen e kredisë në Raiffeisen Bank

Nr.	Përshkrimi	2007
1	TË ARDHURA	918,861
	Të ardhura nga paga e subjektit	836,821
	Të ardhura nga paga e bashkëshortes	70,022
	Të ardhura nga interesat	12,018
2	SHPENZIME	1,849,114
	Shpenzime jetese sipas ILDKPKI-së	409,860
	Shpenzime transporti	21,000
	Kredi në Raiffeisen Bank, komision për mbylljen	16,789
	Kredi në NBG Bank (25.000 euro) principal + interes)	317,244
	Shpenzime ekstra kredia NBG Bank	15,805
	Kredi në Raiffeisen Bank (1.000.000) (principal + interes)	1,068,415
3	PASURI	(730,331)
	Automjet Ford Fiesta (7.6.2007)	150,000
	<i>Ndryshim likuiditeti</i>	(880,331)
	DIFERENCA (1-2-3)	(199,922)

123. Për sa më sipër, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe paragrafin 5 të nenit Ç të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i ka kaluar subjektit barrën e provës për të dhënë shpjegime bindëse lidhur me mungesën e burimeve të ligjshme të rezultuara në masën 199.922 lekë për mbylljen e kredisë në Raiffeisen Bank, blerjen e automjetit, si dhe për të përballuar shpenzimet e tjera familjare.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

124. Subjekti ka pretenduar përfshirjen në analizën financiare të të ardhurave të përfituara nga bashkëshortja e tij nga puna si përkthyes, të deklaruara për vitin 2006 dhe në DPV-në e vitit 2007, në shumën 550.000 lekë. Subjekti ka parashtruar se është në pamundësi për t'i provuar me dokumentacion këto të ardhura, për shkak të kohës së largët, projektit të huaj i cili nuk është më prezent në Shqipëri, si dhe për faktin që janë deklaruar në kohë reale. Subjekti ka pretenduar nga Komisioni që të bëhet një vlerësim, duke balancuar shpenzimet e jetesës me këto të ardhura, duke mbajtur në konsideratë të dhënat indirekte që vërtetojnë ekzistencën e këtyre të ardhurave, si dhe t'i vlerësojë ato me proporcionalitet.

Vlerësimi i Komisionit

125. Trupi gjykues ka arsyetuar më sipër qëndrimin lidhur me pretendimin e subjektit sa i takon të ardhurave të përfituara gjatë vitit 2007 nga bashkëshortja e tij si përkthyes, duke konkluduar se ato nuk përmbushin kriteret e përcaktuara në nenin D të Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, situata financiare mbetet e njëjtë, sikurse është paraqitur në tabelën e mësipërme.

Deklarimi i bashkëshortes së subjektit – znj. E. K.

1. Apartament me sipërfaqe 62,2 m², me nr. pasurie *, z. k. ***, Tiranë, në bashkëpronësi, në masën 1/8 të apartamentit**

126. Në deklaratën *Vetting* të personit të lidhur, bashkëshortja e subjektit ka deklaruar se ka në bashkëpronësi 1/8 e apartamentit me sipërfaqe 62,2 m², me nr. pasurie ***, z. k. ***, rruga “***”, Tiranë, trashëguar nga babai i saj, i ndjeri B. K. Bashkëlidhur deklaratës *Vetting* ka rezultuar dëshmia e trashëgimisë ligjore nr. ***, datë 7.10.2013, si dhe dokumenti hipotekor nr. ***, datë 23.10.2013, ku evidentohet rivlerësimi i pasurisë në shumën 7.370.700 lekë.

127. ASHK Tirana Jug, me shkresën nr. *** prot., datë 23.4.2021, ka konfirmuar se znj. E. B. K. (K.) figuron bashkëpronare e pasurisë apartament me sipërfaqe 62,2 m², z. k. ***, volum ***, faqe ***. Bashkëlidhur ka rezultuar kontratë shitjeje pasurie datë 28.2.1996, me palë shitëse Enti Kombëtar i Banesave dhe palë blerëse L. S., të apartamenti me sipërfaqe 62,2 m², në rrugën “***”, Tiranë, në vlerën 124.563 lekë, si dhe vërtetim pronësie nr. ***, datë 28.2.1996 dhe harta treguese e pasurisë. Në vijim, pasuria në fjalë është blerë nga z. K. nëpërmjet kontratës nr. ***, datë 27.12.2001, nga shitësi L. S., në vlerën 3.900.000 lekë.

128. Në DIPP-në e vitit 2004, si dhe në përgjigje të pyetësorit nr. 1, subjekti ka deklaruar adresën në fjalë si adresë vendbanimi, për periudhën janar 2002 deri në fund të muajit dhjetor 2005. Në këtë apartament subjekti ka deklaruar se ka banuar së bashku me bashkëshorten, djalin, vjehrrin dhe vjehrrën, të cilët kanë jetuar pa qira në apartamentin në analizë. Subjekti ka deklaruar se shpenzimet për jetesë të familjes janë përballuar prej tij dhe bashkëshortes. Në mbështetje të deklaratimit të tij, subjekti ka paraqitur një vërtetim nga dokumenti hipotekor nr. ***, datë 23.10.2013, i pasurisë apartament nr. ***, i ndodhur në Tiranë, rruga “***”, z. ***.

129. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka deklaruar se blerja e apartamentit nga prindërit e bashkëshortes erdhi si rezultat i shkëputjes së marrëdhënies së tyre të punës në qytetin e Kavajës. Subjekti ka shpjeguar se gjatë vitit 2002 vjehri filloi marrëdhënien e punës me shoqërinë “***” sh.p.k., ndërsa vjehra e tij në fillim të vitit 2003 filloi të ushtrojë aktivitetin “market” në Tiranë.

130. Si burim krijimi për blerjen e apartamentit në Tiranë kanë shërbyer të ardhurat nga shitja e apartamentit në Kavajë sipas kontratës nr. ***, datë 4.12.2001, kundrejt çmimit 3.500.000 lekë, si dhe kursimet e tyre deri në momentin e blerjes së apartamentit në Tiranë.

131. Nga shqyrtimi i dokumentacionit justifikues⁵¹ të paraqitur nga subjekti, për të provuar të ardhurat e prindërve të bashkëshortes është konstatuar se nuk pasqyrohen të ardhurat për të

⁵¹ Subjekti ka depozituar korrespondencën e mbajtur me ISSH/Drejtoria Rajonale Tiranë, dega e arkivit, ku kjo e fundit i ka vendosur në dispozicion dosjen e pensionit, librezë pune, si dhe vërtetimet për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare për prindërit e bashkëshortes.

- gjitha vitet e punësimit në raport me dosjen e pensionit. Vlera e përfituruar për periudhën 1994 – 2001, por e fragmentizuar për të dy bashkëshortët, është 644.147 lekë.
132. Gjithashtu, ISSH-ja gjatë hetimit ka bërë me dije nëpërmjet Drejtorisë Rajonale Tiranë⁵² se znj. V. K. trajtohet me pension pleqërie nga data 7.3.2011 dhe z. B. K. është trajtuar me pension pleqërie nga data 2.3.2004 deri më 30.6.2011.
133. Gjithashtu, subjekti ka shpjeguar se gjatë gjithë periudhës që kanë jetuar së bashku në këtë pasuri nuk janë bërë shpenzime, pasi orenditë shtëpiake të domosdoshme kanë qenë ekzistuese në banesën në Kavajë, nga ku më tej janë transferuar për në adresën tjetër në Tiranë, në rrugën “****”. Ky apartament është blerë prej tyre në datën 27.12.2001 kundrejt çmimit 3.900.000 lekë, përpara se subjekti dhe familja e tij të fillonin bashkëjetesën me ta.
134. Subjekti ka vënë në dispozicion shkresën nr. *** prot., datë 15.6.2023, në të cilën FSHU-ja bën me dije se kontrata nr. ***, me kod klienti ***, është lidhur në datën 15.1.1998, ndërsa kontrata nr. ***, me kod klienti ***, është hapur në datën 27.6.2005. Me shkresën nr. *** prot., datë 13.6.2023, FSHU-ja, Raiffeisen Bank, dega Kavajë, informon se për kontratën nr. *** nuk ka informacion për periudhën 1997 – 2001, informacioni për pagesat dhe faturimet janë nga janari 2007. Gjithashtu, subjekti ka paraqitur në cilësinë e provës edhe vërtetimin nr. *** prot., datë 13.6.2023, të UKT-së Tiranë, në emër të znj. V. K.
135. Në lidhje me masën e faturimit çdo muaj, FSHU-ja disponon të dhëna për detajet e faturimit duke filluar nga janari 2007. Ujësjetës Kanalizime Durrës, Njësia Operative Kavajë, me shkresën nr. *** prot., datë 12.6.2023, ka bërë me dije se për periudhën 1997 – 2001 nuk disponojnë informacion.
136. Pasi ka ndërruar jetë i ndjeri B. K., me vendimin nr. ***, datë 7.10.2013, për lëshimin e trashëgimisë ligjore, pasuria në fjalë është trashëguar nga shtetasit V. K., E. K., V. K. dhe B. K..
137. Për sa më sipër, përveç deklarimit të subjektit në përgjigje të pyetësorit nr. 1 se pasuria në analizë është përdorur përkohësisht prej tij, pa kundërshtim, në funksion të një marrëdhënieje të posaçme me pronarin (vjezhrrin), si dhe faktit se bashkëshortja e subjektit është bashkëpronare e këtij apartamenti nga trashëgimia ligjore në masën 1/8, Komisioni ka çmuar të marrë në konsideratë edhe faktet si vijon:
- i) subjekti nuk ka rezultuar të ketë kontribuar në blerjen e kësaj pasurie në vitin 2001 nga vjezhrrin i tij;
 - ii) vlera e apartamentit (pjesa më e madhe e saj prej 3.500.000 lekësh) është financuar nga shitja e një apartamenti që prindërit e bashkëshortes së subjektit dispononin më parë;
 - iii) prindërit e bashkëshortes kanë qenë vazhdimisht në marrëdhënie pune deri në momentin e daljes në pension pleqërie.
138. Në analizë të sa më sipër, si dhe në pamundësi për të përlogaritur saktësisht të ardhurat e prindërve të bashkëshortes së subjektit (për shkak të mungesës së të dhënave lidhur me të ardhurat e tyre, ndonëse duket se prindërit e bashkëshortes kanë pasur burime financiare për krijimin e kursimeve, të cilat kanë shërbyer për blerjen e kësaj pasurie), Komisioni

⁵² Me shkresën nr. *** prot., datë 24.4.2023.

vlerësoi⁵³ se nuk kishte arsye për kryerjen e hetimeve e verifikimeve të mëtejshme lidhur me burimet e krijimit të kësaj pasurie nga prindërit e bashkëshortes së tij.

139. Për sa më sipër, nuk janë konstatuar problematika me pjesën takuese 1/8 të apartamentit me sipërfaqe 62,2 m², në rrugën “****”, në bashkëpronësi të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit.

2. Llogari bankare në Raiffeisen Bank në emër të znj. E. K., në vlerën 412.223,91 lekë

140. Subjekti ka deklaruar se kjo llogari është krijuar nga paga si juriste në Kukës dhe i ka bashkëlidhur deklaratës vërtetimin nr. *** prot., datë 26.1.2017, nga Raiffeisen Bank, ku konfirmohet se znj. E. K. ka një llogari bankare kursimi ekstra, nr. ***, në vlerën 412.223 lekë.
141. Raiffeisen Bank, me shkresën nr. *** prot., datë 29.3.2021, informon se znj. E. K. ka llogari pranë kësaj banke. Nga analizimi i *statement*-it, llogaria nr. *** është llogari rrjedhëse, depozitë pa afat. Gjendja e saj në datën 27.1.2017, kur është depozituar deklarata *Vetting*, është në vlerën 412.223,91 lekë.
142. Nga hetimi ka rezultuar se bashkëshortja e subjektit ka kryer disa depozitime në llogaritë e saj bankare gjatë vitit 2005. Konkretisht, në datën 14.4.2005 është depozituar shuma 200.000 lekë dhe në datën 29.7.2005 shumat 400.000 lekë, 3.500 euro dhe 1.500 USD.
143. Komisioni kreu analizën financiare në datën 29.7.2005, kur janë kryer këto depozitime, për të parë mundësitë financiare të subjektit të rivlerësimit, dhe ka konstatuar sa vijon:

Tabela nr. 11 – Analiza për depozitimet e kryera në Raiffeisen Bank

Nr.	Përshkrimi	29.7.2005
1	TË ARDHURA	846,438
	Të ardhura nga paga e subjektit	546,114
	Të ardhura nga paga e bashkëshortes	291,667
	Të ardhura nga interesat	8,657
2	SHPENZIME	212,725
	Shpenzime jetese sipas ILDKPKI-së	191,725
	Shpenzime transporti	21,000
3	PASURI	1,397,270
	Pasuri e paluajtshme/e luajtshme	
	<i>Ndryshim likuiditeti</i>	1,397,270
	DIFERENCA (1-2-3)	(763,557)

144. Për sa më sipër, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe paragrafin 5 të nenit Ç të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i ka kaluar subjektit barrën e provës për të dhënë shpjegime bindëse lidhur me pamundësinë financiare të konstatuar në shumën 763.557 lekë, për kryerjen e depozitimeve në Raiffeisen Bank.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

145. Lidhur me depozitat e kryera nga bashkëshortja e subjektit në shumat 400.000 lekë, 3.500 euro dhe 1.500 USD, subjekti ka parashtruar se ato janë depozituar në datën 29.7.2005 dhe janë tërhequr pothuajse në të njëjtën kohë. Vlera 401.787,01 lekë është tërhequr në datën

⁵³ Duke mbajtur në vëmendje edhe qëndrimin, jurisprudencën e mbajtur nga Kolegji i Posaçëm i Apelit – shihni vendimin nr. 7/2020, të Kolegjit.

31.10.2005, ndërsa shumat 3.508,47 euro dhe 1.504,07 USD janë tërhequr në datën 7.11.2005. Burim i parave të depozituara në llogari bankare janë kursimet e nënës së bashkëshortes, por kryesisht të ardhurat e xhiros së aktivitetit. Pra, këto vlera kanë qëndruar në llogari bankare për një periudhë vetëm tremujore. Kjo për shkak se nëna e saj zgjeroi aktivitetin dhe shumat i nevojiteshin për blerjen e mallrave e produkteve. Bashkëshortja i ka tërhequr me gjithë interesat e përfituar dhe ia ka dhënë nënës së saj.

146. Gjithashtu, subjekti ka parashtruar se këto shuma nuk janë deklaruar prej tij në deklaratën periodike vjetore të vitit 2005, së pari për faktin se nuk i përkisnin familjes së tij, por edhe për faktin se depozitimi dhe tërheqja e tyre është kryer brenda një harku kohor prej 3 muajsh, brenda vitit kalendarik. Për rrjedhojë, sipas subjektit, diferenca në shumën 763.557 lekë, e konstatuar nga Komisioni, nuk ekziston. Subjekti ka paraqitur në cilësinë e provës deklaratën noteriale nr. ***, datë 19.6.2024, të nënës së bashkëshortes, znj. V. K., e cila ka referuar situatën që lidhet me depozitimet dhe tërheqjet e shumave në fjalë.

Vlerësimi i Komisionit

147. Nga të dhënat e administruara gjatë hetimit rezulton se nëna e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit ka pasur aktivitet tregtar. Nga qarkullimi i realizuar ka rezultuar se vjehrra e subjektit ka pasur mundësi të krijojë shumën e depozituar në bankë. Po ashtu, fakti që: (i) janë depozituar dhe tërhequr për një kohë të shkurtër (brenda 3 muajsh); (ii) nuk janë përdorur si burim krijimi për ndonjë pasuri të subjektit apo bashkëshortes së tij; (iii) deklarata noteriale e nënës së bashkëshortes së subjektit e cila konfirmon deklarinimin se shumat e depozituara në bankë dhe të tërhequra më pas kanë qenë të saj – krijojnë bindjen se këto likuiditete nuk mund të kenë qenë të familjes së subjektit.

2.1 Llogari bankare në Raiffeisen Bank, në emër të znj. E. K. si person fizik, në vlerën 343.956,34 lekë

148. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës vërtetimin nr. *** prot., datë 26.1.2017, nga Raiffeisen Bank, i cili konfirmon se E. K. , person fizik, ka llogari bankare në vlerën 343.956 lekë dhe llogari në monedhën euro në vlerën 9.999,33 euro.
149. Raiffeisen Bank, me shkresën nr. *** prot., datë 29.3.2021, informon se znj. E. K. ka llogari pranë kësaj banke. Nga analizimi i *statement*-it rezultoi se llogaria nr. *** është llogari biznesi. Gjendja e saj në datën 27.1.2017, kur është depozituar deklarata *Vetting*, ka qenë në vlerën 343.956,34 lekë.

2.2 Llogari bankare në Bankën Kombëtare Tregtar në emër të znj. E. K. si person fizik, në vlerën 2.837.536 lekë

150. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës *Vetting* vërtetimin nr. *** prot., datë 26.1.2017, nga BKT-ja, sipas të cilit znj. E. K. , person fizik, ka një llogari bankare me gjendje në vlerën 2.837.536 lekë.
151. BKT-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 19.4.2024, informon se E. K. , person fizik, me NIPT ***, ka llogari pranë kësaj banke.
152. Nga analizimi i *statement*-it ka rezultuar se:
- Llogaria nr. *** është llogari biznesi në të cilën likuidohen faturat. Gjendja e saj në datën 27.1.2017, kur është depozituar deklarata *Vetting*, ka qenë në vlerën 2.837.236 lekë.

- Llogaria rrjedhëse nr. ***, në monedhën euro, është llogari noteri për tjetërsim pasurish. Gjendja në datën 27.1.2017, kur është depozituar deklarata *Vetting*, ka qenë 0 (zero) euro.
- Llogaria rrjedhëse nr. ***, në monedhën ALL, është llogari noteri për tjetërsim pasurish. Gjendja në datën 27.1.2017, kur është depozituar deklarata *Vetting*, ka qenë 0 (zero) lekë.

2.3 Llogari dyemërore në emër të shtetaseve V. K. dhe E. K. në BKT

153. BKT-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 5.3.2021, ka informuar se shtetasja V. K. ka pasur llogari në BKT me të dhënat:

- V. K. ose E. K. , nr. llogarisë ***, në monedhën lek, mbyllur më 21.5.2012;
- V. K. ose E. K. , nr. llogarisë ***, në monedhën euro, mbyllur më 21.5.2012.

154. Nga analizimi i *statement*-it ka rezultuar se në llogarinë nr. *** janë kryer transaksionet si vijon:

- në datën 27.2.2004 është depozituar shuma 150.000 lekë. Kjo shumë është investuar në depozitë me afat dhe ka gjeneruar interesa deri më 25.9.2006, pasi në këtë datë është tërhequr shuma 163.099,37 lekë (shuma e investuar së bashku me interesat e përfituar);
- në datën 20.7.2007 është depozituar shuma 900.000 lekë. Kjo shumë është investuar në depozitë dhe më pas është tërhequr në datën 4.9.2007 vlera 870.000 lekë. Shuma e mbetur prej 30.000 lekësh është investuar në depozitë dhe është tërhequr në datën 24.2.2009 së bashku me interesat e përfituar në shumën 31.648,47 lekë;
- në datën 21.2.2008 është depozituar shuma 1.470.000 lekë, e cila është investuar në depozitë dhe është tërhequr më 23.2.2009 së bashku me interesat e përfituar në shumën 1.553.609,8 lekë;
- në datën 14.4.2008 është depozituar shuma 400.000 lekë, e cila është investuar në depozitë dhe është tërhequr më 15.4.2009 së bashku me interesat e përfituar në shumën 424.365,11 lekë;
- në datën 10.9.2008 është depozituar shuma 300.000 lekë, e cila është investuar në depozitë dhe është tërhequr në datën 22.9.2009 së bashku me interesat e përfituar në shumën 320.177,69,8 lekë.

155. Ndërsa në llogarinë nr. *** janë kryer transaksionet si vijon:

- a) në datën 26.5.2008 është depozituar shuma 4.000 euro;
- b) kjo shumë është investuar në depozitë me afat dhe më pas tërhequr: në datën 21.1.2009 shuma 3.500 euro, në datën 22.2.2009 shuma 500 euro dhe në datën 4.2.2009 shuma 500 euro.

156. Komisioni e ka pyetur subjektin lidhur me llogaritë dyemërore, i cili në përgjigje të pyetësorit nr. 3 ka deklaruar se bashkëshortja e tij nuk ka qenë në dijeni dhe se është vënë në dijeni të ekzistencës së saj në momentin e dërgimit të pyetësorit. Ai ka sqaruar se kjo llogari është hapur vetëm nga nëna e bashkëshortes, e cila me vullnet të lirë ka vendosur si emër të dytë në këtë llogari edhe vajzën e saj. Në mbështetje të deklarimit të tij, subjekti ka paraqitur përgjigjen e datës 18.7.2019 nga BKT-ja, në të cilën citohej se llogaria në fjalë (me nr. ***) ishte hapur në datën 27.2.2004 dhe mbyllur në datën 21.5.2012, kopje të librezave të depozitave, si dhe kopje të transaksioneve të kryera në këtë llogari. Subjekti ka shpjeguar se si burim për krijimin e kësaj llogarie nga vjehrra e tij kanë shërbyer të ardhurat

nga aktiviteti tregtar i ushtruar prej saj. Ai ka paraqitur shkresën nr. *** prot., datë 15.6.2023, të Drejtorisë së Përgjithshme të taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Tiranë, në të cilën citohet se personi fizik “V. K.” gjatë viteve 2003 – 2007 ka paguar në mënyrë të rregullt taksat vendore. Subjekti tregtar ka likuiduar: për vitin 2003 në total 39.660 lekë; për vitin 2004 në total 19.904 lekë; për vitin 2005 në total 19.904 lekë; për vitin 2006 në total 22.104 lekë; për vitin 2007 në total 90.804 lekë; për vitin 2008 në total 3.304 lekë.

157. Gjithashtu, subjekti ka paraqitur shkresën nr. *** prot., datë 15.6.2023, nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, në të cilën pasqyrohet xhiroja e deklaruar dhe tatimi i paguar për periudhën 2003 – 2005 nga personi fizik “V. K.”, si vijon:

- viti 2003, xhiroja e deklaruar ka qenë 700.000 lekë dhe tatimi i paguar 28.000 lekë;
- viti 2004, xhiroja e deklaruar 1.250.000 lekë dhe tatimi i paguar 50.000 lekë;
- viti 2005, xhiroja e deklaruar 1.650.000 lekë dhe tatimi i paguar 50.000 lekë.

158. Në vijim të hetimit, subjekti ka depozituar⁵⁴ shkresën e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve nr. *** prot., datë 15.5.2024, për subjektin tatimpagues V. K. Kjo shkresë në përmbajtje citon se: *“Personi fizik V. K., me NIPT ***, është regjistruar për ushtrimin e aktivitetit tregtar me pakicë në dyqane jo të specializuara të artikujve ushqimorë, pije, duhan etj., me datë regjistrimi 6.2.2003. Aktualisht personi i tatueshëm rezulton i çregjistruar që prej datës 21.3.2008. Gjatë gjithë periudhës së aktivitetit, tatimpaguesi ka funksionuar si subjekt i biznesit të vogël pa TVSH dhe ka shlyer detyrimet përkatëse sipas kuadrit ligjor rregullues të kohës”*.

Subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se: *“Bazuar në ligjin nr. 9632, “Për sistemin e taksave vendore”, është përcaktuar për vitin 2007 se tatimpaguesit e regjistruar dhe që ushtrojnë aktivitet me objekt “Shitje me pakicë” dhe qarkullim vjetor në nivelin 2-3 milionë lekë duhet të paguajnë taksën e biznesit të vogël në shumën 68.000 lekë (referohu Aneksit nr. 5 të ligjit). Sikurse rezulton nga shkresa nr. *** prot., datë 15.6.2023, vjehrra V. K. ka paguar për vitin 2007 shumën gjithsej prej 68.000 lekësh (ose 17.000 lekë për çdo tremujor). Për periudhat e mëparshme detyrimi për deklarim ka qenë në administratën tatimore, sikurse konfirmon edhe shkresa e marrë nga DPT-ja. Për vitin 2008, niveli i qarkullimit ka qenë 0-2 milionë lekë, pasi ka qenë edhe periudha që vjehrra ka mbyllur aktivitetin tregtar”*.

159. Komisioni ka analizuar dokumentacionin dhe përgjigjet e administruara nga DRT Tiranë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Tiranë, si dhe në referim të ligjit nr. 9632, “Për sistemin e taksave vendore”, dhe i rezulton se qarkullimi i realizuar për vitet 2003 – 2008 është në shumën 8.100.000 lekë. Për vitet 2003 – 2005, qarkullimi është i konfirmuar nga zyra tatimore. Ndërsa për periudhën 2006 – 2008 Komisioni, nisur nga taksat vendore të paguara, ka vlerësuar që për qarkullimin që i korrespondon masës 0-2 milionë ka marrë mesataren, shumën 1.000.000 lekë, dhe për qarkullimin që i korrespondon masës 2-3 milionë ka marrë mesataren, shumën 2.500.000 lekë, si më poshtë pasqyruar:

⁵⁴ Me pyetësin nr. 4, datë 8.5.2024.

Tabela nr. 12 – Qarkullimi i realizuar nga V. K., person fizik

Viti	Qarkullimi
2003	700,000
2004	1,250,000
2005	1,650,000
2006	1,000,000
2007	2,500,000
2008	1,000,000
TOTAL	8,100,000

160. Në raport me qarkullimin e realizuar prej 8.100.000 lekësh dhe shumës totale të depozituar në llogaritë dyemërore prej 2.692.730 lekësh duket se kjo shumë mbulohet me burime të ligjshme.
161. Komisioni ka analizuar dokumentacionin e administruar lidhur me llogarinë bankare në fjalë dhe ka konstatuar se bashkëshortja e subjektit nuk ka kryer asnjë transaksion (derdhje apo tërheqje) në këtë llogari, por ato janë kryer vetëm nga znj. V. K. Po ashtu, nuk ka rezultuar që bashkëshortja e subjektit të ketë nënshkruar ndonjë kontratë apo dokument tjetër për hapjen e llogarisë në fjalë, e cila është mbyllur në datën 21.5.2012.
162. Në referencë të nenit 199, paragrafi i dytë i Kodit Civil, i cili parashikon se: “*Pjesët e bashkëpronarëve janë të barabarta, gjersa nuk vërtetohet e kundërta*”, pjesa takuese e znj. E. K. në këtë llogari është 50%. Në kuptim të këtij përcaktimi ligjor, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit *de jure* ka gëzuar të njëjtat të drejta e detyrime për llogarinë bankare në fjalë, sikurse edhe nëna e saj, e cila e ka hapur këtë llogari. Megjithatë, duke vlerësuar të gjitha të dhënat e administruara përgjatë hetimit administrativ në lidhje me këtë llogari, si dhe duke mbajtur në konsideratë faktet se: (i) vjehrra e subjektit ka vërtetuar me dokumentacion provues aftësinë financiare për të krijuar llogarinë në fjalë; (ii) nga hetimi nuk rezultoi që subjekti i rivlerësimit apo bashkëshortja e tij të kishin kontribuar në krijimin dhe gjendjen e kësaj llogarie bankare ndër vite (apo të kishin përdorur pjesë të saj); (iii) llogaria në fjalë është mbyllur në vitin 2012, pasi znj. V. K. e ka tërhequr personalisht të gjithë shumën përkatëse; (iv) deklarimi i subjektit se ai dhe bashkëshortja janë vënë në dijeni të ekzistencës së kësaj llogarie vetëm pas dërgimit të pyetësorit nga Komisioni; si dhe faktin se (v) nuk rezultoi asnjë e dhënë që subjekti i rivlerësimit apo bashkëshortja e tij të kishin përdorur të ardhurat e disponuara në këtë llogari, si burim për krijimin e ndonjë pasurie të mundshme, apo për të përballuar shpenzime të caktuara – vendosja e llogarisë në dy emra duket se është bërë në kuadër të marrëdhënieve të posaçme familjare nënë e bijë, pa sjellë ndonjë efekt konkret financiar për subjektin apo familjen e tij.
163. Në përfundim, në një vlerësim të harmonizuar të rrethanave të mësipërme, të kuadrit ligjor e të qëllimit të procesit të rivlerësimit kalimtar, si dhe në referencë edhe të qëndrimit të mbajtur nga Kolegji në një rast të ngjashëm⁵⁵, duket se nuk rezultoi që subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij të kishin kontribuar në krijimin dhe gjendjen e kësaj llogarie apo të kishin përdorur të ardhurat e disponuara në këtë llogari, si burim për krijimin e ndonjë pasurie të mundshme, apo për të përballuar shpenzimet e tyre, për rrjedhojë, për sa kohë gjendemi edhe në prezencën e një marrëdhënieje të posaçme (nënë-bijë), duket se nuk janë konstatuar problematika lidhur me këtë depozitë.

⁵⁵ Vendimi nr. 31, datë 18.11.2020, paragrafi 47.

Deklarimi i djalit të subjektit – z. J. K.

1. Depozitë garanci në BKT për vizë gjermane pranë Ambasadës Gjermane, në vlerën 8.640 euro

164. Në DIPP-në e vitit 2015, si dhe në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar “Garanci për vizë gjermane” në BKT, në vlerën 8.640 euro. Bashkëlidhur deklaratës ai ka paraqitur vërtetimin nr. *** prot., datë 26.1.2017, nga BKT-ja, e cila konfirmon se z. Jürgen Kapllani ka llogari me gjendje në vlerën 8.640 euro.
165. BKT-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 19.4.2024, informon se z. J. K. ka llogari pranë kësaj banke. Gjendja në datën 27.1.2017, kur është depozituar deklarata *Vetting*, ka qenë në vlerën 8.640 euro.
166. Në përgjigje të pyetësorëve nr. 1 dhe 2, subjektit ka paraqitur një urdhër për transfertë bankare, si dhe ka shpjeguar se si burim për krijimin e shumës 8.640 euro kanë shërbyer të ardhurat e siguruara nga aktiviteti i bashkëshortes si notere. Kalimi i shumës është bërë me transfertë nga BKT-ja. Nga llogaria bankare e personit fizik me nr. *** është transferuar në datën 27.10.2016 shuma 3.871.277, 1 lekë, në llogarinë po të personit fizik me nr. ***. Nga kjo llogari e fundit, në datë 1.11.2016 është transferuar shuma 1.180.224 lekë, me kurs këmbimi 136,6 lekë, ose 8.640 euro, në llogarinë përfituese të djalit në BKT, me përshkrimin “Kalim shume, garanci për studime, kurs gjuhe në Gjermani”.
167. Në përfundim të sa është analizuar e përshkruar më sipër, është konstatuar se burimi i krijimit të kësaj depozite është nga të ardhurat e aktivitetit të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit. Komisioni ka verifikuar dhe konfirmuar veprimet e përshkruara dhe të gjitha transaksionet janë kryer me bankë. Komisioni kreu analizën financiare dhe nuk i kanë rezultuar problematika.
168. Për sa më sipër, lidhur me të gjitha llogaritë bankare të analizuar në këto rezultate, Komisioni i ka përfshirë ato sipas datës së çeljes dhe mbylljes në analizën financiare të detajuar për secilin vit. Në analizën financiare nuk janë përfshirë llogaritë dyemërore, pasi nuk rezultoi ndonjë e dhënë që të provonte se bashkëshortja e subjektit ishte kontribuuese apo përfituese e tyre.

KONSTATIME TË TJERA

1. Lidhur me disa pasuri të tjera të përfituara nga subjekti nga trashëgimia e babait të subjektit

169. ASHK Tirana Jug⁵⁶ ka konfirmuar në emër të z. Sh. K. (babai i subjektit) dy pasuri, konkretisht:
- *truall me sipërfaqe 57 m², me nr. ***, vol. ***, fq. ***, z. k. ***, ndodhur në rrugën “***”, Tiranë, e regjistruar në datën 23.3.2003, si dhe është përcjellë dosja e kësaj pasurie;*
 - *truall me sipërfaqe totale 400 m² (nga e cila 343 m² ndodhen në parcelën nr. *** dhe 57 m² ndodhen në parcelën nr. ***, në rrugën “***”), sipas vërtetimit hipotekor të datës 24.3.2004, me nr. ***.*

⁵⁶ Me shkresën nr. *** prot., datë 24.4.2021.

170. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka deklaruar se babai i tij nuk ka pasur asnjëherë pasuri truall me sipërfaqe 57 m², me nr. *** vol. ***, fq. ***, z. k. ***, të ndodhur në rrugën “****”. Sipas tij, ky është një gabim i sistemit elektronik multifunksional dhe parcela prej 57 m² është pjesë e truallit 400 m² të cituar më sipër.
171. Në përgjigje të pyetësorit nr. 3, subjekti ka paraqitur shkresën nr. *** prot., datë 13.7.2023, të ASHK-së, bashkëlidhur së cilës ka rezultuar dokumentacioni i pasurisë së sipër përshkruar, ku ndër të tjera gjendet edhe vërtetimi hipotekor i datës 24.3.2004. Në këtë vërtetim citohet se z. Sh. K. ka në pronësi pasurinë truall me sipërfaqe 400 m² të ndodhur në rrugën “****”, nga e cila 57 m² ndodhet në parcelën nr. *** dhe 343 m² ndodhet në pasurinë nr. ***.
172. Po ashtu ka rezultuar vërtetimi hipotekor nr. ***, datë 3.4.2002, nga i cili ka rezultuar se kjo pasuri ka qenë në pronësi të shtetasit S. K., i cili e ka përfutuar nga Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave dhe pasi ai ka ndërruar jetë pasuria ka kaluar në pronësi të 9 trashëgimtarëve të tij, konkretisht shtetasve L., M., A., J., K., F., S., A. I. dhe N. K. Këta të fundit, me anë të kontratës nr. ***, datë 14.10.2003, i kanë shitur shtetasit Sh. K. një pjesë të pasurisë prej 400 m², me çmim në vlerën 1.900.000 lekë. Në vijim, në vitin 2019⁵⁷, pas çeljes së dëshmisë së trashëgimisë, kjo pasuri ka kaluar në pronësi të subjektit, nënës dhe vëllait të tij.
173. Referuar plan-rilevimit të datës 19.7.2023, pasuria në fjalë ka rezultuar ende truall dhe duket se nuk është kryer asnjë investim.
174. Po ashtu ASIG, me shkresën nr. *** prot., datë 18.7.2023, ka përcjellë pamjet imazherike të printuara nga Gjeoportali Kombëtar i pasurisë në fjalë, të viteve 2001, 2007, 2015 e 2018, nga ku nuk ka rezultuar të kenë ndodhur ndryshime/ndërtime në këtë truall.
175. Me anë të deklaratës noteriale nr. ***, datë 18.10.2019, subjekti, nëna dhe vëllai i tij kanë deklaruar se kanë në bashkëpronësi pasurinë në fjalë të regjistruar në ASHK Tiranë dhe kanë kërkuar lëshimin e dublikatës së certifikatës vërtetimi pronësie.
176. ASHK Skrapar ka bërë me dije se në bashkëpronësi të subjektit, nënës dhe babait të tij ka rezultuar e regjistruar pasuria nr. ***, z. k. ***, e llojit apartament me sipërfaqe totale 68 m², e ndodhur në lagjen “****”, Çorovodë, sipas certifikatës së pronësisë së datës 19.7.2001. Pasuria në fjalë është përfutuar nga babai i subjektit me anë të kontratës së shitblerjes nr. ***, datë 15.5.1998, të lidhur me EKB-në. Nga shqyrtimi i planimetrisë së kësaj pasurie ka rezultuar se ajo përbëhet nga apartamenti me sipërfaqe 67,76 m², si dhe trualli me sipërfaqe 36 m².
177. Në përgjigje të pyetësorit nr. 3, subjekti ka shpjeguar se babai i tij e ka përfutuar falas këtë apartament si ish i përndjekur politik, me anë të kontratës së shitblerjes nr. ***, datë 15.5.1998 – dhe se deri në vitin 2016 nuk ishte në dijeni të ekzistencës së të drejtave të tij të pronësisë për këtë pasuri, duke qenë se ishte shkëputur nga trangu familjar.
178. Gjithashtu, subjekti ka deklaruar se në këtë apartament nuk është bërë asnjë investim nga ana e tij. Administrimi i apartamentit është bërë nga babai i tij i ndjerë dhe nga vëllai i tij, z. D. K.. Ndërsa, pasi babai i tij ka ndërruar jetë, nëna e subjektit ia ka lënë në përdorim apartamentin familjes Gj. (miq të tyre). Për të vërtetuar këtë fakt, subjekti ka paraqitur

⁵⁷ Referuar certifikatës së paraqitur nga subjekti, babai i tij ka ndërruar jetë në datën 7.5.2019.

deklaratën noteriale nr. ***, datë 14.7.2023, të shtetasve V. dhe M. Gj., të cilët kanë deklaruar se: “[...] nga viti 2021 jetojmë në banesën apartament në Çorovodë, Skrapar, në pronësi të të ndjerit Sh. K. Apartamenti ndodhet në adresën lagjja “***”, p. ***, shk. ***, kt. ***, ap. ***. Në këtë apartament, të dy ne bashkëshortët jetojmë duke e përdorur, mirëmbajtur, paguar detyrimet që rrjedhin nga konsumi i energjisë elektrike, ujit etj., por pa paguar vlerë qiraje, pasi i ndjeri Sh. K. ka qenë mik i familjes sonë dhe znj. H. K., pas vdekjes së të ndjerit, na e ka lënë në përdorim këtë pasuri, thjesht që ne ta mirëmbajmë e të kujdesemi për të, pasi ajo pjesën më të madhe të kohës jeton në Itali tek djali i saj D. K.”.

179. Subjekti ka paraqitur në cilësinë e provës foto aktuale të kësaj pasurie, si dhe shkresën nr. *** prot., datë 13.7.2023, nga ASHK-ja, shoqëruar me dokumentacionin përkatës të saj, për të provuar statusin juridik të saj.
180. Nga shqyrtimi i këtij dokumentacioni ka rezultuar se së paku deri në datën 18.10.2019, kur subjekti, nëna dhe vëllai i tij kanë paraqitur kërkesë për t’u pajisur me certifikatë pronësie, nuk duket të jetë kryer ndonjë investim në pasurinë në fjalë. Gjendja faktike, si dhe statusi juridik i pronës duket se paraqiten të njëjtë, që nga momenti i fitimit të të drejtave reale nga babai i subjektit mbi këtë pasuri.
181. Drejtoria e Përgjithshme e ASHK-së, me shkresën nr. *** prot., datë 30.3.2021, ka bërë me dije se z. Sh. H. K. ka rezultuar vetëdeklarues për ndërtimin pa leje të godinës së banimit *** kate, të ndodhur në qarkun Fier, për të cilin është pajisur me lejen nr. ***, datë 30.8.2018. Pas kërkesës së Komisionit, ASHK-ja⁵⁸ ka përcjellë dokumentacionin që i përket pasurisë në fjalë. Nga shqyrtimi i tij ka rezultuar se vetëdeklarues/pronar i kësaj pasurie nuk ka qenë babai i subjektit, por një tjetër shtetas me emër, mbiemër dhe atësi të njëjtë, por ndryshon datëlindja.

2. Lidhur me disa letra me vlerë në Raiffeisen Bank, të përfituara nga trashëgimia ligjore

182. Në përgjigje të pyetësorit nr. 1, subjekti ka deklaruar se ka në bashkëpronësi me të tretë letra me vlerë në Raiffeisen Bank, të përfituara nga trashëgimia ligjore e babait të tij, sipas vendimit për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore nr. ***, datë 27.7.2019, në emër të subjekti, nënës dhe vëllait të tij. Subjekti ka deklaruar në këtë pyetësor se sipas prokurës nr. ***, datë 15.6.2019, është autorizuar nga nëna, dy motrat dhe vëllai i tij për t’i përfaqësuar në lidhje me kërkesën për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë. Po në këtë prokurë, të dyja motrat e subjektit kanë autorizuar nipin e tij R. Sh. (djali i njërit prej motrave) për t’i përfaqësuar në deklarimin e heqjes dorë të tyre nga trashëgimia ligjore.
183. Në përgjigje të pyetësorit nr. 3, subjekti ka paraqitur vërtetimin e datës 13.7.2023 nga Raiffeisen Bank, në të cilin citohet se në emër të të ndjerit Sh. K. disponohen letra me vlerë në shumën 3.986.043 lekë, me nr. libeze ***, krijuar në datën 31.8.1996. Subjekti ka shpjeguar se këto letra me vlerë janë përfitur nga babai i tij në cilësinë e ish të përndjekurit dhe të dënuarit politik. Në përmbajtje të librezës “Llogari në letra me vlerë për privatizim” citohet se: “Banka e Kursimeve, në bazë të udhëzimit të Këshillit të Ministrave nr. 01, datë 6.6.1994, ndër detyrat që ka pasur ka qenë edhe ...4.b) Për kalimin pjesor ose tërësor të letrave me vlerë të një personi tjetër, duke e pajisur atë me librezën përkatëse, pavarësisht

⁵⁸ Me shkresën nr. *** prot., datë 20.4.2024.

nëse është i persekutuar ose jo nëpërmjet shitjes së shumave apo dhurimit të tyre për t'u përdorur në procesin e privatizimit”.

184. Referuar vërtetimit nr. *** prot., datë 18.7.2023, të Institutit të ish të Përndjekurve Politikë “Vërtetim për dhënie statusi”, të paraqitur nga subjekti, ka rezultuar se i ndjeri Sh. K., krahas shpërblimeve të tjera, ka përfituar edhe letra me vlerë, sipas librezës së hapur në datën 22.9.1996 dhe ka pasur tërheqje dhe shtesa të tjera në këtë llogari deri në datën 16.12.1999. Teprica e letrave me vlerë është në të njëjtën vlerë që konfirmohet edhe nga Raiffeisen Bank. Sikurse rezulton edhe nga informacioni i përcjellë, ende kjo llogari është në emër të babait të tij dhe nuk është kryer ndonjë tërheqje. Subjekti ka shpjeguar se pjesa e tij takuese do të përcaktohet sipas dëshmisë së trashëgimisë për të ndjerin Sh. K.
185. Në procesverbalin e datës 9.7.2021, të mbajtur nga ILDKPKI-ja, subjekti është shprehur se është bashkëpronar i pjesës takuese në masën 1/3 të pasurive të disponuara nga babai i tij, sipas vendimit për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore të tij. Ai ka shpjeguar se si burim krijimi për pasuritë e krijuara nga i ati kishin shërbyer: (i) të ardhurat e përfituara prej tij në cilësinë e ish të përndjekur politik; (ii) të ardhurat e përfituara në cilësinë e ortakut të shoqërisë “***” sh.p.k., për periudhën 1.1.1995 – 2.3.1998, më pas si ortak i vetëm i kësaj shoqërie për periudhën 2.3.1998 – 21.1.2008; (iii) të ardhurat e përfituara sipas vendimit nr. ***, datë 22.6.2015, të Gjykatës Administrative Tiranë; (iv) të ardhurat nga pensioni i pleqërisë. Në mbështetje të deklaratimit të tij, subjekti ka bashkëlidhur dokumentacionin provues përkatës⁵⁹.
186. Në përfundim të sa është analizuar dhe parashtruar më sipër, ka rezultuar se lidhur me pasuritë e sipër përshkruara, të cilat kanë qenë në pronësi të babait të subjektit: (i) subjekti nuk ka rezultuar të ketë kryer ndonjë pagesë/investim për krijimin e këtyre pasurive; (ii) subjekti ka rezultuar me të drejta pronësie mbi këto pasuri (vetëm) pas çeljes së dëshmisë së trashëgimisë në vitin 2019, dhe në pjesën takuese.
187. Për sa më sipër, nuk janë konstatuar problematika lidhur me pasuritë e subjektit të rivlerësimit të trashëguara nga babai i tij.

3. Lidhur me arsimimin e djalit të subjektit të rivlerësimit

188. Në përgjigje të pyetësorit nr. 1, subjekti ka deklaruar se djali i tij ka studiuar fillimisht në një shkollë shtetërore e më pas në një shkollë private, sipas periudhave të cituara në vijim:
- *shkolla publike “***”, nga shtatori 2004 deri në dhjetor 2007;*
 - *dhjetor 2007 – dhjetor 2009, shkolla publike “***”, Kukës;*
 - *janar 2010 – dhjetor 2010, shkolla publike “***”, Tiranë;*
 - *dhjetor 2010 – qershor 2016, shkolla private “***”, Tiranë.*
189. Sa më sipër, është konfirmuar edhe nga informacioni i administruar nga Komisioni përgjatë hetimit administrativ, me shkresën nr. *** prot., datë 25.4.2023, nga Zyra Vendore Arsimore Tiranë.

⁵⁹ Subjekti ka paraqitur: vendimin për lëshim të dëshmisë së trashëgimisë ligjore nr. ***, datë 27.7.2019; kontratë për përfitimin e apartamentit në Skrapar nga Enti Kombëtar i Banesave, datë 21.4.1998; llogari në letra me vlerë, nr. llogarie ***, datë 2.9.1996, etj.

190. Gjithashtu, në pyetësonin nr. 1, subjekti ka deklaruar pagesat e kryera për shkollimin e djalit, si dhe ka paraqitur vërtetimin nr. *** prot., datë 12.2.2021, nga shkolla “***”, sipas të cilit tarifrat e paguara kanë qenë si vijon:
- dhjetor 2010 – qershor 2011, paguar në dhjetor shuma 1.000 euro;
 - shtator 2011 – qershor 2012, paguar në mars shuma 1.000 euro;
 - shtator 2012 – qershor 20 t3, parapaguar në dhjetor 2012 shuma 1.000 euro;
 - shtator 2013 – qershor 2014, paguar në nëntor 2013 shuma 1.500 euro;
 - shtator 2014 – qershor 2015, paguar në dhjetor 2014 shuma 1.500 euro;
 - shtator 2015 – qershor 2016, paguar në dhjetor shuma 1.500 euro.
191. Sa më sipër, është konfirmuar edhe nga informacioni i administruar nga Komisioni përgjatë hetimit administrativ, me shkresën nr. *** prot., datë 10.5.2023 nga shkolla “***”.
192. Në përgjigje të pyetësonit nr. 2, subjekti ka sqaruar se djali i tij J. K. ka udhëtuar në Gjermani në vitin 2017. Gjatë këtij viti ai ka jetuar tek një mik i familjes në Berlin, z. K. N. Subjekti ka deklaruar se gjatë vitit 2017 djali i tij ka ndjekur kursin e gjuhës gjermane, për të cilin subjekti ka paguar shumën 5.600 euro, por nuk disponon dokumentacion për pagesat e kryera.
193. Në lidhje me marrëdhënien me shtetasin K. N., subjekti ka deklaruar se ka njohje pasi është i biri i shtetasit Ll. N., me të cilin ai ka miqësi familjare. Në lidhje me këtë shtetas, nga gjykatat pranë të cilave ka ushtruar detyrën subjekti është konfirmuar se nuk kanë rezultuar çështje gjyqësore të gjykuara prej tij, ku të ketë qenë palë shtetasi K. N.
194. Komisioni ka analizuar disponibilitetin financiar të subjektit për të mbuluar me burime të ligjshme shpenzimet për arsimimin e djalit të tij, për periudhën 2010 – 2016. Nga analiza e kryer (pasqyruar në tabelën e analizës së përgjithshme financiare) nuk janë konstatuar problematika.
195. Lidhur me shtetasit e mësipërm, gjatë hetimit administrativ, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë⁶⁰, Berat⁶¹, Lezhë⁶² dhe Kukës është bërë me dije se nuk ka rezultuar që subjekti të ketë shqyrtuar ndonjë çështje ku ata të kenë qenë palë.

4. Lidhur me vendbanimet e subjektit të rivlerësimit ndër vite

196. Në përgjigje të pyetësonit nr. 1, subjekti ka deklaruar se që nga momenti i marrjes së detyrës në vitin 2009 si gjyqtar ka banuar në pasuritë e ndodhura në adresat si vijon:
- a. Nga muaji shtator 1997 deri në prill të vitit 2001, subjekti ka deklaruar se ka jetuar së bashku me bashkëshorten, djalin dhe prindërit e bashkëshortes në një apartament në Kavajë, në lagjen “***”, pallati ***, Kavajë, kati i tretë, pa qira, në përdorim, duke paguar vetëm shpenzimet për ushqim të familjes. Në mbështetje të deklarimit të tij, subjekti ka paraqitur një certifikatë pronësie të apartamentit në fjalë, të datës 15.12.2000, në emër të prindërve të bashkëshortes së tij, si dhe të vetë bashkëshortes. Në mbështetje të deklarimit të tij, subjekti ka paraqitur deklaratën noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., të znj. V. K., si dhe certifikatën e pronësisë për pasurinë apartament, me nr. ***, z. k. ***, vol. ***, fq. ***, i ndodhur në Kavajë.

⁶⁰ Me shkresën nr. *** prot., datë 27.4.2023.

⁶¹ Me shkresën nr. *** prot., datë 20.4.2023.

⁶² Me shkresën nr. *** prot., datë 20.4.2023.

- b. Nga muaji prill 2001 deri në fund të dhjetorit të vitit 2001, subjekti ka deklaruar se ka jetuar së bashku me bashkëshorten E. K. dhe djalin J. K. në një apartament të ndodhur në zonën e quajtur “****”, në Tiranë, në emër të shtetasit A. B., të cilin e ka pasur në përdorim, pa qira, për shkak të marrëdhënies shoqërore me këtë shtetas. Në mbështetje të deklaramit të tij, subjekti ka paraqitur një deklaratë nga shtetasit A. dhe L. B., bashkëlidhur së cilës gjendet një vërtetim nga dokumenti hipotekor i pasurisë apartament, i datës 5.10.2004, ndodhur në Tiranë, ***, z. k. ***, në emër të shtetasve A. dhe L. B. Gjithashtu, subjekti ka paraqitur kontratën e shitjes nr. ***, të pasurisë në fjalë, sipas së cilës ka rezultuar se apartamenti në datën 7.10.2004 ka kaluar në pronësi të shtetasve V. e T. Ll. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka deklaruar se me shtetasit A. B. dhe L. B. ka njohje, pasi z. B. është nipi i profesor Z. B., njohje e cila ka filluar që nga periudha e universitetit.
- c. Subjekti ka deklaruar se nga muaji janar 2002 deri në fund të dhjetorit të vitit 2005, së bashku me bashkëshorten, djalin, vjehrrin dhe vjehrrën kanë jetuar pa qira në apartamentin e këtyre të fundit, i cili ndodhej në Tiranë, rruga “****”, pallati ***, shkalla ***, apartamenti nr. ***. Subjekti ka deklaruar se shpenzimet për jetesë të familjes janë përballuar prej tij dhe bashkëshortes. Subjekti ka paraqitur një vërtetim nga dokumenti hipotekor nr. ***, datë 23.10.2013, i pasurisë apartament nr. ***, i ndodhur në Tiranë, rruga “****”, z. k. ***. Në DIPP-në e vitit 2004, subjekti ka deklaruar adresën në fjalë si adresë vendbanimi. Kjo pasuri është analizuar në pasurinë nr. 1, të deklaruar nga bashkëshortja e subjektit.
- d. Nga muaji janar 2006 e në vijim, subjekti ka deklaruar se ka banuar së bashku me bashkëshorten dhe djalin në apartamentin e ndodhur në rrugën “****”, pallati “****”, shkalla ***, apartamenti nr. ***, kati i shtatë i banimit. Subjekti ka paraqitur një vërtetim nga dokumenti hipotekor i pasurisë apartament nr. ***, i ndodhur në Tiranë, rruga “****”, z. k. ***, me sipërfaqe 78,96 m², në emër të shtetasit Flamur Sh. Kapllani, e cila është pasuria e analizuar në pikën 1 të këtij relacioni.
- e. Për periudhën 1.11.2007 – 31.3.2010, subjekti ka deklaruar se për arsye të transferimit me punë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës ka banuar së bashku me familjen në qytetin e Kukësit, në pasurinë apartament nr. ***, i ndodhur në z. k. *, Lagjja nr. ***, pallati ***, shkalla ***, në përdorim, pa qira, për shkak të lidhjeve miqësore me pronarët D. dhe L. R., që para transferimit me punë në Kukës. Në mbështetje të deklaramit të tij, subjekti ka paraqitur në cilësinë e provave deklaratën noteriale nr. ***, datë 5.2.2021, me deklarues L. e D. R., bashkëlidhur së cilës gjendet certifikata për vërtetim pronësie datë 5.10.2006, për pasurinë apartament, i ndodhur në Kukës, z. k. ***, vol. ***, fq. ***, me nr. pasurie ***, në bashkëpronësi të shtetasve D. dhe L. R. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka deklaruar se me shtetasit D. R. dhe L. R. ka pasur njohje që prej periudhës së universitetit.
197. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar nga DPSHTRR-ja, ndër të tjera ka konstatuar se sipas vërtetimeve të datave 8.4.2002 dhe 23.6.2004, z. Kapllani ka qenë banor i Njësisë Bashkiake Nr. ***, rruga “****”.

198. Sa më sipër, është konfirmuar edhe nga DPGJC-ja⁶³, e cila ka bërë me dije se referuar regjistrin të gjendjes civile nr. *** ka rezultuar se gjatë periudhës 2001 – 25.3.2005 subjekti ka qenë i regjistruar në Zyrën e Gjendjes Civile nr. ***, rruga “****”.
199. Në përgjigje të pyetësorëve nr. 2 dhe 3, subjekti është shprehur se adresa në rrugën “****”, Njësia Bashkiake Nr. ***, Tiranë, shënuar në kontratën nr. ***, datë 20.10.2004, është lapsus. Ai ka sqaruar se në vitin 2004 figuronte i regjistruar në Zyrën e Gjendjes Civile, Njësia nr. ***, regjistrim i kryer në vitin 2001, deri në momentin kur gjendja civile është transferuar. Sipas subjektit, adresa ***, pallati ***, hyrja *** – në atë kohë ka qenë e përfshirë në Njësinë nr. *** dhe bllokun/rrugën “****”. Subjekti ka vënë në dispozicion të Komisionit edhe shkresën nr. *** prot., datë 13.7.2023, të Njësisë Administrative Nr. ***, me të cilën ky institucion informon se, bazuar në Regjistrin Themeltar ***, subjekti është regjistruar në datën 19.10.2001 dhe është transferuar në datën 7.4.2005. Në momentin e regjistrimit si banor i Njësisë Bashkiake Nr. ***, rruga “****”, subjekti ka banuar në *** dhe, për këtë arsye, është regjistruar në këtë njësi bashkiake. Apartamentin e ka pasur në përdorim pasi ka jetuar për një periudhë të shkurtër kohe. Në janar të vitit 2002 ai ka filluar të jetojë në rrugën “****” pallati ***, shkalla ***, apartamenti ***, por ndryshimin e gjendjes civile në këtë adresë, sikurse konfirmohet edhe nga përgjigjja, e ka bërë në datën 7.4.2005.
200. Gjatë hetimit administrativ, Komisioni ka kërkuar informacion nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë⁶⁴, Berat⁶⁵, Lezhë⁶⁶ dhe Kukës, lidhur me çështje të mundshme të shqyrtuara nga subjekti, me palë pronarët e apartamenteve që ai ka deklaruar se ka pasur në përdorim. Këto institucione kanë bërë me dije se nuk kanë rezultuar çështje të shqyrtuara nga subjekti Flamur Kapllani, me palë shtetasit L. dhe A. B., L. e D. R.
201. SPAK⁶⁷ ka bërë me dije se në emër të shtetasve të sipërpërmendur nuk është regjistruar ndonjë procedim penal.

5. Lidhur me disa automjete të cilat kanë rezultuar në pronësi të subjektit dhe të tjetërsuara ndër vite, si dhe ato të rezultuara në përdorim të tij

202. Komisioni përgjatë procesit të rivlerësimit ka administruar nga institucionet përkatëse informacione të mundshme në lidhje me automjetet në pronësi apo përdorim nga subjekti i rivlerësimit.
203. Nga shqyrtimi i deklarimeve periodike të subjektit, dokumentacionit të përcjellë nga DPSHTRR⁶⁸-ja, si dhe nga verifikimi i kryer *online* në sistemin informatik të AMF-së, ka rezultuar se, veç automjetit me targë ***, të deklaruar në deklaratën *Vetting* nga subjekti i rivlerësimit, kanë rezultuar edhe disa mjete në përdorim prej subjektit dhe personave të lidhur, si dhe mjete që kanë qenë në pronësi të tij dhe bashkëshortes (me targa ***, *** dhe ***), të cilat trajtohen në vijim.

5.1 Lidhur me automjetin tip “Mercedes-Benz 190”

⁶³ Me shkresën nr. *** prot., datë 29.5.2023.

⁶⁴ Me shkresën nr. *** prot., datë 27.4.2023.

⁶⁵ Me shkresën nr. *** prot., datë 20.4.2023.

⁶⁶ Me shkresën nr. *** prot., datë 20.4.2023.

⁶⁷ Me shkresën nr. *** prot., datë 2.5.2023.

⁶⁸ Me shkresën nr. *** prot., datë 20.4.2023.

204. Subjekti ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2003 automjetin tip “Mercedes-Benz 190”, me targë ***, prodhim i vitit 1984 (fillimisht me targë ***), si pasuri e dhuruar nga të afërmit (daja, F. Q). Nga shqyrtimi i kontratës së dhurimit të automjetit në fjalë, nr. ***, datë 6.11.2001, ka rezultuar se kontrata është nënshkruar nga subjekti dhe pala dhuruese, shtetasi N. K.
205. Në DIPP-në e vitit 2005, subjekti ka deklaruar kontratë shitjeje të automjetit në fjalë, nr. ***, datë 20.10.2004, në vlerën 600.000 lekë, e cila është likuiduar nga blerësi M. Gj., jashtë zyrës noteriale.
206. Nga shqyrtimi i dosjes së këtij automjeti ka rezultuar se në kontratën e dhurimit nr. ***, datë 6.11.2001, citohej se mjete, i cili pasur fillimisht targën ***, i është dhuruar z. Flamur Kapllani. Dhuruesi, z. K., e kishte përfituar këtë automjet nga një shtetas italian sipas kontratës së lidhur në Durrës, me nr. ***, datë 12.5.2001, në vlerën 150.000 lekë.
207. Në përgjigje të pyetësorit nr. 1, subjekti ka deklaruar se ka marrë si dhurim automjetin në fjalë nga z. N. K., mik i dajës së tij, z. F. Q., të cilin daja e kishte njohur gjatë emigrimit në Greqi.
208. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka deklaruar se automjetin e ka përfituar me dhurim dhe të ardhurat e realizuara nga shitja, në mënyrë indirekte, janë të ardhura të përfituara nga dhurimi, pra nga pasuri e luajtshme e dhuruar, që është transferuar në likuiditet.
209. Lidhur me sa më sipër, referuar qëndrimit të mbajtur nga Kolegji në vendimin nr. 14/2021, paragrafi 22.11, në të cilin citohet se: *“...Subjekti gjithashtu ka mbështetur qëndrimin e mbajtur nga Ministria e Financave dhe e Ekonomisë, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, në shkresën nr. {***} prot., datë 16.5.2019, në përgjigje të pyetjes së drejtuar nga Komisioni, se nuk i nënshtrohen tatimit shumat e dhuruara të cilat janë tatuar një herë, ndër të tjera, në zbatim të parimit të mostatimit të dyfishtë”*, si dhe bazuar në shkresën nr. *** prot., datë 4.7.2023, nga Kolegji për Komisionin, ku përcjell shkresën e DPT-së që informon se akti nënligjor në mbështetje të ligjit, udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 5, datë 30.1.2006 (i ndryshuar), në pikën 2.3.9, me qëllim shterimin dhe/ose sqarimin e shkronjës “g” “Të ardhura të tjera” të nenit 8 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 (i ndryshuar) nuk ka të përfshirë dhe/ose cituar si të ardhur të tatueshme të ardhurat nga shitja e pasurisë së luajtshme (automjet për përdorim personal), duket se subjekti nuk ka pasur detyrim për pagesën e tatimit për të ardhurat e shitjes së automjetit në fjalë.
210. Subjekti ka deklaruar në përgjigje të pyetësorëve nr. 1 dhe 2 të dërguar nga Komisioni se z. K. nuk e ka njohur personalisht, nuk ka konflikt interesi apo procese gjyqësore ku ai të ketë qenë palë. Në lidhje me marrëdhënien me shtetasin M. Gj., subjekti ka deklaruar se nuk ka pasur dhe nuk ka ndonjë marrëdhënie shoqërore përveçse marrëdhënies kontraktuale për shitjen e automjetit. Ai ka deklaruar se nuk ka gjykuar ndonjë çështje me palë ndërgjyqëse ose kërkues këtë shtetas.
211. Gjithashtu, edhe gjykatat⁶⁹ në të cilat ka ushtruar funksionin subjekti kanë konfirmuar për Komisionin se nuk kanë rezultuar çështje të gjykuara nga subjekti, ku palë të ketë qenë shtetasi N. K. dhe as me blerësin e këtij automjeti, shtetasin M. Gj.

⁶⁹ Me shkresën nr. *** prot., datë 11.4.2023.

5.1.1 Lidhur me analizën e burimit të ligjshëm të krijimit të pasurisë nga shtetasi N. K.

212. Në përgjigje të pyetësorit nr. 3, subjekti ka paraqitur dokumentacionin ligjor lidhur me të ardhurat e familjes K., i cili i është vënë në dispozicion nga shtetasi R. K. (djali i shtetasit N. K.). Subjekti ka shpjeguar se shtetasi N. K. dhe daja i tij, z. F. Q., janë shumë miq me njëri-tjetrin. Z. K. ka dashur t'i dhurojë automjetin e sipërcituar dajës së subjektit (për shkak të miqësisë së tyre) dhe ai i kërkoi pronarit të mjetit t'ia dhuronte direkt subjektit, për të shmangur nënshkrimin e dy kontratave të njëpasnjëshme. Subjekti ka parashtruar gjithashtu se në këtë periudhë nuk ka qenë subjekt deklarues. Në këto kushte, nuk ka pasur ndonjë arsye për nënshkrimin e një kontrate jo reale. Në mbështetje të shpjegimeve të tij ai ka paraqitur:

- *deklaratë noteriale nr. ***, datë 20.7.2023, nënshkruar nga shtetasi R. N. K., djalit të shtetasit N. K., duke sqaruar se z. N. K. është në moshë të thyer dhe jo në gjendje të mirë shëndetësore;*
- *vërtetim për të ardhurat e shtetasit N. K. nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Durrës, për vitet 1994 – 2006;*
- *vërtetim për të ardhurat e bashkëshortes së shtetasit N. K. Q. K. nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Durrës, për vitet 1994 – 2000.*

213. Përgjatë hetimit Komisioni i ka kërkuar informacion Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Durrës, e cila me shkresën nr. *** prot., datë 18.7.2023, ka vënë në dispozicion kopje të librezës së punës bashkë me pagat sipas dosjes së pensionit të pleqërisë nr. *** dhe vërtetimet përkatëse.

214. Komisionit, në analizë të dokumentacionit të administruar, i rezulton se z. K. ka pasur mundësi financiare për krijimin e pasurisë në analizë.

5.2 Lidhur me automjetin tip “Mercedes-Benz 250 D”, prodhim i vitit 1984, në vlerën 300.000 lekë, në pronësi të subjektit

215. Në DIPP-në e vitit 2005, subjekti ka deklaruar kontratën e shitblerjes së automjetit tip “Mercedes-Benz 250 D”, me targë ***, me nr. ***, datë 31.12.2004, blerë nga shtetasi A. L., përfaqësuar nga av. S. D., në vlerën 300.000 lekë. Si burim krijimi për këtë pasuri, subjekti ka deklaruar të ardhurat nga paga e tij dhe bashkëshortes, si dhe të ardhurat nga shitja e automjetit në datën 20.10.2004 (automjeti me targë ***). Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka deklaruar se mosdeklarimi i krijimit të kësaj pasurie në vitin përkatës, sipas tij, është pasaktësi formale.

216. DPSHTRR-ja⁷⁰ ka përcjellë dosjen e këtij automjeti, nga shqyrtimi i së cilës ka rezultuar se mjeti me targë *** është i njëjtë me atë në analizë, me targë ***. Ky fakt është konfirmuar edhe nga vetë subjekti në përgjigje të pyetësorit nr. 3. Ai ka sqaruar se mjeti me targë *** ka qenë në pronësi të tij nga data 31.12.2004 deri më 5.8.2009. Subjekti ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2009 shitjen e automjetit në fjalë në vlerën 600.000 lekë. Në përgjigje të pyetësorit nr. 1, subjekti ka paraqitur kontratën e shitjes së automjetit në analizë, nr. ***, datë 5.8.2009, në vlerën 600.000 lekë, e cila është likuiduar jashtë zyrës noteriale nga blerësi A. A.

⁷⁰ Me shkresën nr. *** prot., datë 6.6.2023.

217. Gjithashtu, DPPPP-ja, me shkresën e datës 25.4.2023 ka përcjellë informacione lidhur me këtë automjet, të cilat ishin administruar edhe më herët nga burime të tjera, nëpërmjet përgjigjeve të administruara nga Komisioni (si më sipër).
218. Subjekti ka sqaruar se për të ardhurat e përfituara nga shitja e mjetit nuk ka paguar tatim, për shkak se në vlerësimin e tij nuk ka pasur detyrim tatimor për të ardhurat e krijuara nga shitja e këtij automjeti. Të ardhurat për shitjen e kësaj pasurie janë arkëtuar në rrugë bankare në datën e lidhjes së kontratës⁷¹.
219. Në lidhje me shtetasit A. L., A. A. dhe S. D., subjekti ka deklaruar se nuk ka pasur dhe nuk ka ndonjë marrëdhënie shoqërore përveçse marrëdhënies kontraktuale për shitjen e automjetit. Ai është shprehur se nuk ka gjykuar ndonjë çështje me palë ndërgjyqëse ose kërkues këta shtetas. Gjatë hetimit administrativ, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë⁷², Berat⁷³, Lezhë⁷⁴ dhe Kukës është bërë me dije se nuk kanë rezultuar çështje gjyqësore të shqyrtuara nga subjekti, me palë shtetasit e sipërpërmendur.

5.2.1 Lidhur me analizën financiare të burimit të krijimit të kësaj pasurie

220. Nëpërmjet pyetësorit nr. 3, Komisioni e ka pyetur subjektin në lidhje me shkaqet e shitjes së këtij automjeti në një vlerë rreth dy herë më të lartë se çmimi i blerjes. Në përgjigje të këtij pyetësi, subjekti ka deklaruar se automjetit ai i ka bërë përmirësime, duke i kryer të gjitha rregullimet nga e para (si goma të reja, tapiceri e ndryshuar, lysterje, mirëmbajtje dhe revizionim), shpenzime të cilat në kohën kur janë kryer nuk janë dokumentuar.
221. Analiza financiare për mundësitë e subjektit për të investuar në blerjen e këtij mjeti ka rezultuar pa problematika. Ajo është pasqyruar në tabelën e detajuar financiare, ndërsa të ardhurat nga shitja e këtij mjeti janë marrë në shumën 300.000 lekë, për sa kohë që subjekti nuk provoi me dokumentacion shpenzimet e kryera për këtë mjet.
222. Nga sa më sipër, ka rezultuar se subjekti nuk ka provuar rritjen e vlerës së mjetit nga investimet e kryera prej tij. Kësisoj, mbetet i paqartë shkaku i një përfitimi financiar, që bie ndesh me logjikën e tregut. Në këto kushte, Komisioni i ka kërkuar subjektit që të paraqiste shpjegime bindëse, si dhe dokumentacionin provues përkatës.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

223. Subjekti është shprehur se është në pamundësi për t'i dokumentuar shpenzimet e kryera për rregullimin e automjetit, për shkak të kohës së gjatë që ka kaluar. Ai ka parashtruar se çmimi i shitjes së automjetit është ai i përcaktuar në kontratën e shitblerjes dhe analiza financiare e vitit 2009 rezulton pozitive edhe në kushtet kur të ardhurat nga shitja e automjetit përlllogariten në shumën 300.000 lekë – dhe se nuk ka pasur asnjë arsye të

⁷¹ Subjekti ka përmendur për analogji qëndrimin e mbajtur nga Komisioni në vendimin nr. 548, datë 6.7.2022, në të cilin citohet interpretimi ligjor i bërë nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve me shkresën e datës 7.3.2022, e cila në këtë shkresë ka theksuar se nuk paguhet tatim për të ardhurën e realizuar nga shitja e automjeteve. Më konkretisht, në këtë shkresë theksohet se: *“Pas një interpretimi të nenit 8 “E ardhura e tatueshme” të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, dhe udhëzimit nr. 5, datë 30.1.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, ky institucion në përfundim deklaroi se: “Të ardhurat e përfituara nga shitja e pasurisë së luajtshme (në rastin tuaj autoveturë/dhe ose mjet motorik) nuk janë të ardhura të listuara në nenin 8 “Të ardhura të tatueshme”, si dhe pikën 2.3 të udhëzimit nr. 5, datë 30.1.2006 (i ndryshuar) në zbatim të dispozitave ligjore”.*

⁷² Me shkresën nr. *** prot., datë 27.4.2023.

⁷³ Me shkresën nr. *** prot., datë 20.4.2023.

⁷⁴ Me shkresën nr. *** prot., datë 20.4.2023.

vendosë në kontratën e shitjes një shumë të ndryshme nga ajo e çmimit të dakordësuar ndërmjet palëve.

Vlerësimi i Komisionit

224. Pas shqyrtimit të parashtrimeve të subjektit, në referencë edhe të qëndrimeve të mbajtura nga Kolegji⁷⁵ në një rast të ngjashëm, trupi gjykues konstatoi se deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në ILDKPKI dhe gjatë hetimit administrativ lidhur me gjendjen e automjetit në momentin e blerjes së tij dhe shpenzimet e kryera prej tij më pas, për riparime, mbetën në nivel deklarativ, pa u provuar me dokumentacion ligjor.
225. Gjithashtu, nga verifikimi i deklaratave periodike vjetore, trupit gjykues i rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar shpenzime apo investime të kryera për riparimin e këtij automjeti e, më pas, duke e shitur atë me vlerë më të lartë se çmimi i blerjes. Nga të gjitha këto rrethana, trupi gjykues i konsideron jo bindëse deklaratimet e subjektit lidhur me rritjen e vlerës nëpërmjet kostove të riparimit, duke i bërë kësaj të pabesueshme arsyet për të cilat ky automjet është blerë në vitin 2004 me një çmim prej 300.000 lekësh dhe është shitur në vitin 2009 në shumën 600.000 lekë. Në këtë mënyrë, çmimi i vendosur në kontratën e shitblerjes së automjetit ndryshon në mënyrë thelbësore nga parimet e barazisë e të paanësisë të shprehura në dispozitat e Kodit Civil, që rregullojnë marrëdhëniet kontraktuale. Për rrjedhojë, Komisioni ka arritur në konkluzionin se janë kryer veprime jashtë logjikës financiare, duke e shitur mjetin disa vite më vonë, në vlerë të dyfishtë. Në këto kushte, trupi gjykues ka vlerësuar se për sa kohë nuk provohen shpenzimet e kryera, të ardhurat nga shitja e këtij mjeti do të jenë në masën 300.000 lekë, aq sa është blerë nga subjekti.
226. Për sa më sipër, pas korigjimit të shpenzimeve të udhëtimit për këtë vit, si dhe kursit të këmbimit për shlyerjen e parakohshme të kredisë në datën 9.2.2009, konstatohet një ndryshim në balancë nga negative, prej (-)6.020 lekësh në vitin 2009, në një rezultat financiar pozitiv për vitin 2009.

5.3 Lidhur me automjetin tip “Ford Jaz Fiesta”, prodhim i vitit 1996, në vlerën 150.000 lekë, në pronësi të bashkëshortes së subjektit

227. Në DIPP-në e vitit 2010, subjekti ka deklaruar kontratë blerjeje automjeti tip “Ford Fiesta”, prodhim i vitit 1996, me targë ***, me nr. ***, datë 7.6.2007, blerë nga shtetasja Sh. H. në vlerën 150.000 lekë. Si burim krijimi për këtë pasuri subjekti ka deklaruar të ardhurat nga paga e tij dhe bashkëshortes, si dhe likuiditetin e gjendjes në momentin e blerjes.
228. DPSHTRR-ja⁷⁶ ka përcjellë dosjen e automjetit në analizë, ku nga shqyrtimi i saj ka rezultuar se znj. E. K. ka pasur në pronësi mjetin me targë ***, i cili me parë ka pasur targën ***. Shitësja Sh. H. e kishte përfituar këtë mjet me kontratën nr. ***, datë 20.12.2006, nga shtetasi E. L., në vlerën 250.000 lekë, e cila është likuiduar përpara nënshkrimit të kontratës. Shtetasi E. L. e kishte blerë këtë automjet në Gjermani, në datën 14.11.2006, në vlerën 650 euro.

⁷⁵ Vendimi nr. 54, datë 19.12.2023.

⁷⁶ Me shkresën nr. *** prot., datë 20.4.2023.

229. Ky automjet ka rezultuar i shitur me kontratën nr. ***, datë 11.6.2012, në vlerën 100.000 lekë⁷⁷. Vlera e automjetit është likuiduar *cash* jashtë zyrës noteriale nga blerësi Sh. P., përpara lidhjes së kontratës.
230. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka paraqitur kopje të kontratës nr. ***, datë 11.6.2012. Ai ka deklaruar se likuidimi i vlerës së blerjes së automjetit prej 150.000 lekësh është bërë *cash*, siç citohet në kontratë, jashtë zyrës noteriale. Si burim krijimi për këtë pasuri kanë shërbyer të ardhurat nga paga e tij dhe bashkëshortes, si dhe likuiditeti i gjendjes në momentin e blerjes.
231. Në lidhje me marrëdhënien me shtetasin Sh. P., subjekti ka deklaruar se nuk ka pasur dhe nuk ka ndonjë marrëdhënie shoqërore, por është babai i kolegut të tij E. P. Ai ka sqaruar se në asnjë rast nuk ka gjykuar ndonjë çështje me palë ndërgjyqëse ose kërkues këtë shtetas.
232. Gjithashtu, edhe gjykatat në të cilat ka ushtruar funksionin subjekti kanë konfirmuar për Komisionin se nuk kanë rezultuar çështje të gjykuara nga subjekti, ku palë të kenë qenë shtetasit Sh. H., E. L. dhe as me blerësin e këtij automjeti, shtetasin Sh. P..
233. Në lidhje me shtetasit Sh. H. dhe E. L., Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë ka bërë me dije se nuk kanë rezultuar çështje gjyqësore të shqyrtuara nga subjekti, ku të kenë qenë palë këta shtetas.

5.3.1 Lidhur me analizën financiare të burimit të krijimit të kësaj pasurie

234. Komisioni kreu analizën financiare në datën e investimit, duke përfshirë të ardhurat dhe shpenzimet e identifikuara, dhe nuk konstatoi problematika, siç paraqitet në tabelën në vijim.

Tabela nr. 13 – Analiza financiare për blerjen e automjetit

Nr.	Përshkrimi	7.6.2007
1	TË ARDHURA	438,694
	Të ardhura nga paga e subjektit	435,287
	Të ardhura nga interesat	3,407
2	SHPENZIME	471,126
	Shpenzime jetese sipas ILDKPKI-së	170,775
	Shpenzime kredia NBG Bank (25.000 euro) (principal + interes)	132,185
	Shpenzime ekstra kredia NBG Bank	15,805
	Shpenzime kredia Raiffeisen Bank (1.000.000 lekë) (principal + interes)	152,361
3	PASURI	(821,877)
	Pasuri e paluajtshme/e luajtshme	
	Automjet Ford Fiesta (7.6.2007)	150,000
	<i>Ndryshim likuiditeti</i>	(971,877)
	DIFERENCA (1-2-3)	789,446

5.3.2 Lidhur me automjetin tip “Audi”, prodhim i vitit 1982, në pronësi të subjektit

⁷⁷ Në përgjigje të pyetësorit nr. 1, subjekti ka paraqitur kontratën e shitjes së automjetit në analizë.

235. Nga shqyrtimi i dosjes së përcjellë nga DPSHTRR-ja, ka rezultuar se subjekti e ka përfituar këtë automjet nëpërmjet kontratës së shitblerjes nr. ***, datë 23.8.2000, nga shtetasi D. K. (vëllai i subjektit), në vlerën 240.000 lekë.
236. Në dosjen e paraqitur nga ky institucion nuk ka rezultuar dokumentacion tjetër veç kontratës së sipër përshkruar. Në këto kushte, Komisioni e ka ftuar subjektin të bëjë me dije nëse ky automjet vijon të jetë në pronësi të tij.
237. Në përgjigjeve të pyetësorit nr. 3, subjekti ka deklaruar se ky automjet ka dalë nga përdorimi në vitin 2002 dhe është shitur për pjesë këmbimi në një servis automjetesh në vlerën 100.000 lekë. Ai ka vënë në dispozicion të Komisionit shkresën nr. *** prot., datë 17.7.2023, të DRSHTRR-së Durrës, nga e cila rezulton se ky automjet është çregjistruar sipas ligjit nr. 33/2017.
238. Nisur nga sa më sipër, vërehet se nuk kanë rezultuar problematika lidhur me automjetin tip “Audi”, i cili ka qenë në pronësi të subjektit.

5.4 Lidhur me automjetin tip “BMW”, në pronësi të vëllait të bashkëshortes së subjektit, z. B. K., si dhe automjetin tip “Jeep” me targë *, në pronësi të djalit të xhaxhait të tij, z. A. K.**

239. Në përgjigje të pyetësorit nr. 1, subjekti ka deklaruar se gjatë periudhës 2012 – 2013 ka pasur në përdorim automjetin tip “BMW” me targë ***, në pronësi të vëllait të bashkëshortes së tij, z. B. K. Gjatë periudhës 2014 – 2015, subjekti ka deklaruar se ka pasur në përdorim automjetin tip “Jeep” me targë ***, në pronësi të djalit të xhaxhait të tij, z. A. K.
240. Lidhur me automjetin me targë ***, nga shqyrtimi i dosjes së përcjellë nga DPSHTRR-ja është konstatuar se ky mjet është i tipit “Peugeot 307”, prodhim i vitit 2007, që fillimisht ka pasur targën *** dhe më pas ka marrë targën **. Automjeti në fjalë, në kohën kur ka kryer udhëtimin subjekti, ka rezultuar në pronësi të shtetasës S. M., përfituar prej saj me kontratën e dhurimit nr. ***, datë 10.7.2014, nga shtetasi A. M. Aktualisht ka kaluar në pronësi të shtetasës B. D.⁷⁸.
241. I pyetur nga Komisioni lidhur me mosdeklarimin e përdorimit të automjeteve të mësipërme, subjekti ka shpjeguar se sipas tij detyrimi për të deklaruar pasuritë e luajtshme në përdorim është përcaktuar në mënyrë të shprehur për herë të parë në legjislacionin e posaçëm që normon procesin e rivlerësimit, konkretisht nenin D, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenin 30 të ligjit nr. 84/2016.
242. Në lidhje me sa më sipër, Komisioni konstaton se mosdeklarimi i përdorimit të automjeteve në fjalë nga subjekti i rivlerësimit nuk përbën shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 4, shkronja “a” e ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Mbi deklarimin e pasurive të luajtshme të subjektit të rivlerësimit”, për sa kohë ai nuk ka pasur të drejta pronësie mbi to. Ky qëndrim i Komisionit mbështetet edhe në jurisprudencën e Kolegjit⁷⁹, në të cilën është vlerësuar se: “25. ...detyrimi për të deklaruar pasuritë e paluajtshme në përdorim dhe zotërim të

⁷⁸ Automjeti në fjalë ka rezultuar në pronësi të shtetasit E. I. K., i përfituar prej tij me kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 14.8.2014, nga shtetasi J. Sh. Ky i fundit e ka përfituar këtë automjet nga znj. S. Sh. (M.) me anë të kontratës nr. ***, datë 10.7.2014. Në vijim, me kontratën nr. ***, datë 24.10.2014, ky automjet aktualisht ka kaluar në pronësi të shtetasës B. D.

⁷⁹ Vendimi nr. 35, datë 15.12.2020, paragrafi 25.

subjekteve rivlerësuese është përcaktuar në mënyrë të shprehur për herë të parë në legjislacionin e posaçëm që normon procesin e rivlerësimit, konkretisht në nenin D, pika I e Aneksit të Kushtetutës dhe nenin 30 të ligjit nr. 84/2016. Sipas kësaj dispozite ligjore, interpretuar kjo sipas përkufizimit të dhënë në nenin 3, pika 11 e të njëjtit ligj, në drejtim të zëbrthimit të konceptit të pasurisë, objekti i kontrollit të kriterit të pasurisë shtrihet edhe në pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme të subjekteve të rivlerësimit, të cilat janë jo vetëm në pronësi, por edhe në posedim ose përdorim të tyre. Trupi gjykues çmon se një arsytim i tillë mbështetet edhe nga përmbajtja e kërkesave për deklaram sipas deklaratës së interesave privatë periodikë, e cila ndryshon nga deklaratata e pasurisë Vetting, ku në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar, subjekteve të rivlerësimit u është kërkuar të deklarojnë me saktësi dhe në mënyrë të plotë çdo pasuri të paluajtshme në pronësi, posedim ose përdorim të tyre”.

243. Nisur nga informacionet e administruara përgjatë hetimit administrativ, si dhe verifikimeve të kryera në sistemin TIMS, në raport edhe me përdorimin e mjeteve në pronësi të personave të tretë dhe të përdorura nga subjekti dhe personat e lidhur (përfshirë edhe ato automjete me të cilat kanë udhëtuar jashtë shtetit dhe që janë drejtuar nga të tjerë shtetas), Komisioni ka kërkuar informacion nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës, Lezhë⁸⁰, Berat⁸¹ dhe Tiranë⁸², pranë të cilave ka ushtruar detyrën subjekti i rivlerësimit, lidhur me ekzistencën e konfliktit të mundshëm të interesit midis subjektit dhe pronarëve të këtyre automjeteve. Këto gjykata kanë bërë me dije se nuk kanë rezultuar çështje të gjykuara nga subjekti i rivlerësimit me palë shtetasit e sipërcituar.
244. Komisioni i është drejtuar gjithashtu edhe Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, e cila ka bërë me dije se nuk disponohen të dhëna që shtetasit për të cilët ishte kërkuar informacion të jenë lidhur me rekorde kriminale të mundshme, apo të jenë përfshirë në krimin e organizuar⁸³.
245. Nga sa më sipër, Komisioni nuk ka konstatuar problematika lidhur me përdorimin e pasurive të luajtshme automjet (BMW me targë *** dhe Jeep me targë ***) nga ana e subjektit të rivlerësimit.

5.5 Lidhur me udhëtimet e subjektit jashtë vendit me automjete në pronësi të shtetasve të tjerë

246. Nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit⁸⁴, nga të dhënat e nxjerra nga sistemi TIMS, si dhe nga verifikimi i kryer *online* në sistemin elektronik të AMF-së, ka rezultuar se subjekti dhe familja e tij kanë udhëtuar jashtë territorit të Shqipërisë me automjete në pronësi të disa shtetasve të tjerë.
247. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, në lidhje me udhëtimet e kryera, subjekti ka deklaruar se për udhëtimet gjatë të cilave ka qëndruar tek të afërmit ka paguar vetëm shpenzimet e biletave të udhëtimit apo karburantit, në rastet e udhëtimeve me automjete, dhe nuk ka shpenzuar për akomodim dhe ushqim.

⁸⁰ Me shkresën nr. *** prot., datë 20.4.2023.

⁸¹ Me shkresën nr. *** prot., datë 20.4.2023.

⁸² Me shkresën nr. *** prot., datë 27.4.2023.

⁸³ Me shkresën nr. *** prot., datë 2.5.2023.

⁸⁴ Me shkresën nr. *** prot., datë 30.3.2021.

248. Ndërsa për udhëtimet e kryera me kolegët, familjarët apo miqtë e tij, duke përdorur mjetet e tyre, subjekti ka paraqitur shpjegime lidhur me pronarët e këtyre mjeteve, si dhe marrëdhënien përkatëse me ta, për secilin udhëtim të evidentuar nga Komisioni⁸⁵.
249. Gjithashtu, subjekti ka deklaruar se gjatë ushtrimit të detyrës nuk ka qenë në kushtet e konfliktit të interesit, për shkak se nuk ka gjykuar çështje ku palë me ndonjë pozitë të caktuar procedurale të kenë qenë shtetasit e sipërcituar.
250. Sa më sipër, është konfirmuar edhe nga Gjykatat e Rrethit Gjyqësor Kukës⁸⁶, Lezhë⁸⁷, Berat⁸⁸ dhe Tiranë⁸⁹, pranë të cilave ka ushtruar detyrën subjekti, të cilat kanë bërë me dije se nuk kanë rezultuar çështje të gjykuara prej tij, ku palë të kenë qenë shtetasit e sipërpërmendur.

REZULTATET E ANALIZËS FINANCIARE

251. Në vijim të analizës financiare të kryer mbi deklaratimet periodike ndër vite të subjektit, pas përlloraritjeve të kryera në mënyrë të detajuar sipas viteve, janë paraqitur të gjitha të dhënat mbi të ardhurat, shpenzimet, kursimet dhe detyrimet, për çdo vit. Po ashtu, në këtë analizë, janë paraqitur sa vijon:
252. Pasuritë e realizuara nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, të pasqyruara në vitin përkatës të kryerjes së investimit.
253. Të gjitha të ardhurat e deklaruara ndër vite dhe të ardhurat e dokumentuara për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, bazuar në përgjigjet e institucioneve dhe dokumentacionin e paraqitur nga subjekti, bashkëngjitur deklaratës *Vetting*.
254. Shpenzimet jetike janë përlloraritur në bazë të frymëve sipas të dhënave zyrtare nga INSTAT-i.
255. Shpenzimet e udhëtimit janë përlloraritur duke u bazuar në raportin e hyrje-daljeve sipas sistemit TIMS të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të, bazuar në vendimin nr. 11/2019 (JR), datë 22.5.2019, të Kolegjit. Ndërsa për shpenzimet e udhëtimit për në

⁸⁵ Shtetasi H. T. S. është koleg i tij, ndërsa shtetasja L. Xh. S. është bashkëshortja e kolegut dhe me ta ka njohje familjare; shtetasja O. Sh. D. është bashkëshortja e kolegut D. C.; shtetasi B. H. O. është fqinji i subjektit dhe me të ka njohje familjare; shtetasi A. E. K. është shok i përbashkët me kolegun e subjektit, S. P. Mjeti me targë *** është në pronësi të shtetasit A. E. K.; shtetasja A. Z.M. ka qenë punonjëse në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Mirditë, ku subjekti ka ushtruar detyrën; me të ndjerin V. A. B., pronar i mjetit me targë ., subjekti ka deklaruar se ka pasur njohje, koleg pune dhe miqësi familjare; me shtetasin A. A. subjekti ka njohje nga profesioni i tij si avokat; në lidhje me mjetin me targë ***, subjekti ka udhëtuar në periudhën kur mjeti ka qenë në pronësi të shtetasit A. D.; me shtetasin A. D. ka marrëdhënie familjare; lidhur me shtetasin L. K., subjekti ka deklaruar se nuk ka asnjë lidhje dhe nuk e njeh. Me mjetin me targë *** ka udhëtuar kur pronar i këtij mjeti ka qenë djali i xhaxhait të tij A. K.; për shtetasit A. H. dhe M. S., subjekti ka deklaruar se nuk i njeh. Në datën 7.3.2017 ka udhëtuar me kolegë gjyqtarë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë për në Kastoria/Greqi dhe është kthyer në datën 8.3.2017. Ai ka deklaruar se nuk mban mend të ketë udhëtuar me mjetin në pronësi të tyre; me shtetasin A. S., pronar i mjetit me targë ***, subjekti ka deklaruar se ka njohje familjare; lidhur me mjetin me targë ***, ka deklaruar se ky mjet ka qenë në pronësi të shtetasit D. C., kolegut të tij; me shtetasin I. N., pronar i mjetit me targë ***, subjekti ka deklaruar se ka njohje që nga periudha e universitetit dhe deri aktualisht; lidhur me shtetasin S. M., pronare e mjetit me targë ***, subjekti ka deklaruar se nuk i kujtohet të ketë udhëtuar apo të ketë ndonjë lidhje me pronarët e këtij mjeti; lidhur me mjetin me targë ***, në pronësi të shtetasit A. C., ish-koleg i subjektit, ai ka deklaruar se me këtë mjet ka udhëtuar bashkëshortja dhe djali i tij.

⁸⁶ Me shkresën nr. *** prot., datë 25.4.2023.

⁸⁷ Me shkresën nr. *** prot., datë 20.4.2023.

⁸⁸ Me shkresën nr. *** prot., datë 20.4.2023.

⁸⁹ Me shkresën nr. *** prot., datë 27.4.2023.

punë, subjekti ka deklaruar në pyetësin nr. 2 se nga data 24.4.2000 deri në gusht të vitit 2007 përgjithësisht ka udhëtuar me makinën e tij, të kolegëve (A. S., J. H., A. A. etj.) dhe së bashku me ta dhe, në disa raste, me autobusë të linjës. Ai ka sqaruar se: *“Në të gjitha rastet e udhëtimit me makinë kemi ndarë shpenzimet mes njëri-tjetrit, të cilat nuk kanë qenë më shumë se 3.000 lekë në muaj”*.

256. Shpenzimet e shkollimit për periudhën 2010 – 2016 (për djalin e subjektit) janë konsideruar sipas deklaramit të subjektit në përgjigje të pyetësin nr. 1 dhe dokumentacionit të administruar, në të cilin ka deklaruar se djali i tij ka ndjekur shkollën “***. Totali i shpenzuar për vitet 2010 – 2016 është në vlerën 1.045.205 lekë.
257. Në lidhje me shpenzimet e transportit për në vendin e detyrës, për vitet 2000 – 2007, ato janë përlloritur në vlerën 240.000 lekë.
258. Në lidhje me shpenzimet e kryera për mobilimin e banesës, subjekti ka deklaruar në pyetësin nr. 1 se ka shpenzuar 550.000 lekë, të ndarë në vitet 2006 dhe 2015.
259. Shpenzimet lidhur me likuidimin e kredive janë bazuar në përpunimin e të dhënave të administruara nga bankat e nivelit të dytë.
260. Gjendja e likuiditeteve nënkupton gjendjen në fund të çdo viti të ndodhur në të gjitha llogaritë bankare të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të.
261. Kursi i këmbimit i përdorur për të gjitha investimet/shpenzimet/gjendjet bankare në valutë është konsideruar sipas kursit mesatar të fundit të vitit, botuar në faqen zyrtare të Bankës së Shqipërisë⁹⁰.
262. Në këtë analizë janë konsideruar dhe përpunuar të dhënat duke filluar nga viti 2003, vit në të cilin fillon edhe deklarimi i pasurisë nga subjekti i rivlerësimit pranë ILDKPKI-së, nga ku ka rezultuar një bilanc i përgjithshëm negativ në vlerën -1.904.187 lekë. Nga kjo vlerë shuma prej -833.610 lekësh është vjetore dhe shuma prej -1.070.576 lekësh është për pasuri në datën e investimit.
263. Gjithashtu, Komisioni ka konstatuar se subjekti ka rezultuar me pamundësi financiare për vitet 2008, 2009 dhe 2011, në shumën totale -394.207 lekë.
264. Për sa më sipër, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe paragrafin 5 të nenit Ç të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i ka kaluar subjektit barrën e provës për të dhënë shpjegime bindëse lidhur me problematikat e konstatuara në pikat e mësipërme dhe për të paraqitur dokumente ligjore për të provuar të kundërtën e rezultateve të Komisionit për sa i përket pamundësisë financiare të konstatuar për vitet 2008, 2009 dhe 2011, në shumën totale -394.207 lekë.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

265. Subjekti pretendoi që Komisioni të merrte në pamundësinë për të dokumentuar të gjitha të ardhurat e përfutuara nga bashkëshortja, si dhe reduktimin e shpenzimeve të jetesës, pasi ai dhe familja kanë jetuar në qytetin e Kukësit dhe, nga ana tjetër, edhe për shkak të faktit se një pjesë e shpenzimeve në këto vite është kryer në monedhën euro dhe kursi i këmbimit ka qenë më i favorshëm se ai i aplikuar nga Komisioni.

⁹⁰ www.bankofalbania.org

266. Po ashtu, subjekti ka pretenduar se balanca negative e konstatuar nga Komisioni, e shpërndarë në disa vite, ku nuk është kryer asnjë investim, bazuar në parimin e objektivitetit dhe proporcionalitetit, nuk përbën shkak për marrjen e ndonjë mase disiplinore ndaj tij, si dhe ka pretenduar zbatimin e parimit të proporcionalitetit, duke cituar edhe praktikën e përditshme të Komisionit dhe të Kolegjit⁹¹.

Vlerësimi i Komisionit

267. Lidhur me pretendimet e subjektit se balancat negative vijnë për shkak të: (i) mosdokumentimit të të gjitha të ardhurave të përfituara nga bashkëshortja; (ii) për shkak se shpenzimet e jetesës kanë qenë më të ulëta, pasi ka jetuar në qytetin e Kukësit; dhe, nga ana tjetër, edhe (iii) për shkak të faktit se një pjesë e shpenzimeve në këto vite është kryer në monedhën euro dhe kursi i këmbimit ka qenë më i favorshëm se ai i aplikuar nga Komisioni – trupi gjykues arsyeton si vijon:
268. Lidhur me të ardhurat e përfituara nga punësimi i bashkëshortes së subjektit, edhe pse ato janë deklaruar nga ana e tij në DIPP-në e viteve 2006 dhe 2007, subjekti ka paraqitur prova të cilat në mënyrë indirekte konfirmojnë marrëdhënien e punësimit të bashkëshortes së tij, sërish nuk plotësohet kushti i pagesës së tatimit për këto të ardhura, sikurse përcakton dispozita e nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës. Në këto kushte, trupi gjykues ka vlerësuar të mos i përfshijë këto të ardhura në analizën financiare.
269. Sa i përket shpenzimeve të jetesës, ato janë marrë sipas statistikave të INSTAT-it dhe nuk ndryshojnë për rrethe, pavarësisht se stili dhe kostoja e jetesës është e ndryshme për qytete të ndryshme. Metodologjia e përdorur nga Komisioni është e njëjtë për të gjithë subjektet e rivlerësimit, pavarësisht qytetit ku kanë banuar. Shpenzimet e jetesës sipas INSTAT-it janë një mesatare e totalit të kostove në rang vendi.
270. Lidhur me kursin e këmbimit për shlyerjen e kësteve mujore të kredisë së marrë në monedhën euro, në analizën financiare të kryer është marrë kursi mesatar për secilin vit sipas Bankës së Shqipërisë. Për sa kohë që subjekti nuk depozitoi ndonjë dokumentacion për të provuar kur mund t'i ketë kryer transaksionet e këmbimit, Komisioni nuk mund të përcaktojë ekzaktësisht kohën se kur mund të jetë kryer këmbimi i monedhave për çdo kësht për secilin muaj. Trupi gjykues ka vlerësuar të marrë në konsideratë vetëm pretendimin për këmbimin e kryer në datën 9.2.2009, pasi provohet transaksioni i tërheqjes së shumave në monedhën lek dhe depozitimi në monedhën euro, brenda të njëjtës ditë.
271. Në përfundim, pas rilogaritjeve të kryera me pretendimet e marra në konsideratë, është konstatuar se subjekti i rivlerësimit, për periudhën 1997 – 2016, ka rezultuar me mungesë të burimeve të ligjshme në masën 827.590 lekë për krijimin e pasurive në pronësi të tij dhe përballimin e shpenzimeve familjare, siç paraqitet në mënyrë të detajuar në tabelën në vijim, dhe në masën 82.644 lekë për të shlyer kredinë e parakohshme në datën 9.2.2009, të analizuar më sipër në këtë vendimmarrje.

⁹¹ Vendimet nr. 38, datë 6.12.2021, nr. 6, datë 17.3.2022, nr. 20/2023 dhe nr. 19/2022 të Kolegjit.

Analiza financiare për periudhën 1997 – 2016

Nr	Përshkrimi	1997-2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
1	TË ARDHURA	3,355,225	2,822,666	4,519,740	1,953,169	918,861	1,615,432	2,260,191	1,616,789	1,895,141	1,939,286	2,824,459	3,548,408	5,528,910	4,347,035
	Të ardhura nga paga Subjekti	2,830,613	978,888	936,196	935,187	836,821	1,197,156	1,340,950	1,052,038	1,177,014	1,120,999	1,139,365	1,337,976	1,340,812	1,298,229
	Të ardhura nga paga Bashkëshortja	517,123	40,000	500,000	-	70,022	397,441	608,323	561,201	707,260	700,370	1,674,770	2,199,067	4,185,787	3,047,279
	Të ardhura nga interesat	7,489	16,572	20,044	17,982	12,018	20,835	10,918	3,550	10,867	17,917	10,324	11,365	2,311	1,527
	Shitje automjeti benz 190E, targë *** (kontratë Nr.***, datë 20.10.2004)	-	500,000	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
	Shitje automjeti benz 250D, targë *** (kontratë Nr.*** dt.05.08.2009)	-	-	-	-	-	-	300,000	-	-	-	-	-	-	-
	Shitje automjeti Ford Fiesta, targë *** (kontratë Nr.*** dt.11.06.2012)	-	-	-	-	-	-	-	-	-	100,000	-	-	-	-
	Kredi NBG 20.12.2005 (25.000 euro)			3,063,500											
	Kredi RFZ05.07.2006 (1.000.000 lekë)				1,000,000										
	Të ardhura nga periudha e mëparshme	-	1,287,206	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
2	SHPENZIME	1,575,499	314,592	397,065	1,204,053	1,849,114	826,823	2,283,022	1,070,523	1,292,834	1,482,051	1,372,664	1,565,665	3,511,040	1,323,017
	Shpenzime jetese sipas ILDKPKI	1,455,499	281,592	328,671	328,671	409,860	409,860	409,860	409,860	409,860	423,072	423,072	659,994	672,828	705,276
	Shpenzime transporti	120,000	33,000	33,000	33,000	21,000	-	-	-	-	-	-	-	-	-
	Kredi RFZ komision për mbylljen	-	-	-	-	16,789	-	-	-	-	-	-	-	-	-
	Shpenzime TIMS	-	-	35,394	140,843	-	78,221	353,789	284,561	646,553	493,003	505,882	439,756	755,317	617,741
	Shpenzime shkollimi	-	-	-	-	-	-	-	138,810	-	279,440	210,315	210,165	206,475	-
	Shpenzime arredimi	-	-	-	250,000	-	-	-	-	-	-	-	-	300,000	-
	Shpenzime rivlerësimi për apartamentin në Tiranë	-	-	-	-	-	-	-	-	-	59,284	-	-	-	-
	Shpenzime kredia NBG (25.000 euro) (principal+interes)				324,572	317,244	310,164	1,507,988	225,772	224,942	227,252	211,242	244,681	1,531,849	-
	Shpenzime ekstra kredia NBG				-	15,805	28,578	11,385	11,521	11,479	-	22,153	11,069	44,571	-
	Shpenzime kredia RFZ (1.000.000 lekë) (principal +interes)				126,967	1,068,415									
3	PASURI	492,520	1,316,573	4,103,601	988,598	(730,331)	1,085,549	(228,092)	(716,542)	693,554	102,321	1,335,339	1,137,599	722,233	2,041,806
	Pasuri e paluajtshme/e luajtshme														
	Autoveturë benz 190	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
	Apartament sip.89 m2 Tiranë (kontratë sipërmarrje dt.20.01.2004) (vlera 5.070.000 lekë)	-	1,000,000	3,517,548	500,000	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
	Automjet benz 250D (kontratë Nr.***) (31.12.2004) ***	-	300,000	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
	Automjet Ford Fiesta *** (07.06.2007)	-	-	-	-	150,000	-	-	-	-	-	-	-	-	-
	Parcelë e llojit Arë, sip.1.000 m2, në ***, Durrës (10.11.2012)	-	-	-	-	-	-	-	-	-	200,000	-	-	-	-
	Automjet Toyota targë*** (08.08.2016)	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	811,620
	Automjet Audi (23.08.2000)	240,000													
	Ndryshim Likuiditeti	252,520	16,573	586,054	488,598	(880,331)	1,085,549	(228,092)	(716,542)	693,554	(97,679)	1,335,339	1,137,599	722,233	1,230,186
	DIFERENCA (1-2-3)	1,287,206	1,191,501	19,073	-239,482	-199,922	-296,940	205,262	1,262,807	-91,246	354,913	116,456	845,144	1,295,638	982,212

272. Për sa më sipër, trupi gjykues çmon se balanca negative në shumën totale 827.590 lekë, e shpërndarë në 4 vite (2006, 2007, 2008 dhe 2011) në vlera jodomethënëse, nuk mund të përbëjnë shkak për shkarkimin e subjektit.
273. Në përfundim, trupi gjykues, bazuar në parimin e objektivitetit dhe proporcionalitetit, barazisë së palëve, si dhe duke respektuar të drejtat themelore të subjektit të rivlerësimit, në lidhje me vlerësimin e pasurisë, arrin në përfundimin se nga kontrolli i pasurisë subjekti ka rezultuar me mungesë të ardhurash për 4 vite, të cilat nuk janë në atë shkallë sa të përbëjnë shkak për shkarkimin e tij nga detyra. Kjo balancë negative nuk u vlerësua se duhet të krijojë një përgjegjësi disiplinore për subjektin e rivlerësimit, për pasojë, trupi gjykues arriti në konkluzionin se subjekti ka nivel të besueshëm në kriterin e vlerësimit të pasurisë, sipas parashikimit të nenit 59, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016.

B. KONTROLLI I FIGURËS

274. Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (AKSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit. Për këtë qëllim, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, është përcjellë pranë Komisionit raporti i Grupit të Punës nr. *** prot., datë 30.10.2017, i përpiluar pa përgjigjen e njërit prej autoriteteve verifikuese, me të cilin ishte konstatuar përshtatshmëria e subjektit për vazhdimin e detyrës.
275. Në vijim, Komisioni i ka kërkuar AKSIK-së përditësimin dhe rishikimin e mundshëm të raportit fillestar të përcjellë për këtë subjekt rivlerësimi. Në përgjigje të kësaj kërkesë, AKSIK-ja, me shkresat e datave 7.8.2023 dhe 2.9.2023 ka përcjellë dy shkresa të organeve ligjzbatuese, të cilat kanë bërë me dije se nuk dispononin informacione lidhur me veprimtari të kundërligjshme nga ana e këtij subjekti rivlerësimi.
276. Më tej, AKSIK-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 15.8.2023, ka përcjellë pranë Komisionit raportin e mësipërm (nr. *** prot.), të deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. ***, datë 14.8.2023, të KDZH-së.
277. Nga hetimi i kryer nga Komisioni nuk ka rezultuar që subjekti i rivlerësimit të ketë qenë i përfshirë në veprimtari të kundërligjshme apo të ketë pasur ndonjë kontakt të papërshtatshëm me persona të përfshirë në krimin e organizuar. Kësisoj, në përfundim të rivlerësimit për kriterin e kontrollit të figurës, bazuar në të dhënat që disponohen, Komisioni konstaton se subjekti i rivlerësimit Flamur Kapllani: (i) nuk rezultoi që të ketë pasur apo të ketë aktualisht kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar; (ii) ka dorëzuar në kohë deklaratën për kontrollin e figurës; (iii) nuk ka bërë deklaratime të pasakta, të paplota dhe nuk ka fshehur të dhëna apo kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar. Kësisoj, subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel të besueshëm në kriterin e kontrollit të figurës.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

C/1. Lidhur me analizën e aftësive profesionale nga KLGJ-ja

278. Komisioni, në bazë të neneve 40 - 44 të ligjit nr. 84/2016, pasi ka analizuar raportin e KLGJ-së, si dhe dokumentacionin e bashkëlidhur, ka kryer rivlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit Flamur Kapllani, në përputhje me nenin E të Aneksit të Kushtetutës.

279. Rivlerësimi i aftësive profesionale është mbështetur në: (a) raportin për analizimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, të kryer dhe të përcjellë në Komision; (b) informacionin e marrë nga burime të ligjshme, si i tillë është konsideruar informacioni i marrë nga denoncimet dhe organet ligjzbatuese, burime të cilat, kur ka qenë nevoja, i janë nënshtruar verifikimit të vërtetësisë së tyre nga Komisioni; (c) kriteret e vlerësimit të parashikuara në nenin 71 e vijues të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.
280. Raporti i përcjellë nga KLGJ-ja është kontrolluar në drejtim të saktësisë dhe standardizimit të tij, raport i cili ka të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kriterëve të vlerësimit, si: (i) aftësive profesionale; (ii) aftësive organizative; (iii) etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale; (iv) aftësive personale dhe angazhimit profesional.
281. Nga të dhënat që ndodhen në sektorin e burimeve njerëzore pranë Këshillit të Lartë të Gjyqësor nuk ka rezultuar të jetë marrë ndonjë masë disiplinore ndaj subjektit të rivlerësimit Flamur Kapllani.

C/2. Rivlerësimi i aftësive profesionale nga Komisioni

282. Komisioni, në bazë të neneve 40 - 44 të ligjit nr. 84/2016, pasi ka analizuar raportin e KLGJ-së dhe dokumentacionin përkatës, si dhe lidhur me tri dokumentet ligjore të depozituara prej subjektit dhe pesë dosjet e shortuara, ka konstatuar sa vijon:

1. Lidhur me dosjen nr. 1, që i përket çështjes nr. * akti, datë 17.2.2014**

283. KLGJ-ja ka konstatuar se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. *** (***) , datë 13.12.2017, ka vendosur: “Prishjen e vendimit nr. *** , datë 9.12.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe vendimit nr. *** , datë 15.5.2014, të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë”. Në këtë vendim, Gjykata e Lartë ka arsyetuar ndër të tjera se me vendimin unifikues administrativ nr. *** , datë 6.12.2013, është përcaktuar se çështjet që përbëjnë mosmarrëveshje administrative, pavarësisht gjendjes, fazës apo shkallës së gjykimit, janë kompetencë e gjykatave administrative.
284. Gjithashtu, KLGJ-ja ka konstatuar se gjykimi i çështjes në fjalë ka zgjatur tej afatit 6-mujor të caktuar nga pika 5, shkronja “e” e Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit, seancat janë caktuar me distancë rreth 1 muaj nga njëra-tjetra dhe nuk janë dokumentuar me regjistrim audio.
285. Për sa më sipër, Komisioni e ftoi subjektin të jepte shpjegime mbi kompetencën lëndore në këtë gjykim, si dhe në lidhje me konstatimin se vendimi i dhënë është prishur nga Gjykata e Lartë, me arsyetimin se është dhënë në shkelje të rënda procedurale.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

286. Subjekti ka parashtruar se vendimi i dhënë prej tij është shpallur në datën 9.12.2013. Ndërkohë që vendimi unifikues nr. 3, datë 6.12.2013, i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 215/2013, datë 6.3.2014⁹². Subjekti ka shpjeguar se në vitin 2013 faqja zyrtare e Gjykatës së Lartë nuk ka ofruar këtë informacion që ofron ditët e sotme. Referuar kuadrit ligjor në fuqi në kohën e vendimmarrjes, konkretisht nenit 19/3 të ligjit nr. 8588, datë 15.3.2000 “Për organizimin dhe funksionimin

⁹² Fletorja Zyrtare mund të aksesohet në faqen zyrtare të Qendrës së Botimeve, me adresë <https://qbz.gov.al/eli/fz/2013/215/a38ddba0-b64f-4b4b-bdd6-9fb8f37665f3>

e Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë”, vendimet e Gjykatës së Lartë, për njësimin ose ndryshimin e praktikës gjyqësore, botoheshin detyrimisht në numrin më të parë të Fletores Zyrtare. Për rrjedhojë, ai nuk ka pasur mundësi për t’u njohur në momentin e vendimmarrjes objekt shqyrtimi, datë 9.12.2013, me përmbajtjen e vendimit unifikues të sipërcituar.

287. Subjekti ka parashtruar gjithashtu se në kohëzgjatjen e këtij gjykimi kishte ndikuar fakti se Gjykata e Rrethit Tiranë dhe vetë subjekti si gjyqtar ka pasur një ngarkesë shumë më të lartë krahasuar me gjykatat e tjera. Për shkak të numrit të lartë të proceseve gjyqësore, nuk ishte e mundur që të gjitha seancat të zhvilloheshin me regjistrim audio.

Vlerësimi i trupit gjykues

288. Pas shqyrtimit të prapësimeve të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, Komisioni ka konstatuar se çështja në fjalë ishte regjistruar në datën 8.2.2013 dhe deri më 4.11.2013, kur ka hyrë në fuqi ligji nr. 49/2012, ishin zhvilluar 9 seanca, nga 10 që kanë qenë gjithsej. Duke qenë se ky ligj është procedural dhe nuk përmban dispozita kalimtare që të tregojnë se cila është gjendja, faza apo shkalla e gjykimit të një mosmarrëveshjeje gjyqësore mbi të cilën ky ligj i shtrin efektet, kjo situatë faktike është rregulluar përmes vendimit unifikues të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, me anë të të cilit është konkluduar se: *“Gjykatat administrative të shkallës së parë, Gjykata e Apelit Administrativ dhe Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, të krijuara me ligjin nr. 49, datë 3.5.2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, janë kompetente për shqyrtimin e të gjitha çështjeve, të cilat sipas nenit 7 të këtij ligji përbëjnë mosmarrëveshje administrative, pavarësisht gjendjes, fazës apo shkallës së gjykimit”.*
289. Në vlerësim të kësaj çështjeje, Komisioni ka marrë në konsideratë: (i) faktin se bëhet fjalë për një fazë implementimi të një ligji të ri; (ii) periudhën e shkurtër kohore nga data e daljes së vendimit unifikues deri në datën e përfundimit të shqyrtimit gjyqësor dhe shpalljes së vendimit nga ana e subjektit (3 ditë); (iii) pamundësinë e subjektit për të marrë dijeni në kohë reale për vendimin unifikues që rregullonte situatën në fjalë; si dhe (iv) faktin se edhe pas rigjykimit është arritur në të njëjtin konkluzion sikurse kishte arritur edhe subjekti i rivlerësimit. Në këto kushte, trupi gjykues vlerëson se shpjegimi i subjektit se në kohën e vendimmarrjes nuk ka pasur dijeni për vendimin unifikues të datës 9.12.2013, ndonëse nuk zbeh shkeljen procedurale të konstatuar lidhur me juridiksionin e çështjes, sërish nuk mund të shërbejë si shkak i vetëm dhe i mjaftueshëm për penalizimin e tij.
290. Ndërsa, për sa i takon kohëzgjatjes së gjykimit, e cila ka qenë në kapërcim të afatit standard të gjykimit, kjo ka ardhur si pasojë e ngarkesës së lartë të subjektit, fakt i evidentuar edhe në raportin e KLGJ-së⁹³. Megjithatë, Komisioni çmon se afatet e caktuara nga ish-KLD-ja ishin afate orientuese dhe jo detyruese për gjyqtarët. Afatet ligjore të gjykimit, detyruese, janë vetëm ato të caktuara nga neni 399/2 i Kodit të Procedurës Civile. Sipas kësaj dispozite: *“1. Afate të arsyeshme të përfundimit të hetimit, gjykimit apo ekzekutimit të një vendimi të formës së prerë, për qëllimet e përcaktuara në nenin 399/1, do të konsiderohen: (...)* b) *në gjykimin civil në shkallë të parë përfundimi i procesit të gjykimit brenda dy viteve; (...).”.* Në rastin në fjalë, çështja është gjykuar nga subjekti i rivlerësimit brenda 9 muajve,

⁹³ Në këtë drejtim, vetë KLGJ-ja në raportin e saj të vlerësimit ka konstatuar se në rastin e subjektit të rivlerësimit Flamur Kapllani, ngarkesa e tij sasiore në tre vjet ka qenë mbi standardin minimal të aplikuar.

pra në respektim të afatit ligjor 2-vjeçar. Po kështu, edhe vendimi përfundimtar i dosjes në fjalë është dorëzuar i arsyetuar brenda afatit ligjor.

291. Përpos sa më sipër, është evidentuar gjithashtu se në periudhën në fjalë subjekti i rivlerësimit ka qenë anëtar i ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe megjithëse sipas kuadrit ligjor në fuqi duhet të kishte ngarkesë të reduktuar në shpërndarjen e dosjeve gjyqësore, ai ka dorëzuar e përfunduar vetëm brenda vitit 2013 mbi 200 dosje gjyqësore. Pra, ai ka zhvilluar një proces të rregullt ligjor dhe në respektim të afatit të parashikuar nga Kodi i Procedurës Civile.
292. Së fundi, për sa i përket mungesës së regjistrimit audio të seancave gjyqësore, sikurse ka parashtruar edhe subjekti, gjendja e infrastrukturës në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe numri i pamjaftueshëm i sallave të gjykimit diktonte zhvillimin e tyre në zyrat e gjyqtarëve, duke ia dedikuar sallat e gjykimit vetëm rasteve të veçanta, që kërkonin kushte shtesë sigurie, apo në raste të cilat regjistrimi audio ishte kërkesë e palëve ndërgjyqëse.

2. Lidhur me dosjen nr. 2, që i përket çështjes civile nr. * regj., datë 4.3.2013**

293. KLGJ-ja ka konstatuar se gjykimi ka zgjatur 9 muaj e 3 ditë, pra tej afatit 6-mujor të caktuar nga pika 5, shkronja “e” e Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit. Rrjedhimisht, kohëzgjatja e gjykimit nga subjekti i rivlerësimit nuk respekton standardin e procesit të rregullt ligjor, të përcaktuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së.
294. Për sa më sipër, Komisioni e ka ftuar subjektin të jepte shpjegime lidhur me kohëzgjatjen e gjykimit të çështjes së sipërcituar.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

295. Subjekti ka parashtruar se në këtë çështje vetëm dy seanca janë shtyrë, për shkak se ai duhet të ishte prezent në mbledhjet e ish-KLD-së, në cilësinë e anëtarit të saj. Dy seanca janë shtyrë me kërkesë të palës së paditur, për t'i krijuar mundësinë përfaqësueses së legjitimuar në gjykim për të realizuar mbrojtjen e interesave të institucionit shtetëror. Po kështu, me kërkesë të palës paditëse në atë proces, gjatë zhvillimit të gjykimit është realizuar edhe ekspertimi në fushën e kontabilitetit. Në gjykim është thirrur eksperti I. D. Me qëllim përgatitjen e aktit të ekspertimit, është shtyrë edhe seanca gjyqësore e datës 4.11.2013. Po me kërkesë të palëve është shtyrë edhe seanca gjyqësore e datës 25.11.2013. Palët prezente në këtë seancë kanë kërkuar që diskutimi përfundimtar të paraqitet me shkrim. Në bazë të nenit 302 të Kodit të Procedurës Civile, me kërkesë të palëve, gjykata iu jep atyre një afat deri në 5 ditë për të përgatitur parashtrësit e tyre me shkrim.

Vlerësimi i trupit gjykues

296. Pas analizimit të shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues çmon se nuk konstatohen veprime të subjektit me qëllim zvarritjen e gjykimit. Në administrimin e çështjes në fjalë nuk vërehen shtyrje të pajustificuara të seancave gjyqësore nga subjekti i rivlerësimit. Çështja është gjykuar nga subjekti i rivlerësimit në respektim të afatit ligjor 2-vjeçar, të sanksionuar nga neni 399/2 i Kodit të Procedurës Civile.

3. Lidhur me dosjen nr. 3, që i përket çështjes nr. * regj., datë 18.11.2011**

297. Për këtë çështje, KLGJ-ja ka konstatuar tejkallim të afatit të gjykimit, ndryshim të trupit gjykues në kundërshtim me nenin 154/a/2 të Kodit të Procedurës Civile dhe nenet 72, 73 e 74 të këtij Kodi, për rastet e largimit nga trupi gjykues të një gjyqtari të caktuar sipas shortit

dhe se vendimi i dhënë nga subjekti është prishur nga Gjykata e Apelit, për shkelje procedurale.

298. Për sa i përket menaxhimit të çështjes nga subjekti, Komisioni ka çmuar të marrë në konsideratë se referuar të dhënave nga burimet arkivore të KLGJ-së subjekti ka pasur një ngarkesë dukshëm më të lartë se ajo e përcaktuar në sistemin e vlerësimit, pasi për 3 vite ka shqyrtuar 730 çështje. Ndërkohë që, bazuar në 3 shkronjën “e” të Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit në aspektin sasior, ngarkesa e tij duhet të ishte jo më pak se 360 çështje. Për çështjen në fjalë janë zhvilluar gjithsej 17 seanca (4 seanca përgatitore dhe 13 seanca gjyqësore), nga të cilat 12 kanë qenë produktive. Pengesë për 5 seancat joproduktive është bërë mosformimi i trupit gjykues. Megjithatë, gjykimi ka qenë brenda afatit të përcaktuar nga pika 1, shkronja “b” e nenit 399/2 të Kodit të Procedurës Civile, ku parashikohet se: *“Afate të arsyeshme të përfundimit të hetimit, gjykimit apo ekzekutimit të një vendimi të formës së prerë, për qëllimet e përcaktuara në nenin 399/1, do të konsiderohen: ... b) në gjykimin civil në shkallë të parë përfundimi i procesit të gjykimit brenda dy viteve...”*.
299. Gjatë hetimit, Komisioni ka konstatuar se vendimi nr. ***, datë 20.11.2014, i dhënë nga subjekti, është prishur nga Gjykata e Apelit me vendimin nr. ***, datë 23.6.2016 dhe çështja është dërguar për rigjykim në atë gjykatë, me tjetër trup gjykues. Kjo gjykatë ka arsyetuar se vendimi është rrjedhojë e shkeljeve të rënda procedurale lidhur me përbërjen e rregullt të trupit gjykues, përveçse e një hetimi gjyqësor të mangët, duke disponuar për rrëzimin e padisë, pa e shqyrtuar atë në themel.
300. Për sa më sipër, Komisioni i ka mundësuar subjektit dhënien e shpjegimeve lidhur me përbërjen e trupit gjykues dhe hetimin e mangët, sikurse kishte konstatuar Gjykata e Apelit.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

301. Subjekti ka parashtruar se për shkak të transferimit të gjyqtarës së çështjes, si dhe pas rishortimit në datën 4.11.2013, bazuar në nenin 181 të Kodit të Procedurës Civile, është vlerësuar se gjykimi i çështjes me nr. *** duhet të niste nga fillimi. Për shkak të vlerës së padisë, konform nenit 35 të Kodit të Procedurës Civile dhe sipas urdhrit nr. 9, datë 21.1.2013, të Kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, shqyrtimi i saj është bërë me trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë, me relator gjyqtarin Flamur Kapllani dhe anëtarë të trupit gjykues A. G. dhe J. H.
302. Për sa i përket konstatimit të Gjykatës së Apelit mbi mangësinë e hetimit gjyqësor, subjekti ka parashtruar se nga hetimi gjyqësor ishte provuar se prona objekt gjykimi e pretenduar nga paditësi (Xh.), me anë të vendimit nr. ***, datë 23.2.1996, të Gjykatës së Rrethit Tiranë, i ishte njohur palës së paditur (familjes B.), e cila detyrimisht duhet të ishte prezente në këtë gjykim. Në të kundërt, sipas subjektit, do të ndodheshim përpara një situatë që për të njëjtën pronë do të njiheshin pronarë me vendim gjyqësor dy subjekte të ndryshme të së drejtës, pra familja Xh. dhe ajo B., çka vjen në kundërshtim me parimin e procesit të rregullt ligjor.
303. Pikërisht, për të shmangur këto problematika në drejtim të formimit të detyrueshëm të ndërëgjyqësisë pasive, ligjvënësi nëpërmjet ligjit nr. 38/2017, datë 30.3.2017, ka shtuar shkronjën “ç” në nenin 161 të Kodit të Procedurës Civile. Sipas kësaj dispozite: *“ç) nëse vendimi nuk mund të jepet përveçse kundrejt shumë personave, në rastin e bashkëndërgjyqësisë së detyrueshme, këta të fundit duhet të thirren si të paditur në të njëjtin proces. Gjyqtari, kur konstaton se bashkëndërgjyqësia e detyrueshme në anën e të*

paditurve është e paplotë, i lë palës paditëse një afat deri në 20 ditë që ta rregullojë atë, sipas shkronjës “c” të këtij neni dhe nenit 154/a të këtij Kodi. Në rast se paditësi nuk vepron brenda afatit të mësipërm, gjykata vendos pushimin e gjykimit”.

304. Subjekti ka shpjeguar se në kohën e marrjes së vendimit nr. ***, datë 20.11.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, neni 161 i Kodit të Procedurës Civile nuk e përmbante shkronjën “ç” të tij. Për këtë shkak, Gjykata e ka pasur të pamundur për të ndikuar në vullnetin e palës paditëse në formimin e bashkëndërgjyqësisë së detyrueshme pasive. Për këtë arsye, me gjithë orientimin e dhënë gjatë shqyrtimit të rastit, në mungesë të një reagimi të këtij subjekti, në përfundim të hetimit gjyqësor të çështjes gjykata ka disponuar me vendim për rrëzimin e padisë.

Vlerësimi i trupit gjykues

305. Duke qenë se aktualisht çështja mbi bazën e rekursit të paraqitur nga Avokatura e Shtetit është duke u shqyrtuar nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë – për sa kohë që Gjykata e Lartë nuk e ka dhënë vendimin përfundimtar mbi këtë çështje – Komisioni nuk mund të konkludojë lidhur me shkelje procedurale të mundshme të kryera nga subjektit në vendimmarrjen në fjalë.

4. Lidhur me disa ankesa të trajtuara nga KLGJ-ja⁹⁴

306. KLGJ-ja ka bërë me dije se për subjektin Flamur Kapllani ishin paraqitur 10 ankesa⁹⁵. Për 5 prej këtyre ankesave është vendosur arkivimi, pasi nuk janë evidentuar fakte dhe rrethana për verifikim⁹⁶. Ndërsa 5 ankesat (2 në vitin 2014 dhe 3 në vitin 2016) janë verifikuar, dhe është konkluduar si vijon:
- a. Ankesa nr. ***, datë 31.3.2014, pasi është verifikuar është arkivuar sepse nuk kanë rezultuar shkelje nga ana e gjyqtarit.
 - b. Ankesa nga i njëjti shtetas me nr. ***, datë 15.4.2014, me objekt “Dhënien e një vendimi në kundërshtim me një vendim unifikues”, është verifikuar për mosrespektim formal të ligjit dhe shkelje të etikës dhe i është përcjellë ILD-së. ILD-ja⁹⁷, me vendimin nr. ***, datë 1.7.2020, e ka arkivuar ankesën e mësipërme, me arsyetimin se ajo ishte përcjellë në tejkalim të afatit (pasi pretendimet për shkelje disiplinore shqyrtohen brenda 5 viteve nga data kur pretendohet të jetë kryer shkelja, në të kundërt, bazuar në nenin 117 të ligjit nr. 96/2016, parashkruhet e drejta e ankimit) dhe, për rrjedhojë, nuk mund të shqyrtohej.
 - c. Ankesa nr. ***, datë 28.1.2016, e shtetases K. T., është verifikuar dhe më pas arkivuar, pasi shkelja e pretenduar ishte parashkruar (pretendimi i referohej një çështjeje që kishte filluar në vitin 2005 dhe ka përfunduar në vitin 2015).
 - d. Ankesa nr. ***, datë 1.8.2016, nga shtetasi P. Z., është arkivuar, pasi nuk rezultuan shkelje.

⁹⁴ Me shkresën nr. *** prot., datë 15.10.2021.

⁹⁵ Konfirmuar edhe nëpërmjet informacionit të përcjellë nga ILD-ja me shkresën nr. *** prot., datë 8.5.2023.

⁹⁶ Konkretisht: 2 ankesa janë arkivuar (ankesa nr. ***, datë 16.10.2013, nga shtetasi P. Ç., së cilës i është kthyer përgjigje: “Pretendimet zgjidhen nëpërmjet apelimit”; dhe ankesa nr. ***, datë 22.9.2016, nga shtetasi S. Gj., arkivuar pasi nuk përmbante fakte dhe rrethana për verifikim); 3 ankesa të vitit 2014 janë arkivuar pasi ishin të përsëritura (ankesa nr. ***, datë 8.1.2014, e shtetasis P. Ç.; ankesa nr. ***, datë 21.3.2014, e cila është bashkuar me ankesën e shoqërisë “*****” sh.a., me nr. ***, datë 30.4.2014).

⁹⁷ ILD-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 5.5.2023.

- e. Ankesa nr. ***, datë 19.7.2016, ku ngriheshin pretendime për zvarritje gjykimi, i është regjistruar gjyqtarit për efekt të vlerësimit profesional dhe etik.
307. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar nga KLGJ-ja⁹⁸, lidhur me ankesën e mësipërme, është konstatuar se nga data 7.2.2013, kur ishte regjistruar çështja objekt ankimi, deri në dhënien e vendimit nga subjekti në datën 20.4.2013, ishin zhvilluar gjithsej 35 seanca. Nga këto, 9 prej tyre ishin shtyrë me kërkesë të paditësit, 4 seanca ishin shtyrë për njoftim eksperti, 7 ishin shtyrë për verifikimin e shkaqeve të pezullimit etj. Procesi gjyqësor është pezulluar për një afat kohor 1 vit e 13 ditë dhe gjykimi i çështjes ka zgjatur 3 vjet, 2 muaj e 13 ditë. Në përfundim të procedurës së verifikimit të ankesë së z. Z., KLGJ-ja ka arritur në përfundimin se: *“Gjykimi i kësaj çështjeje është tej afatit maksimal të gjyqimit dhe shkaqet që kanë sjellë tejkalimin e këtij afati duhet t’i evidentohen gjyqtarit vetëm si e dhënë statistikore për efekt të vlerësimit profesional dhe etik të tij”*. Gjithashtu, KLGJ-ja në shkresën dërguar Komisionit është shprehur se: *“Efektet e konkluzionit të mësipërm, si një nga burimet e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve, do të vlerësohen vetëm nëse gjyqtari kalon me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar nga KPK-ja”*.
308. Në shkresën e ILD-së, të cituar më sipër, është bërë me dije gjithashtu se kanë rezultuar edhe disa ankesa të tjera veç atyre të sipërpërmendura dhe të trajtuara edhe në raportin e KLGJ-së, konkretisht 11 ankesa (pas vitit 2016) për të cilat, pas shqyrtimit, ILD-ja ka vendosur arkivimin e tyre⁹⁹. Gjithashtu, kanë rezultuar edhe 3 ankesa, për të cilat ILD-ja ka bërë me dije se ndodhen në fazën e shqyrtimit fillestar¹⁰⁰. Komisioni ka përsëritur kërkesën drejtuar këtij institucioni, me qëllim përditësimin lidhur me statusin e këtyre ankesave. ILD-ja¹⁰¹ ka bërë me dije se pas shqyrtimit të ankesave kishte vendosur arkivimin e tyre, pasi nuk ishin evidentuar problematika.
309. Sipas të dhënave të regjistrimit të procedimeve disiplinore, për gjyqtarin Flamur Kapllani përgjatë periudhës së rivlerësimit nuk ka rezultuar ndonjë kërkesë për procedim disiplinor apo të jetë dhënë ndonjë masë disiplinore nga ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë.
310. Prokuroria e Përgjithshme¹⁰² ka përcjellë dokumentacionin, nga i cili ka rezultuar se ndaj z. Kapllani është regjistruar kallëzimi penal nr. ***, datë 13.10.2020, për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Për këtë kallëzim, në

⁹⁸ Me shkresën nr. *** prot., datë 8.5.2024.

⁹⁹ Ankesa e Zyrës së Avokatisë ADCA me nr. *** prot., datë 18.10.2017, lidhur me të cilën ILD-ja pas shqyrtimit ka vendosur arkivimin e saj; ankesa e shtetasit S. V. me nr. *** prot., datë 15.12.2017, lidhur me të cilën ILD-ja pas shqyrtimit ka vendosur arkivimin e saj; ankesa e shtetasit I. S. me nr. *** prot., datë 2.7.2018, lidhur me të cilën ILD-ja pas shqyrtimit ka vendosur arkivimin e saj; ankesa e shtetasit H. H. me nr. *** prot., datë 27.7.2017, lidhur me të cilën ILD-ja pas shqyrtimit ka vendosur arkivimin e saj; ankesa e shtetasit K. K. me nr. *** prot., datë 3.12.2018, lidhur me të cilën ILD-ja pas shqyrtimit ka vendosur arkivimin e saj; ankesa e shtetasit P. R. me nr. *** prot., datë 1.2.2019, lidhur me të cilën ILD-ja pas shqyrtimit ka vendosur arkivimin e saj; ankesa e shoqërisë “****” me nr. *** prot., datë 24.4.2019, lidhur me të cilën ILD-ja pas shqyrtimit ka vendosur arkivimin e saj; ankesa e shtetasit P. R. me nr. *** prot., datë 10.6.2020, lidhur me të cilën ILD-ja pas shqyrtimit ka vendosur arkivimin e saj; ankesa e shtetasit A. Xh. me nr. *** prot., datë 11.2.2020, lidhur me të cilën ILD-ja pas shqyrtimit ka vendosur arkivimin e saj; ankesa e shtetasit S. V. me nr. *** prot., datë 26.6.2020, lidhur me të cilën ILD-ja pas shqyrtimit ka vendosur arkivimin e saj; ankesa e shtetasit A. S. me nr. *** prot., datë 24.2.2021, lidhur me të cilën ILD-ja pas shqyrtimit ka vendosur arkivimin e saj.

¹⁰⁰ Ankesa e shtetasit B. B. me nr. *** prot., datë 9.3.2020; ankesa e shtetasit P. R. me nr. *** prot., datë 7.3.2019; ankesa e shtetasit D. K. me nr. *** prot., datë 31.5.2021.

¹⁰¹ Me shkresën nr. *** prot., datë 29.3.2024.

¹⁰² Me shkresën nr. *** prot., datë 29.4.2021, është përcjellë shkresa e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me nr. *** prot., datë 2.4.2021.

datën 28.10.2020, Prokuroria ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, me arsyetimin se kallëzimi nuk përmbante elementet thelbësore të faktit penal të pretenduar nga ankuesi, burimet e provës dhe çdo gjë tjetër në interes të hetimit, sipas parashikimeve të nenit 283 të Kodit të Procedurës Penale.

311. Po ashtu, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, me shkresën nr. *** prot., datë 31.3.2021, ka bërë me dije se ndaj subjektit të rivlerësimit kanë rezultuar të regjistruar 4 materiale hetimore (kallëzime), lidhur me të cilët është vendosur mosfillimi i procedimit penal, për shkak se nuk janë konstatuar elemente të veprës penale. Gjithashtu, ky institucion ka përcjellë dosjet e procedimeve në fjalë, si dhe vendimet përkatëse¹⁰³.
312. Në vijim të kërkesës së Komisionit, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës¹⁰⁴ ka përcjellë kopjen e fashikullit të hetimit me nr. ***. Nga analizimi i dokumenteve të administruara ka rezultuar se Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin e datës 2.3.2020 ka vendosur “Mosfillimin e procedimit penal”, për shkak se nuk janë evidentuar elemente të veprës penale.
313. Nga shqyrtimi i vendimeve të dhëna lidhur me kallëzimet e bëra ndaj subjektit të rivlerësimit, është konstatuar se: (i) Lidhur me kallëzimin penal nr. ***, është marrë vendimi i mosfillimit të procedimit penal në datën 17.10.2018, me arsyetimin se mungonin elementet e veprës penale; (ii) Lidhur me kallëzimin penal nr. ***, prokuroria ka arsyetuar ndër të tjera se nuk ekzistonte asnjë e dhënë apo fakt që gjyqtari të kishte pasur interes vetjak në gjykimin e çështjes, apo aq më pak që vendimi të jetë dhënë në keqbesim e, për rrjedhojë, është marrë vendimi i mosfillimit të procedimit penal në datën 14.2.2020; (iii) Lidhur me kallëzimin penal nr. ***, prokuroria ka konkluduar se nuk gjendej përpara elementeve të veprës penale “Shpërdorimi i detyrës” – dhe ka vendosur mosfillimin e procedimit në datën 11.2.2019; (iv) Lidhur me kallëzimin penal nr. ***, është marrë vendimi i mosfillimit të procedimit penal në datën 2.3.2020, me arsyetimin se mungonin elementet e veprës penale.

DENONCIME NGA PUBLIKU

314. Pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në nenin 53 të ligjit nr. 84/2016, për subjektin e rivlerësimit Flamur Kapllani janë paraqitur 25 denoncime nga publiku. Nga këto, 5 denoncime kanë qenë të përsëritura. Dy prej tyre (me të njëjtën përmbajtje) referonin edhe të dhëna për kriterin pasuror, për rrjedhojë janë trajtuar edhe në rubrikën e rivlerësimit të pasurisë.
315. Komisioni, me qëllim vlerësimin e aspektit etik dhe profesional, analizoi të gjitha denoncimet e depozituara, së bashku me materialet përkatëse, duke konstatuar se: (i) disa prej tyre nuk përmbanin elemente/referenca konkrete lidhur me rrethana specifike, që do të mundësonin analizimin e akteve përkatëse; (ii) disa denoncime nuk kishin lidhje me aktivitetin profesional të subjektit; (iii) ndërkohë që janë shqyrtuar të gjitha denoncimet e tjera, lidhur me të cilat është konstatuar sa vijon:

¹⁰³ *Materiali hetimor nr. ***, për të cilin është marrë vendimi i mosfillimit të procedimit penal në datën 17.10.2018; materiali hetimor nr. ***, për të cilin është marrë vendimi i mosfillimit të procedimit penal në datën 11.2.2019; materiali hetimor nr. ***, për të cilin është marrë vendimi i mosfillimit të procedimit penal në datën 14.2.2020; materiali hetimor nr. ***, për të cilin është marrë vendimi i mosfillimit të procedimit penal në datën 2.3.2020.*

¹⁰⁴ Me shkresën nr. *** prot., datë 20.4.2023.

1. Denoncimi nr. * prot., datë 15.10.2018, i shtetas J. Z.**

316. Shtetasja J. Z., në denoncimin e paraqitur ka përmendur subjektin, duke parashtruar se i është cenuar e drejta për të ndrequr të metat e padisë së depozituar prej saj, pasi i është kthyer me vendimin nr. ***, datë 13.3.2018, të Gjykatës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë. Ajo ka pretenduar shkelje procedurale (neni 154/a i Kodit të Procedurës Civile) nga ana e subjektit, njëanshmëri dhe zbardhje të vendimit në tejkalim të afatit (ndërkohë që dispozitivi është shpallur brenda afatit).
317. Gjatë hetimit, Komisioni ka administruar dokumentacionin¹⁰⁵ që i përket çështjes objekt denoncimi dhe ka konstatuar se vendimi i sipërcituar është dhënë nga një tjetër gjyqtar. Për rrjedhojë, pretendimi i saj për mosrespektim të nenit 154/a të Kodit të Procedurës Civile nga ana e subjektit, ka rezultuar i pabazuar. Pas ridepozitimit të padisë nga shtetasja J. Z., çështja është shqyrtuar nga subjekti i rivlerësimit, i cili me vendimin nr. ***, datë 26.9.2018, ka vendosur rrëzimin e saj, për shkak se e ka gjetur të pabazuar në prova e në ligj.
318. Lidhur me pretendimin e denoncueses për njëanshmëri nga ana e subjektit, pasi sipas saj gjyqtari nuk ka marrë në konsideratë pretendimet e saj, por ka vendosur në favor të palës tjetër, Komisioni vlerëson se jemi përballë një vlerësimi në themel të çështjes, që nuk hyn në juridiksionin e organeve të *Vetting*-ut.
319. Për sa i përket pretendimit të denoncueses për zvarritje të procesit gjyqësor, nga shqyrtimi i dokumentacionit (sipas fletës së regjistrimit të çështjeve) ka rezultuar se çështja është regjistruar në gjykatë në datën 29.3.2018. Vendimi është marrë nga subjekti në datën 26.9.2018 dhe është dorëzuar në sekretari më 28.9.2018. Referuar procesverbaleve të seancave gjyqësore, ka rezultuar se janë zhvilluar gjithsej 5 seanca, nga të cilat 2 janë shtyrë për shkaqe shëndetësore të gjyqtarit dhe përfaqësueses së palës paditëse.
320. Për sa më sipër, Komisioni e ka ftuar subjektin të paraqiste shpjegime lidhur me kohëzgjatjen e gjykimit të çështjes në fjalë.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

321. Subjekti ka parashtruar se vetëm një seancë (ajo e datës 28.6.2018) është shtyrë për shkaqe shëndetësore të tij. Ky fakt është pasqyruar në raportin mjekësor nr. *** regj. datë 28.6.2018. Një seancë (e datës 18.7.2018) është shtyrë për shkak se përfaqësuesja e palës paditëse nuk është paraqitur në gjykim, për shkaqe shëndetësore. Ndërsa seanca e radhës është zhvilluar më 6.9.2018, për shkak se muaji gusht ka qenë pushim për gjykatat. Në këtë seancë me kërkesë të palëve dhe në bazë të nenit 302 të Kodit të Procedurës Civile, Gjykata iu ka dhënë afat palëve 5 ditë, për të përgatitur parashtrësat e tyre me shkrim.

Vlerësimi i trupit gjykues

322. Pas shqyrtimit të prapësimeve të subjektit të rivlerësimit, ka rezultuar se në administrimin e çështjes në fjalë nuk vërehen shtyrje të pajustificuara të seancave gjyqësore nga subjekti i rivlerësimit. Çështja është gjykuar nga subjekti i rivlerësimit në respektim të afatit ligjor 2-vjeçar, të sanksionuar nga neni 399/2 i Kodit të Procedurës Civile. Pra, nuk konstatohet

¹⁰⁵ Komisioni ka administruar me shkresën nr. *** prot., datë 17.5.2023, kopje të vendimit të dhënë nga subjekti i rivlerësimit, kopje të fletëthirrjeve për njoftimin e palëve, fletë nga regjistri përkatës i Gjykatës, ku evidentohet data e regjistrimit të çështjes dhe e zbardhjes së vendimit.

asnjë veprim i gjyqtarit me qëllim zvarritjen e gjykimit – dhe as shkelje e afatit standard të gjykimit, apo mosrespektim të afatit 2-vjeçar të parashikuar nga Kodi i Procedurës Civile.

2. Denoncimi nr. * prot., datë 4.1.2018, i shtetases F. M.**

323. Denoncuesja ka pretenduar se lidhur me kërkesëpadinë e saj, subjekti ka dhënë vendimin nr. ***, datë 2.12.2017, i cili sipas saj ka qenë i padrejtë¹⁰⁶.
324. Trupi gjykues, bazuar në pikën 2 të nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe pikën 4 të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016, vlerëson se pretendimi për vendimmarrje të padrejtë është në tejkallim të kompetencës kushtetuese të organeve të rivlerësimit dhe, si i tillë, nuk mund të jetë objekt shqyrtimi nga Komisioni. Pretendimet e kësaj natyre adresohen në gjykatat më të larta, sipas hierarkisë së sistemit gjyqësor.

3. Denoncimet nr. * prot., datë 31.1.2019, nr. *** prot., datë 24.4.2019, nr.*** prot., datë 24.6.2019 dhe nr. *** prot., datë 6.3.2019, të shtetasi P. R.**

325. Shtetasi P. R. ka paraqitur 4 denoncime, duke pretenduar shkelje të ligjit, shpërdorim detyre dhe zvarritje të procesit dhe favorizim të palës së paditur, lidhur me dy çështje në të cilat denoncuesi ka qenë paditës. Denoncuesi ka paraqitur ankim edhe pranë ILD-së¹⁰⁷, e cila ka vendosur arkivimin e ankesës së tij, pasi nuk janë evidentuar shkelje nga ana e subjektit. Po ashtu, denoncuesi ka paraqitur edhe kallëzim ndaj subjektit, për të cilin është marrë vendim mosfillimi¹⁰⁸, pasi nuk ka rezultuar të jenë kryer veprime që përbejnë elemente të veprës penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Po ashtu, në këtë vendim është cituar se për pretendimet e kallëzuesit (denoncuesit në këtë rast) për vendimmarrje të padrejtë, ligji procedural civil ka parashikuar mjete dhe forma procedurale, të cilat mund të përdoren brenda afateve për t’u ankuar në një gjykatë më të lartë.
326. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar¹⁰⁹, sa i takon pretendimeve të parashtruara në denoncimin nr. ***, datë 31.1.2019 dhe atë nr. *** (që i referohen së njëjtës çështje të finalizuar me vendimin, me nr. ***), ka rezultuar se kohëzgjatja e gjykimit ka qenë brenda afatit 6-mujor të përcaktuar nga pika 5, shkronja “e” e Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit¹¹⁰. Çështja është regjistruar në gjykatë në datën 11.1.2017 dhe pasi janë zhvilluar 6 seanca, në datën 11.5.2017, është vendosur pushimi i çështjes për shkak të mosparaqitjes së palëve¹¹¹. Vendimi është depozituar në sekretari në datën 17.5.2017 – dhe ka marrë formë të prerë në datën 30.5.2017.
327. Ndërsa, në denoncimet nr. *** dhe nr. ***, denoncuesi ka pretenduar se i janë refuzuar kërkesat e tij për përjashtimin e subjektit nga gjykimi i çështjes ku ai ka qenë palë. Komisioni ka konstatuar se në një rast denoncuesi është gjobitur me 30.000 lekë nga gjykata, për “abuzim me të drejtën në proces”, bazuar në nenin 34 të Kodit të Procedurës

¹⁰⁶ Gjykata e Apelit, me shkresën nr. ***, datë 28.4.2023, ka bërë me dije se ndaj këtij vendimi nuk është ushtruar ankim.

¹⁰⁷ Sipas informacionit të dërguar me shkresën nr. *** prot., datë 5.5.2023.

¹⁰⁸ Dosja penale është përcjellë me shkresën nr. *** prot., datë 12.3.2021, të Prokurorisë së Përgjithshme.

¹⁰⁹ Me shkresën nr. *** prot., datë 27.4.2023.

¹¹⁰ Sistemi i Vlerësimit përmbledh vendimin nr. ***, datë 14.4.2010 të KLD-së “Sistemi i Vlerësimit të Gjyqtarëve”, së bashku me Aneksin I “Kriteret matëse të veprimtarisë gjyqësore”.

¹¹¹ Në seancën paraprake ishte paraqitur vetëm paditësi¹¹¹, i cili, edhe pse prezent, është njoftuar për seancën e radhës me fletëthirrjen e datës 26.4.2017. Megjithëse është njoftuar, paditësi nuk është paraqitur në seancën gjyqësore. Ndërsa i padituri kundërpaditës/denoncuesi, nuk ishte paraqitur në asnjë nga seancat, ndonëse ishte njoftuar rregullisht dhe ka pasur dijeni për datën dhe orën e seancave.

Civile, pasi ka paraqitur disa herë të njëjtën kërkesë (me të njëjtat pretendime), e cila është rrëzuar më parë nga gjykata.

328. Për sa është parashtruar më sipër, si dhe në mbështetje edhe të konkluzioneve të KLGJ-së në raportin e saj ku janë shqyrtuar e më pas janë arkivuar disa ankesa të paraqitura nga denoncuesi¹¹² (në të cilat përgjithësisht parashtrohen të njëjtat pretendime), nuk kanë rezultuar shkelje procedurale të kryera nga subjekti i rivlerësimit.

4. Denoncimi nr. * prot., datë 6.2.2019, i shtetasit A. Xh.**

329. Shtetasi A. Xh. ka pretenduar se vendimi nr. ***, datë 19.11.2018, është i padrejtë, pasi subjekti me anë të këtij vendimi ka favorizuar palën kundërshtare të tij në procesin gjyqësor. Këtë pretendim denoncuesi e ka adresuar edhe në ILD¹¹³, e cila ka vendosur arkivimin e ankesës, pasi nuk janë evidentuar shkelje të kryera nga subjekti.
330. Pas shqyrtimit të dokumentacionit të administruar, nuk janë evidentuar shkelje procedurale apo favorizim i palës në procesin gjyqësor. Trupi gjykues çmon se pretendimi për vendimmarrje të padrejtë është në tejkalim të kompetencës kushtetuese të organeve të rivlerësimit dhe, si i tillë, nuk mund të jetë objekt shqyrtimi nga Komisioni. Pretendimet e kësaj natyre trajtohen përmes ankimit në gjykatat më të larta.

5. Denoncimi nr. * prot., datë 12.2.2018, i shtetases S. B.**

331. Denoncuesja ka pretenduar se vendimi nr. *** akti, datë 13.5.2016, i dhënë nga subjekti, ka qenë i padrejtë.
332. Gjatë hetimit, Komisioni ka konstatuar¹¹⁴ se gjykatat më të larta nuk kanë evidentuar shkelje procedurale lidhur me këtë vendimmarrje. Konkretisht, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. ***, datë 19.12.2017, ka vendosur: “Lënien në fuqi të vendimit civil nr. *** akti, datë 13.5.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë...”, me anë të të cilit subjekti kishte vendosur: “Pranimin e kërkesëpadisë për sa i përket fazës së parë të pjesëtimit. Lejimin e pjesëtimit të pasurisë së paluajtshme “truall” i ndodhur në rrugën “****”, Tiranë, në bashkëpronësi të palëve ndërgjyqëse...”.
333. Ndaj vendimit të Gjykatës së Apelit është paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë. Kjo e fundit ka arsyetuar se në kuptim të neneve 369 e vijues të Kodit të Procedurës Civile, si dhe nenit 207 të Kodit Civil, gjykimi për pjesëtimin e sendit në bashkëpronësi kalon në dy faza. Vendimi i fazës së parë të pjesëtimit përbën një vendim gjyqësor *sui generis* sepse nuk ka thjesht karakter procedural, por përmes tij zgjidhen në themel dhe në mënyrë përfundimtare çështjet. Ndërsa në fazën e dytë të pjesëtimit merren në shqyrtim kërkesat që mund të kenë bashkëpronarët, si dhe llogaritë që eventualisht duhet të japin midis tyre dhe që rrjedhin nga marrëdhëniet e bashkëpronësisë. Nën këtë arsyetim, Gjykata e Lartë ka vlerësuar se Gjykatat e Apelit nuk kishte përmbushur një nga detyrimet primare të fazës së parë të pjesëtimit të pasurisë, atë të lidhur me sendin që do t’i nënshtrohet pjesëtimit, si dhe pjesëve takuese të secilit bashkëpronar, pasi nuk sqaron dhe identifikon qartë nëse objekt pjesëtimi është vetëm truall apo truall + banesë. Për rrjedhojë, vendimi i dhënë prej saj duhej të

¹¹² Shihni raportin e KLGJ-së dhe dosjen penale të përcjellë me shkresën nr. *** prot., datë 12.3.2021, të Prokurorisë së Përgjithshme.

¹¹³ Me shkresën nr. *** prot., datë 5.5.2023.

¹¹⁴ Me shkresën nr. *** prot., datë 27.4.2023, Komisioni ka administruar kopje të vendimit të dhënë nga subjekti i rivlerësimit, kopje të fletëthirrjeve për njoftimin e palëve, fletë nga regjistri përkatës i Gjykatës, ku evidentohet data e regjistrimit të çështjes dhe data e zbardhjes së vendimit. Gjithashtu, gjatë hetimit janë administruar kopje të vendimeve të dhëna nga gjykatat më të larta lidhur me çështjen objekt shqyrtimi.

prishej dhe çështja të dërgohej për rishqyrtim në këtë gjykatë, me tjetër trup gjykues, për një hetim të plotë e të gjithanshëm.

334. Sikurse evidentohet, vendimmarrja e të dyja gjykatave nuk ka afektuar nga ana procedurale vendimin e dhënë nga subjekti.
335. Pavarësisht parashtrimit të mësipërm lidhur me vendimmarrjet e gjykatave më të larta, në kuadër të një panorame më të qartë të çështjes objekt denoncimi, trupi gjykues çmon se pretendimi i denoncueses për vendimmarrje të padrejtë del jashtë tagrave të Komisionit, pasi i referohet themelit të çështjes.

6. Denoncimi nr. * prot., datë 24.2.2021, i shtetasit A. S.**

336. Shtetasi A. S. ka pretenduar njëanshmëri dhe zvarritje të procesit gjyqësor të finalizuar me vendimin nr. ***, datë 22.1.2021, me anë të të cilit subjekti ka vendosur pranimin e pjesshëm të padisë “*Dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm lidhur me kërkimin për lirimin dhe dorëzimin e pronës. Rrëzimin e kundërpadisë*¹¹⁵...”. Këtë pretendim denoncuesi e ka adresuar edhe në ILD¹¹⁶. Ky institucion e ka arkivuar ankesën e tij, pasi nuk ka evidentuar shkelje.
337. Nga verifikimi i regjistrit të numërorit të vendimeve të gjykatës ka rezultuar se çështja në fjalë është regjistruar në datën 11.6.2020, me nr. ***. Janë zhvilluar gjithsej 5 seanca dhe vendimi është dhënë në datën 22.1.2021. Dosja është dorëzuar në sekretari në datën 3.2.2021. Duke mbajtur në konsideratë faktin se gjykatat gjatë muajit gusht nuk zhvillojnë procese gjyqësore, ka rezultuar se çështja në fjalë është shqyrtuar brenda afatit të përcaktuar nga pika 5, shkronja “e” e Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit¹¹⁷, si dhe afatit të përcaktuar nga neni 399/2 i Kodit të Procedurës Civile.
338. Përpos sa më sipër, Komisioni e ka ftuar subjektin të paraqiste shpjegime në kuadër të analizimit të vendimmarrjes së tij në raport me përcaktimet e nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

339. Subjekti ka parashtruar se dhënia e vendimit me ekzekutim të përkohshëm është bërë me qëllim garantimin në një kohë efektive të së drejtës për të gëzuar lirisht pronën nga pala paditëse, në raport me kohëzgjatjen e afatit tërësor të kontratës së qirasë dhe në raport me kohëzgjatjen e procedurave gjyqësore në gjykimin në shkallë të dytë, ku aktualisht, sipas subjektit, po shqyrtohen ankimet që i përkasin vitit 2018.
340. Subjekti ka sqaruar se, në kushtet kur efekti tërësor i kontratës së qirasë (me afat 3-vjeçar) kishte përfunduar (në datën 19.9.2020) që në kohën e vendimmarrjes së gjykatës së shkallës së parë, impakti i pezullimit të ekzekutimit të kësaj vendimmarrjeje do të vështirësonte ekzekutimin në kufijtë e humbjes së interesit/dobishmërisë të së drejtës së afirmuar në këtë gjykim, është vlerësuar dhënia e vendimit me ekzekutim të përkohshëm.

Vlerësimi i trupit gjykues

¹¹⁵ Me shkresën nr. *** prot., datë 28.4.2023, nga Gjykata e Apelit është bërë me dije se ky vendim nuk është ankimuar.

¹¹⁶ Referuar shkresës me nr. *** prot., datë 5.5.2023.

¹¹⁷ Sistemi i Vlerësimit përmbledh vendimin nr. ***, datë 14.4.2010, të KLD-së “Sistemi i Vlerësimit të Gjyqtarëve”, së bashku me Aneksin I “Kriteret matëse të veprimtarisë gjyqësore”.

341. Pas shqyrtimit të shpjegimeve të subjektit dhe në analizë të rrethanave të çështjes objekt denoncimi, trupi gjykues çmon se vendimmarrja e subjektit gjendet në përputhje me përcaktimet e nenit 317, paragrafi 2 i Kodit të Procedurës Civile, sipas të cilit parashikohet se: *“Vendimi mund të jepet me ekzekutim të përkohshëm edhe kur nga vonesa e ekzekutimit paditësi mund të pësojë dëme të rëndësishme, që nuk mund të vihen në vend, ose kur ekzekutimi i vendimit do të bëhet i pamundur, ose do të vështirësohet së tepërmi. Në këtë rast, gjykata mund të kërkojë që paditësi të japë një garanci...”*.
342. Për sa më sipër, sikurse ka konkluduar edhe ILD-ja, në cilësinë e organit kompetent për verifikimin e shkeljeve disiplinore të magistratëve, nuk janë evidentuar shkelje procedurale në gjykimin e kësaj çështjeje nga subjekti i rivlerësimit.

7. Denoncimi nr. * prot., datë 20.3.2018, i shtetas M. Sh.**

343. Shtetasja M. Sh. ka pretenduar se vendimi nr. ***, datë 19.6.2017, me objekt “Detyrimi për njohje bashkëpronësie”, i dhënë nga subjekti i rivlerësimit, ka qenë i padrejtë dhe i njëanshëm.
344. Nga shqyrtimi i dokumentacionit, që i përket çështjes objekt denoncimi, ka rezultuar se Gjykata e Apelit Tiranë ka prishur një vendim të dhënë më herët nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe ka kthyer çështjen për rigjykim. Pas rikthimit, çështja i është caktuar për shqyrtim subjektit të rivlerësimit, i cili bazuar në ligjin nr. 7652, datë 23.12.1992 “Për privatizimin e banesave shtetërore”, ka vlerësuar se pretendimi i paditësve ka qenë i mbështetur në prova e në ligj, dhe padia duhej të pranohej.
345. Në përfundim të shqyrtimit të këtij denoncimi, si dhe dokumentacionit përkatës, nuk janë evidentuar shkelje procedurale apo *indicie* lidhur me favorizim të mundshëm të palës në këtë proces. Po ashtu, vetë denoncuesja nuk ka cituar ndonjë provë apo fakt në mbështetje të këtij pretendimi. Ndërsa, për sa i përket pretendimit të saj për vendimmarrje të padrejtë, trupi gjykues vlerëson se ky pretendim lidhet me themelin e çështjes, rrethanë e cila nuk hyn në juridiksionin e organeve të *Vetting*-ut, por është kompetencë e gjykatave më të larta¹¹⁸.
346. Për sa më sipër, trupi gjykues çmon se denoncimi nuk përmbush kriteret e përcaktuara nga neni 53 i ligjit nr. 84/2016 – dhe si i tillë nuk mund të mbahet në konsideratë në kuadër të vlerësimit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit.

8. Denoncimi nr. * prot., datë 2.4.2021, i shtetas L. K.**

347. Shtetasja L. K. nuk ka referuar ndonjë fakt, rrethanë apo pretendime në lidhje me vendimmarrjen e subjektit – dhe as nuk ka cituar apo bashkëlidhur ndonjë provë që do ta ngarkonte këtë të fundit me përgjegjësi në kuadër të rivlerësimit profesional të tij. Ajo ka parashtruar se gjykata ka pranuar kërkesën e saj për zëvendësimin e gjyqtarit të çështjes ku ajo ka qenë palë.
348. Gjatë hetimit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë¹¹⁹ ka bërë me dije se nuk kanë rezultuar çështje të shqyrtuara nga subjekti, ku të ketë qenë palë kjo shtetase.

¹¹⁸ Përgjatë hetimit administrativ, Gjykata e Apelit ka bërë me dije se kjo çështje është ankimuar, por deri në datën 24.4.2023 nuk është planifikuar gjykim.

¹¹⁹ Me shkresën nr. *** prot., datë 27.4.2023.

349. Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se ky denoncim nuk i përmbush kriteret e përcaktuara nga neni 53 i ligjit nr. 84/2016 – dhe si i tillë nuk mund të mbahet në konsideratë për vlerësimin e veprimtarisë profesionale të subjektit të rivlerësimit.

9. Denoncimet nr. * prot., datë 26.4.2019 dhe nr. *** prot., datë 30.4.2019, të shtetases A. A.**

350. Denoncuesja ka paraqitur dy denoncime me të njëjtën përmbajtje, ku ngrihen pretendime për njëanshmëri, mosadministrim provash dhe mosnjohim në lidhje me çështjen e finalizuar me vendimin nr. ***, datë 6.3.2017, të dhënë nga subjekti.

351. Nga shqyrtimi i vendimit objekt denoncimi ka rezultuar se subjekti ka arsyetuar ndër të tjera se gjatë gjykimit – ndryshe nga sa ka pretenduar shtetasja A. A. – ka rezultuar e konfirmuar marrëdhënia kontraktore, disbursimi i kredisë, po ashtu edhe fakti se ajo nuk kishte respektuar detyrimet që buronin nga kontrata e nënshkruar prej saj me bankën. Vendimi i dhënë nga subjekti ka rezultuar i lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit me vendimin nr. ***, datë 14.6.2023¹²⁰.

352. Në analizë të dokumentacionit të administruar ka rezultuar se pretendimet e denoncueses, përveçse lidheshim me themelin e çështjes, rezultuan edhe të pabazuara. Në këto kushte, trupi gjykues vlerëson se denoncimi nuk i përmbush kriteret e përcaktuara nga neni 53 i ligjit nr. 84/2016 dhe, për rrjedhojë, nuk mund të shqyrtohet më tej.

10. Denoncimi nr. * prot., datë 19.6.2019, i shtetases E. M.**

353. Shtetasja E. M. ka ngritur pretendime ndaj një noteri dhe nuk referon asnjë fakt apo provë në lidhje me subjektin e rivlerësimit Flamur Kapllani.

354. Në përgjigje të kërkesës së Komisionit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë¹²¹ ka bërë me dije se nuk kanë rezultuar çështje të shqyrtuara nga subjekti, ku shtetasja në fjalë të ishte e përfshirë.

355. Për sa më sipër, trupi gjykues çmon se ky denoncim nuk përmbush kriteret e përcaktuara në nenin 53 të ligjit nr. 84/2016 dhe, si tillë, nuk mund të shqyrtohet më tej.

11. Denoncimi nr. * prot., datë 6.6.2018, nga *****

356. Përfaqësuesi i *** (në cilësinë e të paditurit) ka pretenduar se gjyqtari i çështjes, z. F. Kapllani, ka zhvilluar seancat gjyqësore pa regjistrim audio, si dhe ka treguar mungesë etike profesionale e ligjore ndaj palës së paditur (***), pasi nuk ka lejuar që provat të diskutoheshin prej saj.

357. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të përcjellë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë¹²² ka rezultuar se çështja objekt denoncimi është regjistruar në Gjykatë në datën 18.12.2017 – dhe pasi janë zhvilluar 4 seanca, është finalizuar me vendimin nr. ***, datë 16.4.2018. Ky vendim është depozituar në sekretari në datën 27.4.2018.

358. Subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka arsyetuar në vendim se në rastin konkret bëhej fjalë për zgjidhje të kontratës/marrëdhënies së punës, me efekt të menjëhershëm dhe pa shkaqe të justifikuar nga ana e punëdhënësit/të paditurit (këtu denoncuesi), i cili nuk provoi në gjykim shkeljet e pretenduara si të kryera nga paditësja, znj. R. Kurti. Subjekti ka vlerësuar

¹²⁰https://gjykata.gov.al/**/

¹²¹ Me shkresën nr. *** prot., datë 17.5.2023.

¹²² Me shkresën nr. *** prot., datë 27.4.2023.

se kërkimi i paditëses ka rezultuar i drejtë dhe i bazuar në prova e në ligj dhe, për rrjedhojë, ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit me vendimin ***, datë 23.7.2019, me arsyetimin se çështja është zgjidhur drejt nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë – dhe se kjo Gjykatë ka analizuar drejt provat e administruara në dosje dhe kuadrin ligjor që rregullon mosmarrëveshjen mes palëve e ka zhvilluar një proces të rregullt ligjor për sa i përket procedurës së gjykimit.

359. Në përfundim të sa është analizuar më sipër – sikurse është ka konkluduar edhe nga Gjykata e Apelit – nuk janë konstatuar shkelje apo mangësi procedurale apo dyshime mbi favorizim të mundshëm të ndonjëres prej palëve në proces (sikurse pretendohet nga denoncuesi).

12. Denoncimi nr. * prot., datë 26.6.2018, i shtetasit P. B.**

360. Shtetasi P. B. ka përmendur disa gjyqtarë, ndërmjet tyre edhe subjektin. Lidhur me subjektin, denoncuesi ka pretenduar se vendimi nr. ***, datë 3.4.2017, i dhënë prej tij, ka qenë i padrejtë, pasi ai ka anashkaluar provat, si dhe ka zvarritur procesin gjyqësor.

361. Nga shqyrtimi i vendimit të dhënë nga subjekti ka rezultuar se në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, si dhe bazuar në aktin e përgatitur nga eksperti kontabël për verifikimin e pretendimeve të palëve, subjekti ka vendosur pranimin e pjesshëm të padisë.

362. Sa i takon pretendimit për vendimmarrje të padrejtë, trupi gjykues çmon se përpos faktit që pretendime të tilla nuk janë objekt shqyrtimi nga Komisioni, vendimi i dhënë nga subjekti ka rezultuar i lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit¹²³ me vendimin nr. ***, datë 25.6.2018, e cila nuk ka konstatuar ndonjë shkelje procedurale në këtë vendimmarrje.

363. Ndërsa, lidhur me pretendimin për zvarritje të procesit gjyqësor, Komisioni ka konstatuar se çështja objekt denoncimi është regjistruar në Gjykatë në datën 12.5.2015 dhe vendimi është shpallur në datën 3.4.2017.

364. Për sa më sipër, Komisioni e ka ftuar subjektin të paraqiste shpjegime lidhur me shkaqet e tejkalimit të afatit procedural të shqyrtimit të çështjes në fjalë.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

365. Subjekti ka parashtruar se në kohëzgjatjen e procesit kanë ndikuar faktorët si: kompleksiteti i çështjes, sjellja e palëve dhe sjellja e autoriteteve gjyqësore apo administrative të shtetit, si dhe domosdoshmëria e kryerjes së një ekspertizë teknike. Një pjesë e seancave gjyqësore janë shtyrë edhe me kërkesë të palëve. Subjekti ka parashtruar se gjykimi në fjalë është zhvilluar në tejkalim të afatit standard të gjykimit, por në respektim të afatit ligjor 2-vjeçar të përcaktuar nga Kodi i Procedurës Civile.

Vlerësimi i trupit gjykues

366. Pas analizimit të prapësimeve të subjektit, si dhe referuar evidencës për ngarkesën e gjyqtarëve të Gjykatës së Shkallës së Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë për periudhën 1.1.2013 – 31.12.2016, si dhe raportit të KLGJ-së, ka rezultuar se subjekti ka pasur një ngarkesë dukshëm mbi mesataren.

367. Përpos sa më sipër, trupi gjykues çmon të mbajë në konsideratë edhe qëndrimin e mbajtur nga Gjykata e Lartë në vendimin unifikues nr. 5, datë 12.12.2013, lidhur me afatin e arsyeshem të gjykimit dhe faktorët që ndikojnë në këtë afat. Në këtë vendim, ndër të tjera,

¹²³ Administruar me shkresën nr. *** prot., datë 28.4.2023.

arsyetohe se në vlerësim të rrethanave të zvarritjes së procesit gjyqësor mbahen në konsideratë rrethanat dhe shkaqet që kanë sjellë pamundësinë objektive të zhvillimit të procesit gjyqësor.

368. Në vlerësim të këtyre rrethanave, trupi gjykues arrin në përfundimin se nuk evidentohen fakte për tejzgjatje apo zvarritje të qëllimshme të procesit nga ana e subjektit, pasi kohëzgjatja e gjykimit është diktuar nga faktorë objektivë, e që lidheshin me dinamikën e çështjes. Për rrjedhojë, për sa kohë nuk janë konstatuar cenim të të drejtave procedurale të palëve, nuk shihen *indicie* që do të ngarkonin subjektin me përgjegjësi disiplinore në aspektin profesional.

13. Denoncimi nr. * prot., datë 2.7.2018, i shtetasit I. S.**

369. Shtetasi I. S. ka pretenduar se subjekti nuk ka caktuar datë për seancën gjyqësore, brenda 15 ditëve nga kërkesa e paraqitur prej tij, me objekt “Kundërshtimi i veprimeve përmbarimore”. Këtë pretendim, shtetasi në fjalë e ka adresuar edhe në ILD¹²⁴, ku ka paraqitur 2 ankesa, të cilat janë arkivuar pasi nuk janë evidentuar shkelje.

370. Gjatë hetimit, Komisioni ka konstatuar se kërkesa objekt denoncimi është regjistruar në gjykatë në datën 14.6.2018, me nr. *** regjistri. Vendimi është shpallur në datën 1.8.2018. Referuar afatit të përcaktuar nga paragrafi 3 i nenit 610 të Kodit të Procedurës Civile, i cili parashikon se “*Ankimi shqyrtohet brenda 20 ditëve nga gjykata e vendit të ekzekutimit, e cila kur e sheh të nevojshme mund të thërrasë palët dhe përmbaruesin gjyqësor*”, ka rezultuar se ky afat nuk është respektuar.

371. I pyetur nga Komisioni në lidhje me konstatimin e mësipërm (me tejkalinimin e afatit) subjekti ka shpjeguar se kërkesëpadia, objekt gjykimi, i ka kaluar atij për shqyrtim në datën 20.6.2018 dhe po në këtë datë ai ka caktuar seancën gjyqësore për në datën 6.7.2018, ora 10:30, duke njoftuar edhe palët. Gjykimi¹²⁵ është ndërprerë, pasi kërkuuesi I. S. kishte paraqitur kërkesë¹²⁶ për përjashtimin e gjyqtarit të çështjes. Kjo kërkesë është rrëzuar me vendimin e datës 16.7.2018 nga gjyqtari përkatës.

372. Subjekti ka deklaruar se ky vendim i është komunikuar në datën 19.7.2018 – dhe po në këtë datë ai ka urdhëruar sekretarinë gjyqësore që të njoftojë palët për vazhdimin e gjykimit, duke planifikuar seancën e ardhshme në datën 27.7.2018, ora 12:30. Pas çeljes së seancës në datën dhe orën e përcaktuar, është kryer verifikimi i prezencës së palëve, nga ku ka rezultuar që nuk është paraqitur personi i tretë. Gjykimi është shtyrë me qëllim përsëritjen e njoftimit¹²⁷. Në vijim, me vendimin nr. ***, datë 1.8.2018¹²⁸, subjekti ka vendosur mospranimin e kërkesës së denoncuesit, duke e njoftuar kërkuuesin për këtë vendimmarrje, me anë të dëftesës së komunikimit të datës 8.8.2018. Ky i fundit ka nënshkruar marrjen dijani në datën 12.9.2018. Vendimi i mësipërm ka marrë formë të prerë në datën 1.10.2018.

373. Për sa më sipër, nga analiza e çështjes ka rezultuar se mosrespektimi i afatit të përcaktuar nga ligji (Kodi i Procedurës Civile) ka ardhur për arsye objektive: (i) për shkak të paraqitjes së kërkesës për përjashtim nga pala ankuese; (ii) për shkak të mungesës/mosparaqitjes së

¹²⁴ Me shkresën nr. *** prot., datë 5.5.2023.

¹²⁵ Sipas procesverbalit të seancës gjyqësore, të paraqitur nga subjekti.

¹²⁶ Në datën 6.7.2018, me nr. *** akti.

¹²⁷ Me kërkesë të palëve, subjekti ka përsëritur njoftimin e tyre me fletëthirrje, duke e shtyrë seancën për në datën 1.8.2018, ora 10:30, por sërish personi i tretë nuk është paraqitur. Pavarësisht se përfaqësuesja e kësaj pale ka kërkuar që të rinjoftohen personat e tretë të paparaqitur, gjykata ka vijuar gjykimin pa praninë e tyre.

¹²⁸ Administruar nga Komisioni me shkresën nr. *** prot., datë 27.4.2023.

palëve, çka së pari është një domosdoshmëri në kuadër të plotësisimit të kërkesave procedurale, e së dyti për shkak se palët prezente e kanë kërkuar praninë e tyre.

374. Për sa më sipër, nuk janë evidentuar shtyrje të pajustificuara të seancave apo mosadministrim/menaxhim i çështjes nga ana e subjektit.

14. Denoncimi nr. * prot., i shtetas Y. Z.**

375. Denoncuesja është ankuar për dhënien e një vendimi të padrejtë dhe zvarritje të gjykimit nga subjekti i rivlerësimit, në çështjen gjyqësore ku ajo ka qenë palë e paditur.

376. Gjatë hetimit, ka rezultuar se çështja objekt denoncimi është regjistruar në këtë Gjykatë në datën 24.7.2015. Për këtë çështje janë zhvilluar gjithsej 24 seanca. Në përfundim të gjykimit, me vendimin nr. ***, datë 31.7.2019¹²⁹, subjekti ka vendosur pranimin e pjesshëm të padisë. Vendimi është dorëzuar në sekretari në datën 1.8.2019¹³⁰.

377. I pyetur lidhur me shkaqet dhe arsyet e kohëzgjatjes së këtij gjykimi (në harkun kohor 24.7.2015 – 1.8.2019), në tejkallim të afatit të përcaktuar nga pika 5, shkronja “e” e Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit¹³¹, si dhe afatit të përcaktuar nga neni 399/2 i Kodit të Procedurës Civile, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka parashtruar në datën 28.7.2015, me “Vendim”, shqyrtimin e saj në seancë përgatitore për në datën 24.9.2015, ora 9:30, për shkak se muaji gusht përfaqëson muajin e lejeve vjetore të gjyqtarëve. Kjo seancë ka dështuar për faj të shërbimit postar, i cili nuk bëri të mundur njoftimin e palës së paditur, duke u shtyrë në datën 4.11.2015, seancë e cila është zhvilluar normalisht. Më tej, në seancën e datës 26.11.2015 është vendosur pezullimi i gjykimit për shkaqe të bazuara në ligj. Gjykimi ka qëndruar i pezulluar për 2 vjet, 5 muaj e 13 ditë (26.11.2015 – 9.5.2018) – dhe ka rifilluar në datën 9.5.2018, pasi ka rënë shkaku i pezullimit. Më pas, procesi ka vijuar duke u zhvilluar edhe 19 seanca të tjera. Subjekti ka parashtruar se përpos kompleksitetit të çështjes dhe nevojës për kryerjen e dy ekspertizave të ndryshme, seancat janë shtyrë për shkaqe të justifikuara. Konkretisht, vetëm dy seanca kanë dështuar për mosprezencën e tij (një për shkaqe shëndetësore dhe një për shkak fatkeqësie, pasi babai i tij kishte ndërruar jetë). Ndërsa disa seanca janë shtyrë me kërkesë të vetë palëve për të paraqitur prova të reja dhe për t’u njohur me provat e njëra-tjetrës.

378. Në analizë të rrethanave të sipër përshkruara, trupi gjykues evidenton se bazuar në nenin 399/2 të Kodit të Procedurës Civile, gjykimi civil në shkallë të parë duhet të përfundojë brenda dy viteve. Megjithatë, në nenin 399/2, paragrafi i tretë parashikohet se: *“Në kohëzgjatjen e gjykimit ose të procedimit nuk llogaritet koha kur çështja është pezulluar për shkaqe ligjore, kur është shtyrë për shkak të kërkesave të palës kërkuese ose kur shfaqen rrethana të pamundësisë objektive për procedim”*. Duke mbajtur në konsideratë se pezullimi i gjykimit përbën një shkak të arsyeshëm dhe nuk konsiderohet zvarritje e procesit, në këndvështrim edhe të përcaktimit ligjor të mësipërm, ka rezultuar se gjykimi i kësaj çështjeje ka zgjatur për kohë efektive 1 vit, 6 muaj e 17 ditë¹³², pra në respektim të aftit 2-vjeçar të parashikuar nga neni 399/2, shkronja “b” e Kodit të Procedurës Civile.

¹²⁹ Përcjellë nga Gjykata me shkresën nr. *** prot., datë 17.5.2023.

¹³⁰ Me shkresën nr. *** prot., datë 9.5.2024, Gjykata e Apelit ka bërë me dije se ndaj vendimit të mësipërm është ushtruar ankim dhe deri në datën 9.5.2024 nuk është planifikuar datë për gjykim.

¹³¹ Sistemi i Vlerësimit përmbledh vendimin nr. ***, datë 14.4.2010, të KLD-së “Sistemi i Vlerësimit të Gjyqtarëve”, së bashku me Aneksin I “Kriteret matëse të veprimtarisë gjyqësore”.

¹³² Po t’i zbrisim gjykimit të mësipërm afatin e pezullimit, pra 4 vjet – 2 vjet e 5 muaj e 13 ditë = 1 vit, 6 muaj e 17 ditë.

15. Denoncimi nr. * prot., datë 2.10.2019, i shtetasit P. Z.**

379. Denoncuesi ka përmendur subjektin e rivlerësimit dhe disa gjyqtarë të tjerë, duke u shprehur se ata janë të korruptuar, pasi kanë favorizuar disa shtetas që pretendonin të drejta pronësie, lidhur me prona për të cilat nuk dispononin dokumentacion.
380. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar¹³³ ka rezultuar se denoncuesi ka qenë palë në procesin gjyqësor të finalizuar me vendimin nr. ***, të dhënë nga subjekti, me anë të të cilit subjekti ka vendosur kthimin e kërkesëpadsisë për plotësim të metash, pasi nuk plotësonte kërkesat e neneve 154 dhe 158/a të Kodit të Procedurës Civile. Ky vendim ka marrë formë të prerë në datën 25.4.2016.
381. Për sa më sipër, pretendimet e denoncuesit kanë rezultuar deklarative dhe të pambështetura në prova. Nuk janë evidentuar *indicie* për thellimin e hetimit.

16. Denoncimi nr. * prot., datë 4.10.2019, i shtetasit Xh. Sh.**

382. Denoncuesi ka pretenduar se në shqyrtimin e çështjes ku ai ka qenë në cilësinë e të paditurit, subjekti ka kryer shkelje procedurale dhe ka qenë i njëanshëm.
383. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar lidhur me këtë denoncim¹³⁴ ka rezultuar se prefekti i Qarkut Tiranë, në datën 29.10.2010, i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke kërkuar pavlefshmërinë e pjesshme të Aktit të Marrjes së Tokës në Pronësi me nr. ***, datë 17.5.1996, lëshuar në emër të shtetasit Xh. Sh., si dhe shfuqizimin e pjesshëm të këtij akti dhe kthimin e pasurisë në tokë “shtet”¹³⁵.
384. Çështja në fjalë është regjistruar në gjykatë në datën 28.10.2010. Janë zhvilluar gjithsej 19 seanca. Në përfundim të gjykimit, me vendimin nr. ***, datë 28.6.2012, subjekti ka vendosur: “Pranimin e kërkesëpadsisë dhe deklarimin e pavlefshmërisë së pjesshme të aktit administrativ, AMTP-në në emër të kërkuarit Xhaferr Shtëpani, me nr. ***, datë 17.5.1996, për sipërfaqen e tokës bujqësore prej 2.000 m². Shfuqizimin e pjesshëm të këtij akti dhe kthimin e pasurisë në pronësi “shtet””. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. ***, datë 22.1.2013.
385. Pas rekursit të paraqitur nga denoncuesi, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. ***, datë 28.3.2017, ka vlerësuar se vendimi është marrë në përputhje me dispozitat e ligjit material dhe atij procedural dhe në përfundim ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë 22.1.2013, të Gjykatës së Apelit Tiranë¹³⁶.
386. Nga sa më sipër, sikurse kanë konkluduar edhe të dyja shkallët e tjera të gjyqësorit, vendimmarrja e subjektit ka rezultuar e drejtë dhe e bazuar në ligj. Në përfundim, trupi

¹³³ Me shkresën nr. *** prot., datë 17.5.2023.

¹³⁴ Kopje të fletëthirrjeve për njoftimin e palëve, kopje të regjistrimit ku evidentohet data e regjistrimit të çështjes dhe ajo e depozitimit të vendimit në sekretarinë gjyqësore, kopje të vendimeve në të tria shkallët e gjyqësorit, si dhe vendimin e Gjykatës Kushtetuese.

¹³⁵ Lidhur me këtë pronë, Komisioni Vendor i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë (KVVTP), me vendimin nr. ***, datë 18.10.2010, kishte vendosur “Shfuqizimin e pjesshëm të aktit të marrjes së tokës bujqësore në pronësi të familjes bujqësore të përfaqësuar nga Xh. Sh. dhe kthimin e tokës në pronësi shtet me sipërfaqe 2.000 m² në ngastrën ***”, për shkak se titulli i pronësisë ka qenë pjesërisht në kundërshtim me udhëzimin nr. ***, datë 23.2.1996.

¹³⁶ Denoncuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese, duke pretenduar se vendimet e gjykatave kanë cenuar të drejtën për një proces të rregullt ligjor. Kjo Gjykatë ka vlerësuar se kërkuari nuk legjitimohet *ratione temporis* për vënien në lëvizje të juridiksionit kushtetues, pasi kërkesa është paraqitur jashtë afatit ligjor 4-mujor.

gjykues çmon se nuk janë evidentuar shkelje procedurale apo të të drejtave të palëve në këtë proces gjyqësor dhe as njëanshmëri – sikurse pretendon denoncuesi.

17. Denoncimi nr. * prot., datë 9.11.2020, i shtetasit J. K.**

387. Denoncuesi në fjalë ka ngritur pretendime në lidhje me çështjen e finalizuar me vendimin nr. ***, datë 22.9.2019, të dhënë nga subjekti i rivlerësimit, me objekt “Lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë testamentare të nënës së denoncuesit”. Denoncuesi ka pretenduar se testamenti objekt gjykimi ishte i pavlefshëm. Në këtë testament, e ndjera kishte shprehur vullnetin që e gjithë pasuria e saj të trashëgohej nga dy vajzat e saj, duke përjashtuar djalin J. K. (këtu denoncuesi).
388. Nga shqyrtimi i dokumentacionit, si dhe në analizë të procedurës së përcaktuar në nenin 46 të Kodit të Procedurës Civile, trupi gjykues vlerëson se pretendimet që lidhen me pavlefshmërinë e testamentit dhe ato për pjesëtimin e pasurisë të përfutur me trashëgimi ngrihen në Gjykatë – dhe nuk mund të jenë objekt vlerësimi nga Komisioni.
389. Po ashtu, trupi gjykues çmon se bazuar në nenet 388 e vijues të Kodit të Procedurës Civile, vendimi i dhënë nga subjekti ka pasur karakter deklarativ dhe, si rrjedhojë, faktet e pranuar në të mund të kundërshtohen në çdo kohë me një padi themeli të ngritur, sipas procedurës së përcaktuar ligjore. Në këto rrethana, vendimi i gjykatës së rrethit që konstaton pavlefshmërinë absolute të dëshmisë së trashëgimisë nuk ka asnjë efekt, pra konsiderohet i paqenë¹³⁷. Sipas nenit 348 të Kodit Civil: *“Cilësia si trashëgimtar dhe pjesët takuese në trashëgim caktohen në dëshminë e trashëgimisë të lëshuar nga Gjykata, sipas rregullave të caktuara në Kodin e Procedurës Civile”*.
390. Për sa më sipër – përpos vlerësimeve mbi themelin e çështjes, që nuk u përket organeve të rivlerësimit – nuk janë evidentuar *indicie* për thellimin e hetimit për denoncimin në analizë, për sa kohë ai nuk i përmbush kriteret e përcaktuara nga neni 53 i ligjit nr. 84/2016.

18. Denoncimi nr. * prot., datë 15.8.2023, i shtetasit B. B.**

391. Shtetasi B. B. ka pretenduar se për shqyrtimin e kërkesës së tij, të datës 16.5.2018, me objekt “Lirim, dorëzim sendi...”¹³⁸, subjekti ka zvarritur procesin gjyqësor. Këtë pretendim denoncuesi e kishte adresuar edhe pranë ILD-së¹³⁹, me ankesat nr. *** prot., datë 9.3.2020 dhe nr. *** prot., datë 2.10.2020, ku veç pretendimit për zvarritje të procesit, kishte pretenduar anashkalim të provave – dhe se gjyqtari kishte dalë nga objekti i gjykimit të kërkesëpadisë. Pas verifikimit të këtyre ankesave të bashkuara, ILD-ja me vendimin nr. ***, datë 13.12.2023, ka arsyetuar se referuar vendimit unifikues nr. 5, datë 12.12.2013, të Gjykatës së Lartë, në përcaktimin e afatit të arsyeshëm të gjykimit duhet të mbahen në konsideratë edhe faktorët që ndikojnë në këtë afat, si kompleksiteti i çështjes etj. ILD-ja ka arritur në përfundimin se nuk janë kryer shkelje në drejtim të zvarritjes së procesit gjyqësor, përtej rrethanave dhe shkaqeve të pamundësisë objektive të zhvillimit të procesit gjyqësor. Për rrjedhojë, ka vendosur arkivimin e ankesave.

¹³⁷ Vendimi nr.56, datë 23.9.2002, i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

¹³⁸ Bashkëlidhur denoncimit ka rezultuar një vërtetim i datës 25.7.2023, nga Gjykata e Shkallës së parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë. Gjithashtu, në vërtetimin në fjalë citohej se çështja ishte ende në gjykim.

¹³⁹ Fillimisht me shkresën nr. *** prot., datë 5.5.2023, ka bërë me dije se shtetasi në fjalë ka depozituar pranë ILD-së ankesën nr. *** prot., datë 9.3.2020, e cila ishte në proces shqyrtimi. Në vijim, ILD-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 29.3.2024, ka përcjellë vendimmarrjet përkatëse.

392. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar¹⁴⁰, Komisioni ka konstatuar se çështja civile me nr. *** akti është regjistruar në gjykatë në datën 16.5.2018 dhe i ishte caktuar për gjykim subjektit, me shortin e datës 17.5.2018. Në seancën e datës 25.7.2023, pala e paditur kishte kërkuar pezullimin e gjykimit, pasi kishte bërë një kallëzim që kishte lidhje të drejtpërdrejtë me çështjen në gjykim, e për të cilin vijonin hetimet. Në këto kushte, me vendimin nr. *** akti, datë 25.7.2023, gjykata, bazuar në nenin 297/a të Kodit të Procedurës Civile, ka pezulluar përkohësisht çështjen derisa të përfundonte hetimi penal.
393. Komisioni e ka ftuar subjektin të paraqiste shpjegime lidhur me stadin e gjykimit të kësaj çështjeje, si dhe për kohëzgjatjen e gjykimit të saj.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

394. Subjekti ka parashtruar se çështja në fjalë vijon të jetë e pezulluar sipas vendimit nr. *** akti, datë 25.7.2023 “Për pezullimin e gjykimit”. Ndërsa, lidhur me kohëzgjatjen e gjykimit, subjekti ka parashtruar se çështja ka qenë komplekse dhe se nevoja për kryerjen e një ekspertizë teknike ka marrë kohë dhe ka ndikuar në afatin e gjykimit. Një pjesë e seancave gjyqësore janë shtyrë edhe me kërkesë të palëve. Gjykimi është zhvilluar në tejkallim të afatit standard të gjykimit, por gjithsesi në respektim të afatit ligjor 2-vjeçar të përcaktuar nga Kodi i Procedurës Civile.

Vlerësimi i trupit gjykues

395. Trupi gjykues vlerëson se vendimi i pezullimit i datës 25.7.2023 është dhënë nga subjekti, = pas miratimit të ndryshimeve në Kodit të Procedurës Civile lidhur me “Afatin e arsyeshëm”, i përcaktuar në nenin 399/2, shkronja “b” e këtij Kodi (dispozitë e shtuar me ligjin nr. 38/2017, datë 30.3.2017). Kjo dispozitë përcakton se: “1. Afate të arsyeshme të përfundimit të hetimit, gjykimit apo ekzekutimit të një vendimi të formës së prerë, për qëllimet e përcaktuara në nenin 399/1, do të konsiderohen: ... b) në gjykimin civil në shkallë të parë përfundimi i procesit të gjykimit brenda dy viteve”. Po ashtu, bazuar në paragrafin 3 të po kësaj dispozite, citohet se: “Në kohëzgjatjen e gjykimit ose të procedimit nuk llogaritet koha kur çështja është pezulluar për shkaqe ligjore, kur është shtyrë për shkak të kërkesave të palës kërkuese, ose kur shfaqen rrethana të pamundësisë objektive për procedim”.
396. Gjithashtu, Gjykata Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut¹⁴¹ ka përcaktuar në precedentin e saj se kur bëhet vlerësimi nëse kohëzgjatja e procesit konsiderohet e arsyeshme, duhen marrë parasysh këta faktorë: kompleksiteti i çështjes, sjellja e palëve dhe sjellja e autoriteteve gjyqësore apo administrative të shtetit.
397. Përpos sa më sipër, pretendimi i denoncuesit B. B. për zvarritje të gjykimit është trajtuar dhe inspektuar si e tillë edhe nga organi kompetent për verifikimin e shkeljeve disiplinore të magjistratëve, që është Inspektori i Lartë i Drejtësisë. Në përfundim të shqyrtimit të rastit, ky institucion ka vendosur arkivimin e ankesës, pasi nuk ka gjetur shkelje në veprimtarinë e subjektit të rivlerësimit.
398. Për sa më sipër, trupi gjykues ka arritur në përfundimin se në lidhje me administrimin e çështjes në fjalë nuk vërehen shtyrje të pajustificuara të seancave gjyqësore nga subjekti i

¹⁴⁰ Administruar me shkresën nr. *** prot., datë 17.5.2024, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

¹⁴¹ Shihni Buchholz kundër Republikës Federale Gjermane, 6 maj 1981, paragrafi 49.

rivlerësimit¹⁴². Për një periudhë kohe aktiviteti gjyqësor është pezulluar për shkak të pandemisë të shkaktuar nga Covid-2019, e cila ka ndikuar edhe tek palët dhe institucionet¹⁴³. Për mungesë të gjyqtarit janë shtyrë 3 seanca (e datës 9.5.2019, për shkak të një fatkeqësie familjare, e datave 18.12.2019 e 21.7.2022 për arsye shëndetësore dhe seanca e datës 24.11.2021 për shkak të pjesëmarrjes në një ceremoni mortore jashtë qytetit të Tiranës).

19. Denoncimet nr. * prot., datë 9.5.2019 dhe nr. *** prot., datë 9.5.2019, të shtetasit A. Sh.**

399. Shtetasi A. Sh., në të dy denoncimet e paraqitura (me të njëjtën përmbajtje) ka ngritur pretendime që lidheshin me kriterin pasuror, si dhe lidhur me ndikimin e tij në cilësinë e anëtarit të KLD-së në vendimmarrjen e tyre. Ai ka parashtruar se në një proces gjyqësor që ai ka pasur në Durrës, gjyqtarja Dh. B., e cila ka qenë gjyqtarja e çështjes, sipas denoncuesit është mike e subjektit, i cili e ka favorizuar atë në cilësinë e anëtarit të KLD-së.
400. Lidhur me pretendimet që i referohen kriterit pasuror, Komisioni ka analizuar e përshkruar në këtë vendim veprimet hetimore të kryera lidhur me sa pretendohet.
401. Ndërsa, lidhur me pretendimin e denoncuesit për ndikim të mundshëm tek gjyqtarja Dh. B., për sa i përket çështjes ku denoncuesi ka qenë palë, Komisioni vlerëson se ky pretendim nuk lidhet me veprimtarinë profesionale të subjektit në kuadër të ushtrimit të detyrës së tij si gjyqtar, e për rrjedhojë, nuk mund të mbahet në konsideratë për vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit.

LIDHUR ME PUBLIKIMET NË MEDIAN ONLINE

¹⁴² Me kërkesë të palëve në gjykim janë shtyrë 13 seanca (seancat gjyqësore të datave 13.3.2019, 11.4.2019, 27.6.2019, 29.1.2020, 27.2.2020, 27.2.2020, 23.7.2020, 30.9.2020, 27.10.2020, 26.4.2021, 14.6.2021, 19.1.2023 e 4.4.2023); 5 kërkesa për shtyrje gjykimi ka parashtruar pala paditëse e kundërpaditur dhe 8 kërkesa ka paraqitur pala e paditur kundërpaditëse; në seancën përgatitore të datës 27.9.2018, gjykata ka konstatuar të meta si të padisë, ashtu edhe të kundërpadisë së paraqitur; këto të meta janë ndrequr si të tilla nga palët në seancën e radhës përgatitore, atë të datës 18.10.2018; në seancën gjyqësore të datës 15.11.2018, pala paditëse e kundërpaditur kërkoi kohë të paraqiste me shkrim kërkesën për përjashtimin e trupit gjykues, çka mundësoi edhe shtyrjen e kësaj seance; një sërë seancash janë shtyrë për pamundësi të përfaqësuesve të palëve ndërgjyqëse për t'u paraqitur në gjykim, po ashtu gjatë gjykimit, palët ndërgjyqëse kanë ndërruar disa avokatë. Me kërkesë të tyre janë thirrur në cilësinë e personit të tretë disa subjekte të së drejtës, njoftimi i të cilëve ka shtyrë seancën gjyqësore të datës 10.12.2020; për njoftimin e palëve (seanca e datave 20.12.2021, 28.2.2022 dhe 29.4.2022); dhe më pas realizimi i shpalljes publike (seanca e datës 19.01.2023); ndërkohë që për shkak të ndërrimit të jetës për një nga personat e tretë është realizuar edhe kalimi procedural në favor dhe ngarkim të trashëgimtarëve ligjorë, kjo ka sjellë shtyrjen e seancave gjyqësore të datave 3.2.2021, 16.3.2021, 6.7.2021 dhe 30.9.2021; me kërkesë të palëve ndërgjyqëse, në proces është thirrur një ekspert me njohuri të posaçme në fushën e inxhinierisë së ndërtimit, njoftimi i ekspertës, thirrja e saj në proces, realizimi i aktit të ekspertimit, ka shkaktuar shtyrjen e disa seancave gjyqësore (seanca e datave 16.1.2019, 7.2.2019 dhe 30.5.2019); me kërkesë të palëve është realizuar edhe shtesë në aktin e ekspertimit fillestar, kjo ka bërë të mundur shtyrjen e seancave gjyqësore të datës 22.11.2019; kryerja e ekspertimit ka kërkuar paraqitjen nga palët të një sërë dokumentesh shtesë të kërkuara nga eksperti, kjo ka sjellë shtyrjen e seancave gjyqësore të datave 26.9.2019, 22.10.2019 dhe 22.11.2019.

¹⁴³ Me vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. ***, datë 10.3.2020 "Për pezullimin e veprimtarisë gjyqësore në të gjitha gjykatat e Republikës së Shqipërisë", si dhe aktin normativ nr. 9, datë 25.3.2020, të Këshillit të Ministrave, është vendosur pezullimi i veprimtarisë së gjykatës, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga Covid-19. Kjo ka bërë që seanca gjyqësore e datës 9.4.2020 të shtyhej për në datën 23.7.2020.

1. Në portalin “**”¹⁴⁴, si dhe në portalin “****”¹⁴⁵, ***¹⁴⁶, kanë rezultuar të publikuar dy artikuj me pothuajse të njëjtën përmbajtje, e cila paraqitet në mënyrë të përmbledhur si në vijim:**

“Drejt Vetting-ut gjyqtari me dy padi/Flamur Kapllani, me “shkollë nate”, vendime të jashtëligjshme dhe probleme me pasurinë”... “Në listën e gjyqtareve problematike që po i kontrollohen pasuritë është edhe Flamur Kapllani, i denoncuar vetëm për 2020-ën, dy herë dhe me të dyja dosjet në proces hetimi për shpërdorim detyre në Prokurorinë e Durrësit. Një prej kallëzimeve ndaj tij është bërë pasi me një vendim të pabazuar transferoi aksione pa marrë aspak parasysh gjykatën e arbitrazhit. Flamur Kapllani gjendet në listën e gjyqtareve të dyshimtë, aq më tepër që gjatë kohës që ishte anëtar i KLD-së organizata të ndryshme të shoqërisë civile e listuan mes gjyqtarëve me pasuri luksoze dhe të pajustificuar”.

402. Lidhur me sa më sipër, sikurse është trajtuar edhe në rubrikën “Rivlerësimi i aftësive profesionale nga Komisioni”, gjatë hetimit Komisioni ka administruar dhe shqyrtuar dosjet përkatëse të të gjitha kallëzimeve të përcjella/rezultuara ndaj këtij subjekti. Nga shqyrtimi i tyre është konstatuar se në të gjitha rastet është vendosur mosfillimi i hetimit, për shkak se nuk janë konstatuar elemente të veprës penale.
403. Për sa i përket shprehjes së përdorur në këto artikuj, për “Pasuri luksoze dhe të pajustificuar”, ajo ka rezultuar në formën e një opinioni dhe e tipit deklarativ, e pashoqëruar me prova apo fakte që do të mundësonin ndonjë hetim më të thelluar dhe që, nëse do të rezultonin të bazuara, ndoshta do të ngarkonin me përgjegjësi subjektin.
404. Në këto kushte, në mbështetje të nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, duket se publikimi i sipër përshkruar nuk përmban fakte apo rrethana që mund të përbëjnë prova apo *indicie* konkrete në lidhje me kriteret e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit. Për rrjedhojë, nuk shihen *indicie* për thellimin e hetimit lidhur me këtë shkrim – për sa kohë ai nuk i përmbush kriteret e përcaktuara nga kjo dispozitë (neni 53 i ligjit nr. 84/2016), duke mos i mundur Komisionit kryerjen e ndonjë hetimi specifik, me qëllim verifikimin e thelluar lidhur me vërtetësisë dhe bazueshmërinë e pretendimeve apo shkrimeve të sipër përshkruara.
405. Në konkluzion përfundimtar lidhur me kriterin e aftësive profesionale, Komisioni çmon se për subjektin e rivlerësimit nuk është konstatuar mangësi profesionale, mosrespektim i të drejtave të palëve apo mangësi në arsyetimin e vendimeve të dhëna prej tij. Në këto kushte, vlerësohet se z. Flamur Kapllani ka arritur një nivel profesional kualifikues të aftësive profesionale, sipas parashikimit të shkronjës “c” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

KONKLUZION PËRFUNDIMTAR

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit Flamur Kapllani:

- a. ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- b. ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;

¹⁴⁴ https://www****.com/*****

¹⁴⁵ https://****.al/****/

¹⁴⁶ https://****.tv/****

c. ka arritur një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës, nenin D të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Francesco Ciardi, në bazë të shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 58 dhe pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Flamur Kapllani, gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ndaj këtij vendimi mund të ushtrohet ankim në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga Komisioneri Publik dhe/ose subjekti i rivlerësimit 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në datën 3.7.2024.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Brunilda BEKTESHI
Kryesuese

Lulzim HAMITAJ
Relator

Etleda ÇIFTJA
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Jonida Vrana